
32014R0596

RREGULLORE (BE) NR. 596/2014 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 16 PRILL 2014, "PËR ABUZIMIN NË TREG (RREGULLORJA PËR ABUZIMIN NË TREG) DHE QË SHFUQIZON DIREKTIVËN 2003/6/KE TË PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË KËSHILLIT DHE DIREKTIVAT E KOMISIONIT 2003/124/KE, 2003/125/KE DHE 2004/72/KE"

(Tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funkionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 114 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit Evropian,

Pas komunikimit të projektaktit legjislativ në parlamentet kombëtare,

Duke pasur parasysh opinionin e Bankës Qendrore Evropiane¹,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social²,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative³,

Meqë:

1. Një treg i brendshëm i unifikuar i shërbimeve financiare është thelbësor për rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në BE.

2. Një treg financiar i integruar, efikas dhe transparent kërkon integritet të tregut. Funkionimi normal i tregjeve të titujve dhe besimi i publikut në to përbëjnë kushtet paraprake për rritjen ekonomike dhe mirëqenien. Abuzimi me tregun dëmton integritetin e tregjeve financiare dhe besimin e publikut në tituj dhe derivate.

3. Direktiva 2003/6/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit⁴ plotësoi dhe përditësoi kuadrin ligjor të BE-së për të mbrojtur integritetin e tregut. Megjithatë, duke pasur parasysh zhvillimet legjislative, të tregut dhe teknologjike që nga hyrja në fuqi e asaj direktive, të cilat kanë rezultuar në ndryshime të konsiderueshme në peizazhin financiar, kjo direktivë tani duhet të zëvendësohet. Gjithashtu, nevojitet një instrument i ri legjislativ për të siguruar që të ketë rregulla të njëtrajtshme dhe qartësi të koncepteve kyçe dhe një libër të vetëm rregullash në përputhje me konkluzionet e raportit të 25 shkurtit 2009 nga Grupi i nivelit të lartë mbikëqyrës financiar i BE-së, kryesuar nga Jacques de Larosière (Grupi "de Larosière").

4. Ekziston nevoja për të krijuar një kuadër më uniform dhe më të fortë për të ruajtur integritetin e tregut, për të shmangur arbitrazhin e mundshëm rregullator, për të siguruar llogaridhënien në rast të përpjekjeve për manipulim dhe për të ofruar më shumë siguri ligjore dhe pak kompleksitet rregullash për pjesëmarrësit në treg. Kjo rregullore synon të kontribuojë në mënyrë të përcaktuar në funksionimin e duhur të tregut të brendshëm dhe për rrjedhojë, duhet të bazohet në nenin 114 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), siç interpretohet në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

5. Për të eliminuar pengesat që mbeten në tregtim dhe shtrembërimet e konkurrencës që rezultojnë nga divergjencat mes legjislacioneve të brendshme dhe për të parandaluar çdo pengesë të mundshme në tregti dhe shtrembërimet e konsiderueshme të konkurrencës, është e nevojshme të miratohet një rregullore për vendosjen e një interpretimi më uniform të kuadrit të BE-së për abuzimin me tregun, i cili i përcakton më qartë rregullat e zbatueshme në të gjithë shtetet anëtare. Hartimi i kërkesave të abuzimit në treg në formën e një rregulloreje do të garantonte që këto kërkesa të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo duhet të garantojë kushte uniforme duke parandaluar devijimet nga kërkesat kombëtare si rezultat i transpozimit të një direktive. Kjo rregullore do të kërkojë që të gjithë personat të ndjekin të njëjtat rregulla në të gjithë BE-në. Ajo do të reduktojë edhe kompleksitetin rregullator dhe kostot e shoqërive për zbatueshmërinë e saj, veçanërisht për shoqëritë që operojnë në baza ndërkufitare, dhe do të kontribuojë në eliminimin e shtrembërimeve të konkurrencës.

6. Komunikimi i Komisionit i 25 qershorit 2008 "Për një "Akt të Biznesit të Vogël" për Evropën" i bën thirrje BE-së dhe shteteve anëtare të saj të hartojnë rregulla për të reduktuar ngarkesat administrative, për të përshtatur legjislacionin me nevojat e emetuesve në tregjet për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të) dhe për të lehtësuar aksesin në financa për ata emetues. Një numër i dispozitave në Direktivën 2003/6/KE vendosin detyrime administrative për emetuesit, veçanërisht për ata, instrumentet financiare të të cilëve janë të pranuar në tregti në tregjet e rritjes së SME-ve, të cilat duhet të reduktohen.

7. Abuzimi në treg është një koncept që përfshin sjelljen e jashtëligjshme në tregjet financiare dhe, për qëllime të kësaj rregulloreje, duhet të kuptohet se përbëhet nga abuzimi me informacionet e privileguara, zbulimi i paligjshëm i informacionit të brendshëm dhe manipulimi i tregut. Kjo sjellje pengon transparencën e plotë dhe të përshtatshme të tregut, që është kusht i domosdoshëm tregtimi për të gjithë aktorët ekonomikë në tregjet financiare të integruara.

8. Fusha e veprimit e Direktivës 2003/6/KE e fokusuar në instrumentet financiarë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar ose për të cilin është bërë një kërkesë për praninë për tregtimin në një treg të tillë. Megjithatë, në vitet e fundit instrumentet financiare janë tregtuar gjithnjë e më shumë në platformat shumëpalëshe të tregtimit (MTF-të). Ekzistojnë gjithashtu instrumente financiare të cilat tregtohen vetëm në llojet e tjera të platformave shumëpalëshe të tregtimit (OTF-të) ose vetëm mbi banak (OTC). Për këtë arsye, fushëveprimi i kësaj rregulloreje duhet të përfshijë çdo instrument financiar të tregtueshëm në një treg të rregulluar, një MTF ose një OTF dhe çdo sjellje apo veprim tjetër që mund të ketë efekt në një instrument financiar të tillë pavarësisht nëse ai ndodh në një vend tregtimi. Në rastin e llojeve të caktuara të MTF-ve të cilat, si tregjet e rregulluara, ndihmojnë kompanitë për të ngritur financimin e kapitalit, ndalimi kundër abuzimit në treg zbatohet gjithashtu kur është bërë një kërkesë për praninë për tregtimin

në një treg të tillë. Prandaj, fushëveprimi i kësaj rregulloreje duhet të përfshijë instrumente financiare për të cilat është bërë një aplikim për pranim për tregtimin në një MTF. Kjo duhet të përmirësojë mbrojtjen e investitorëve, të ruajë integritetin e tregjeve dhe të sigurojë që abuzimi në treg i këtyre instrumenteve është i ndaluar në mënyrë të qartë.

9. Për qëllimet e transparencës, operatorët e një tregu të rregulluar, një MTF-je ose një OTF-je duhet të njoftojnë pa vonesë autoritetin e tyre kompetent për detajet e instrumenteve financiare të cilat ata kanë pranuar për tregtim, për të cilat ka pasur një kërkesë për pranim në tregtim ose që janë tregtuar në vendin e tyre të tregtimit. Kur instrumenti nuk pranohet më në tregtim, duhet të bëhet një njoftim i dytë. Këto detyrime duhet të zbatohen edhe për instrumentet financiare për të cilët ka pasur një kërkesë për pranim në tregtim në vendin e tyre të tregtimit dhe instrumentet financiare që janë pranuar në tregtim përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Njoftimet duhet t'i dorëzohen Autoritetit Evropian të Titujve dhe Tregjeve (ESMA) nga autoritetet kompetente dhe ESMA duhet të publikojë një listë të të gjitha instrumenteve financiare të njoftuara. Kjo rregullore zbatohet për instrumente financiare pavarësisht nëse ato janë të përfshira në listën e publikuar nga ESMA apo jo.

10. Ka mundësi që disa instrumente financiare të cilat nuk tregtohen në një vend tregtimi të përdoren për abuzimin në treg. Kjo përfshin instrumentet financiare, çmimi ose vlera e të cilave varet ose ka efekt në instrumentet financiare të tregtuara në një vend tregtimi, ose tregtimi i të cilave ndikon në çmimin ose vlerën e instrumenteve të tjerë financiarë të tregtueshëm në një vend tregtimi. Shembuj se ku mund të përdoren instrumente të tilla për abuzimin në treg përfshijnë informacionin e brendshëm në lidhje me një aksion ose obligacion, i cili mund të përdoret për të blerë një derivat të atij aksioni ose obligacioni ose një indeks vlera e të cilit varet nga ai aksion ose obligacion. Kur një instrument financiar përdoret si çmim referencë, mund të përdoret një derivat i tregtueshëm me OTC për të përfituar nga çmimet e manipuluar ose për të manipuluar çmimin e një instrumenti financiar të tregtueshëm në një vend tregtimi. Një shembull i mëtejshëm është emetimi i planifikuar i një kësti të ri të titujve që nuk janë pjesë e fushëveprimit të kësaj rregulloreje, por kur tregtimi i këtyre titujve mund të ndikojë në çmimin ose vlerën e titujve ekzistues të listuar që përfshihen në fushëveprimin e kësaj rregulloreje. Kjo rregullore mbulon gjithashtu situatën kur çmimi ose vlera e një instrumenti të tregtuar në një vend tregtimi varet nga një instrument i tregtueshëm me OTC. I njëjti parim duhet të zbatohet për kontratat e mallrave me çmime të cilat bazohen në atë të një derivati dhe në blerjen e kontratave spot të mallrave me të cilat referohen instrumente financiare.

11. Tregtimi me tituj apo instrumente të lidhura me ta për stabilizimin e titujve ose tregtimi në aksionet vetjake në programet e riblerjes mund të jetë e ligjshme për arsye ekonomike dhe prandaj, në rrethana të caktuara, duhet të përjashtohet nga ndalimet ndaj abuzimit në treg me kusht që veprimet të kryhen me transparencën e duhur, ku zbulohet informacioni përkatës që lidhet me stabilizimin ose programin e riblerjes.

12. Tregtia në aksione vetjake në programet e riblerjes dhe stabilizimi i një instrumenti financiar që nuk do të përfitonte nga përjashtimet sipas kësaj rregulloreje nuk do të konsiderohej në vetvete si një abuzim në treg.

13. Shtetet anëtare, anëtarët e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ), ministritë dhe agjencitë e tjera dhe automjetet që kanë qëllime të veçanta të një ose disa shteteve anëtare

dhe Bashkimit Evropian dhe disa organe të tjera publike ose persona që veprojnë në emër të tyre, nuk duhet të kufizohen në ndjekjen e politikës monetare, të kursit të këmbimit ose të menaxhimit të borxhit publik, për aq sa ato ndërmerren në interesin publik dhe vetëm në ndjekje të këtyre politikave. Po kështu as transaksionet ose urdhrat e kryer ose sjellja nga Bashkimi Evropian, nga një mjet për qëllime të veçanta të një ose disa shteteve anëtare, Banka Evropiane e Investimeve, Fondi Evropian i Stabilitetit Financiar, Mekanizmi Evropian i Stabilitetit ose një institucion financiar ndërkombëtar i krijuar nga dy ose më shumë shtete anëtare, nuk duhet të kufizohen në mobilizimin e financimit dhe në ofrimin e ndihmës financiare në dobi të anëtarëve të tyre. Një përjashtim i tillë nga fushëveprimi i kësaj rregulloreje, në përputhje me këtë rregullore, mund të përfshijë edhe organe të caktuara publike të ngarkuara me ose që ndërhyjnë në menaxhimin e borxhit publik dhe banka qendrore të vendeve të treta. Në të njëjtën kohë, përjashtimet për politikën monetare, kursin e këmbimit ose politikën e administrimit të borxhit publik nuk duhet të përfshijnë rastet kur këto organe angazhohen në transaksione, urdhra ose sjellje të ndryshme nga ato që ndjekin këto politika ose kur personat që punojnë për ato organe angazhohen në transaksione, urdhra apo sjellje për llogari të tyre.

14. Investitorët e arsyeshëm bazojnë vendimet e tyre të investimit në informacionin që tashmë është në dispozicion për ta, domethënë, në informacionin paraprak që është në dispozicion. Prandaj, pyetja nëse, gjatë marrjes së një vendimi për investime, një investitor i arsyeshëm ka të ngjarë të marrë parasysh një informacion të caktuar duhet të vlerësohet në bazë të informacionit paraprak që është në dispozicion. Një vlerësim i tillë duhet të marrë në konsideratë ndikimin e parashikuar të informacionit në kuadër të aktivitetit të emetuesit përkatës në tërësi, besueshmërinë e burimit të informacionit dhe çdo variabli tjetër tregu që ka gjasa të ndikojë te instrumentet financiare, kontratat përkatëse spot të mallrave, ose produktet e ankanduara bazuar në kuotat e emetimeve në rrethana të caktuara.

15. Informacioni i mëpasshëm mund të përdoret për të kontrolluar supozimin që informacioni paraprak ishte i ndjeshëm ndaj çmimeve, por nuk duhet të përdoret për të vepruar kundër personave që kanë nxjerrë përfundime të arsyeshme nga informacioni paraprak në dispozicion të tyre.

16. Kur informacioni i brendshëm ka të bëjë me një proces që ndodh në fazë, secila fazë e procesit, si dhe procesi i përgjithshëm mund të përbëjnë informacionin e brendshëm. Një hap i ndërmjetëm në një proces të zgjatur mund të përbëjë në vetvete një grup rrethanash ose një ngjarje që ekziston ose kur ekziston një mundësi reale që ato do të krijohen ose ndodhin, në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm të faktorëve ekzistues në kohën e caktuar. Megjithatë, ky nocion nuk duhet të interpretohet në kuptimin që madhësia e ndikimit të atij grupi rrethanash ose e asaj ngjarjeje mbi çmimet e instrumenteve financiare në fjalë, duhet të merret në konsideratë. Një hap i ndërmjetëm duhet të konsiderohet si informacion i brendshëm nëse ai, në vetvete, plotëson kriteret e përcaktuara në këtë rregullore për informacionin e brendshëm.

17. Informacioni që lidhet me një ngjarje ose një grup rrethanash që është një hap i ndërmjetëm në një proces të zgjatur, mund të lidhet, për shembull, me gjendjen e negociatave të kontratës, kushtet e dakorduara përkohësisht në negociatat e kontratës, mundësinë e vendosjes së instrumenteve financiare, kushtet sipas të cilave do të tregtohen instrumentet financiare, kushtet e përkohshme për vendosjen e instrumenteve financiare, ose mundësia për përfshirjen e një

instrumenti financiar në një indeks të madh apo fshirjen e një instrumenti financiar nga një indeks i tillë.

18. Siguria ligjore për pjesëmarrësit e tregut duhet të rritet përmes një përkufizimi më të afërt të dy elementeve thelbësore për përcaktimin e informacionit të brendshëm, përkatësisht natyrën e saktë të atij informacioni dhe rëndësinë e efektit të saj të mundshëm mbi çmimet e instrumenteve financiare, kontratat e mallrave, ose produktet e ankanduara bazuar në kuotat e emetimeve. Për derivatet të cilat janë produkte energjetike të tregtuara me shumicë, informacioni që kërkohet të zbulohet në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1227/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit⁵ duhet të konsiderohet në veçanti si informacion i brendshëm.

19. Kjo rregullore nuk ka për qëllim të ndalojë diskutimet e një natyre të përgjithshme në lidhje me zhvillimet e biznesit dhe të tregut midis aksionarëve dhe menaxhimit në lidhje me një emetues. Marrëdhëniet e tilla janë thelbësore për funksionimin efikas të tregjeve dhe nuk duhet të ndalohen me këtë rregullore.

20. Tregjet spot dhe tregjet përkatëse derivative janë shumë të ndërlidhura dhe globale, dhe abuzimi në treg mund të ndodhë në tregje si dhe në kufijtë të cilat mund të çojnë në rreziqe të mëdha sistemike. Kjo vlen si për abuzimin me informacionet e privilegjuara dhe për manipulimin e tregut. Në veçanti, informacioni i brendshëm nga një treg spot mund t'i shërbejë një personi që tregton në një treg financiar. Informacioni i brendshëm në lidhje me derivatin e një malli duhet të përkufizohet si informacion i cili plotëson përkufizimin e përgjithshëm të informacionit të brendshëm në lidhje me tregjet financiare dhe që duhet të publikohet në përputhje me dispozitat ligjore ose rregullatore të BE-së ose në nivel kombëtar, me rregullat e tregut, kontratat ose doganat në derivatin përkatës të mallit ose tregun spot. Shembuj të dukshëm të rregullave të tilla përfshijnë Rregulloren (BE) nr. 1227/2011 "Për tregun e energjisë dhe bazën e të dhënave për Iniciativën e Bazës së të Dhënave të Organizatave të Bashkuara (JODI) për naftën". Informacioni i tillë mund të shërbejë si bazë e vendimeve të pjesëmarrësve të tregut për të hyrë në derivatet e mallrave ose kontratat përkatëse spot të mallrave dhe për këtë arsye duhet të konsiderohen si informacion i brendshëm i cili duhet të bëhet publik, ku ka të ngjarë të ketë një efekt të rëndësishëm në çmimet e këtyre derivateve ose kontratat përkatëse spot të mallrave.

Për më tepër, strategjitë manipuluese mund të shtrihen edhe nëpër tregjet spot dhe ato të derivateve. Tregtimi i instrumenteve financiare, përfshirë derivatet e mallrave, mund të përdoret për të manipuluar kontratat përkatëse spot të mallrave dhe kontratat spot të mallrave mund të përdoren për të manipuluar instrumentet financiare përkatëse. Ndalimi i manipulimit të tregut duhet të përfshijë këto ndërlidhje. Megjithatë, nuk është e përshtatshme ose praktike të zgjerohet fushëveprimi i kësaj rregulloreje ndaj sjelljes që nuk përfshin instrumente financiare, për shembull, tregtimin e kontratave spot të mallrave që ndikon vetëm në tregun spot. Në rastin specifik të produkteve energjetike të tregtuara me shumicë, autoritetet kompetente duhet të marrin parasysh karakteristikat specifike të përkufizimeve të Rregullores (BE) nr. 1227/2011 kur ato zbatojnë përkufizimet e informacionit të brendshëm, abuzimit me informacionin e privilegjuar dhe manipulimin e tregut sipas kësaj rregulloreje ndaj instrumenteve financiare që lidhen me produktet energjetike të tregtuara me shumicë.

21. Sipas Direktivës 2003/87/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit⁶, Komisioni, shtetet anëtare dhe organe të tjera të përcaktuara zyrtarisht janë, ndër të tjera, përgjegjëse për

lëshimin teknik të kuotave të emetimit, alokimin e tyre falas për sektorët e duhur të industrisë dhe për pjesëtarët e rinj dhe më në përgjithësi zhvillimin dhe zbatimin e kuadrit të politikave klimatike të BE-së, i cili mbështet furnizimin me kuota emetimi për blerësit që përputhen me skemën e tregtimit të emetimeve të BE-së (ETS e BE-së). Në ushtrimin e këtyre detyrave, këto organe publike mund të kenë akses, ndër të tjera, në informacione të ndjeshme ndaj çmimeve dhe jo në publike dhe sipas Direktivës 2003/87/KE, mund të kenë nevojë të kryejnë operacione të caktuara të tregut në lidhje me kuotat e emetimeve. Si pasojë e klasifikimit të kuotave të emetimeve si instrumente financiare si pjesë e rishikimit të Direktivës 2004/39/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit⁷, ato instrumente gjithashtu përfshihen në fushëveprimin e kësaj rregulloreje.

Për të ruajtur aftësinë e Komisionit, shteteve anëtare dhe organeve të tjera të përcaktuara zyrtarisht për të zhvilluar dhe zbatuar politikën klimatike të BE-së, aktivitetet e atyre organeve publike, për sa kohë që ato janë ndërmarrë në interesin publik dhe në mënyrë të qartë në ndjekje të kësaj politike dhe në lidhje me kuotat e shkarkimeve, duhet të përjashtohen nga zbatimi i kësaj rregulloreje. Ky përjashtim nuk duhet të ketë një ndikim negativ në transparencën e përgjithshme të tregut, pasi që këto organe publike kanë detyrime ligjore për të vepruar në një mënyrë që siguron zbulimin e rregullt, të drejtë dhe jodiskriminues dhe aksesin në të gjitha vendimet, zhvillimet dhe të dhënat e reja që kanë një natyrë të ndjeshme ndaj çmimeve. Për më tepër, garancitë për zbulimin e drejtë dhe jodiskriminues të informacionit specifik të ndjeshëm ndaj çmimeve që mbahet nga autoritetet publike ekzistojnë nën Direktivën 2003/87/KE dhe masat zbatuese të miratuara në përputhje me to. Në të njëjtën kohë, përjashtimi për organet publike që veprojnë në ndjekje të politikës klimatike të BE-së nuk duhet të përfshijë rastet kur këto organe publike angazhohen në sjellje ose në transaksione që nuk ndjekin politikën klimatike të BE-së ose kur personat që punojnë për ato organe angazhohen në sjellje ose në transaksione për llogari të tyre.

22. Në përputhje me nenin 43 të TFBE-së dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura në kuadër të TFBE-së, Komisioni, shtetet anëtare dhe organet e tjera të përcaktuara zyrtarisht janë ndër të tjera, përgjegjëse për ndjekjen e Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB) dhe të Politikës së Përbashkët të Peshkimit (PPP). Në ushtrimin e këtyre detyrave, ato organe publike ndërmarrin aktivitete dhe masa që synojnë të menaxhojnë tregjet bujqësore dhe peshkimin, duke përfshirë ato të ndërhyrjes publike, duke imponuar ose pezulluar detyrimet e importit. Në dritën e fushëveprimit të kësaj rregulloreje, dispozitat e caktuara që zbatohen për kontratat spot të mallrave të cilat kanë ose mund të kenë ndikim në instrumentet financiare dhe instrumentet financiare vlera e të cilave varet nga vlera e kontratave spot të mallrave dhe që kanë ose mund të kenë një ndikim në kontratat spot të mallrave, duhet të sigurohet që nuk kufizohet veprimtaria e Komisionit, e shteteve anëtare dhe organeve të tjera të caktuara zyrtarisht për të ndjekur PPB-në dhe PPP-në. Për të ruajtur aftësinë e Komisionit, shteteve anëtare dhe organeve të tjera të përcaktuara zyrtarisht për të zhvilluar dhe ndjekur PPB-në dhe PPP-në, aktivitetet e tyre, për sa kohë që ato janë ndërmarrë në interesin publik dhe vetëm në ndjekje të këtyre politikave, duhet të përjashtohen nga zbatimi i kësaj rregulloreje. Ky përjashtim nuk duhet të ketë një ndikim negativ në transparencën e përgjithshme të tregut, pasi që këto organe publike kanë detyrime ligjore për të vepruar në një mënyrë që siguron zbulimin e rregullt, të drejtë dhe jodiskriminues dhe aksesin në të gjitha vendimet, zhvillimet dhe të dhënat e reja që kanë një natyrë të ndjeshme ndaj çmimeve. Në të njëjtën kohë, përjashtimi për organet publike që veprojnë sipas PPB-së dhe PPP-së nuk duhet të përfshijë rastet kur këto organe publike

angazhohen në sjellje ose në transaksione që nuk ndjekin PPB-në dhe PPP-në ose kur personat që punojnë për ato organe angazhohen në sjellje ose në transaksione për llogari të tyre.

23. Karakteristika thelbësore e abuzimit me informacionin e privilegjuar konsiston në një avantazh të padrejtë që merret nga informacioni i brendshëm në dëm të palëve të treta që nuk janë në dijeni të një informacioni të tillë dhe, rrjedhimisht, në dëmtimin e integritetit të tregjeve financiare dhe besimit të investitorëve. Rrjedhimisht, ndalimi i abuzimit me informacionin e privilegjuar duhet të zbatohet kur një person i cili zotëron informacione të brendshme përfiton padrejtësisht nga ai informacion, duke hyrë në transaksione të tregut në përputhje me atë informacion duke blerë ose shitur, duke u përpjekur të blejë ose të shesë, me anulimin ose ndryshimin, ose duke u përpjekur të anulojë ose ndryshojë një urdhër blerjeje ose shitjeje për llogarinë e tij ose për llogari të një pale të tretë, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, instrumentet financiare me të cilat lidhet informacioni. Përdorimi i informacionit të brendshëm mund të konsistojë gjithashtu në tregtimin e kuotave të emetimeve dhe derivateve të tyre dhe produkteve të tjera të ankanduara të bazuara në to që janë mbajtur sipas Rregullores së Komisionit (BE) nr. 1031/2010⁸.

24. Kur një person juridik ose fizik që zotëron informacione të brendshme, blen ose shet, ose përpiket të blejë ose të shesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për llogari të tij ose për llogari të një pale të tretë, instrumentet financiare me të cilat lidhet ai informacion, duhet të nënkuptohet se ai person e ka përdorur atë informacion. Ai supozim nuk cenon të drejtat e mbrojtjes. Pyetja nëse një person ka shkelur ndalimin për abuzimin me informacionin e privilegjuar ose është përpjekur të kryejë abuzim me informacionin e privilegjuar duhet të analizohet në kuadër të qëllimit të kësaj rregulloreje, që është mbrojtja e integritetit të tregut financiar dhe rritja e besimit të investitorëve, që bazohet, nga ana tjetër, në sigurimin se investitorët do të trajtohen njësoj dhe do të mbrohen nga keqpërdorimi i informacionit të brendshëm.

25. Urdhrat e bërë përpara se personi të ketë informacion të brendshëm nuk duhet të konsiderohet si abuzim me informacionin e privilegjuar. Megjithatë, kur personi zotëron informacion të brendshëm, duhet të supozohet se çdo ndryshim i mëvonshëm që lidhet me këtë informacion ndaj urdhrave të bërë përpara zotërimit të një informacioni të tillë, përfshirë anulimin ose ndryshimin e një urdhri ose një përpjekje për të anuluar ose ndryshuar një urdhër, përbën abuzim me informacionin e privilegjuar. Megjithatë, supozimi mund të kundërshtohet nëse personi vërteton se ai ose ajo nuk ka përdorur informacionin e brendshëm gjatë kryerjes së transaksionit.

26. Përdorimi i informacionit të brendshëm mund të jetë blerja ose shitja e një instrumenti financiar, ose një produkt i ankanduar në bazë të kuotave të emetimit, anulimi ose ndryshimi i një urdhri, ose përpjekjes për të blerë ose shitur një instrument financiar ose për të anuluar ose ndryshuar një urdhër, nga një person i cili ka dijeni, ose duhet të ketë pasur dijeni se informacioni është informacion i brendshëm. Në këtë aspekt, autoritetet kompetente duhet të marrin në konsideratë se për çfarë ka dijeni ose duhet të ketë pasur dijeni në ato rrethana një person normal dhe i arsyeshëm.

27. Kjo rregullore duhet të interpretohet në përputhje me masat e miratuara nga shtetet anëtare për mbrojtjen e interesave të mbajtësve të titujve të transferueshëm që kanë të drejtë vote

në një shoqëri (ose që mund të mbartin këto të drejta si pasojë e ushtrimit të të drejtave apo shndërrimit të tyre), kur shoqëria është objekt i një tenderi publik apo është propozuar për ndryshim kontrolli. Në veçanti, kjo rregullore duhet të interpretohet në përputhje me ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të miratuara në lidhje me ofertat e tenderave, transaksionet e përqendrimit dhe transaksionet e tjera që ndikojnë pronësinë ose kontrollin e shoqërive të rregulluara nga autoritetet mbikëqyrëse të emëruara nga shtetet anëtare sipas nenit 4 të Direktivës 2004/25/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit⁹.

28. Kërkimet dhe vlerësimet e bazuara në të dhënat publike në dispozicion, nuk duhet të konsiderohen në vetvete si informacion i brendshëm dhe vetëm fakti se një transaksion kryhet në bazë të kërkimeve ose vlerësimeve nuk duhet të konsiderohet si abuzim i informacionit të brendshëm. Megjithatë, për shembull, kur publikimi ose shpërndarja e informacionit pritet në mënyrë rutinore nga tregu dhe ku një publikim ose shpërndarje e tillë kontribuon në procesin e krijimit të çmimeve të instrumenteve financiare, ose informacioni jep pikëpamje nga një komentues ose institucion i njohur i tregut që mund të japë çmimet e instrumenteve financiare përkatëse, informacioni mund të përbëjë informacion të brendshëm. Aktorët e tregut duhet të marrin parasysh masën në të cilën informacioni është jopublik dhe ndikimin e mundshëm mbi instrumentet financiare të tregtuara përpara publikimit ose shpërndarjes së tij, për të përcaktuar nëse ato do të tregtonin në bazë të informacionit të brendshëm.

29. Në mënyrë që të shmangen forma të ndaluara të veprimtarisë financiare që janë të ligjshme, domethënë kur nuk ka efekt të abuzimit në treg, një sjellje e ligjshme e caktuar duhet të njihet. Kjo mund të përfshijë, për shembull, njohjen e rolit të personave që bëjnë tregun, kur veprojnë në cilësinë legjitime të ofrimit të likuiditetit të tregut.

30. Vetë fakti se personat që bëjnë tregun ose personat e autorizuar për të vepruar si palë të tjera e kufizojnë veten në ndjekjen e biznesit të ligjshëm të blerjes ose shitjes së instrumenteve financiare ose që personat e autorizuar për të ekzekutuar urdhrat në emër të palëve të treta me informacion të brendshëm kufizohen në kryerjen, anulimin ose ndryshimin e një urdhri siç duhet, nuk duhet të konsiderohet si përdorim i një informacioni të tillë të brendshëm. Megjithatë, mbrojtja, e përcaktuar në këtë rregullore, e personave që bëjnë tregun, organeve të autorizuara për të vepruar si palë të tjera ose persona të autorizuar për të ekzekutuar urdhrat në emër të palëve të treta me informacione të brendshme, nuk përfshihet në veprimtari të ndaluara qartë sipas kësaj rregulloreje, duke përfshirë, për shembull, praktikën e njohur zakonisht si "drejtim frontal". Aty ku personat juridikë kanë marrë të gjitha masat e arsyeshme për të parandaluar abuzimin në treg, por megjithatë personat fizikë brenda punësimit të tyre kryejnë abuzime në treg në emër të personit juridik, kjo nuk duhet të konsiderohet si abuzim në treg nga personi juridik. Një shembull tjetër që nuk duhet të konsiderohet si përdorim i informacionit të brendshëm janë transaksionet e kryera gjatë mbylljes së një detyrimi paraprak që duhet paguar. Aksesit në informacionin e brendshëm në lidhje me një kompani tjetër dhe përdorimi i tij për një tender publik me qëllim që të fitojë kontrollin e asaj kompanie apo propozimi për një bashkim me atë kompani nuk përbën abuzim me informacionet e privileguara.

31. Meqenëse blerja apo shitja e instrumenteve financiare domosdoshmërisht parashikon që personi i cili ndërmerr ndonjë nga këto veprime të marrë një vendim paraprak për blerjen apo shitjen e tyre, kjo blerje apo shitje nuk konsiderohet si përdorim i informacionit të brendshëm. Veprimi në bazë të planeve dhe strategjive vetjake për tregti nuk duhet të konsiderohet si

përdorim i informacionit të brendshëm. Megjithatë, asnjë nga personat juridikë ose fizikë nuk duhet të mbrohet për shkak të funksionit të tyre profesional; ata duhet të mbrohen vetëm nëse veprojnë në mënyrën e duhur dhe të përshtatshme, duke përmbytur si standardet që priten nga profesioni i tyre dhe si ato nga kjo rregullore, përkatësisht integriteti i tregut dhe mbrojtja e investitorëve. Mund të konsiderohet se ka ndodhur një shkelje nëse autoriteti kompetent konstaton se ka pasur një arsye të jashtëligjshme pas atyre transaksioneve ose urdhrave ose sjelljes, ose se personi ka përdorur informacion të brendshëm.

32. Sondazhet e tregut janë ndërveprimet ndërmjet një shitësi të instrumenteve financiare dhe një ose më shumë investitorëve potencialë, përpara shpalljes së një transaksioni, me qëllim që të vlerësohet interesi i investitorëve potencialë në një transaksion të mundshëm dhe çmimin, madhësinë dhe strukturimin e tyre. Sondazhet e tregut mund të përfshijnë një ofertë fillestare ose dytësore të titujve përkatës dhe dallojnë nga tregtia e zakonshme. Ato janë një mjet shumë i vlefshëm për të vlerësuar mendimin e investitorëve potencialë, për të rritur dialogun e aksionarëve, për të siguruar që marrëveshjet të funksionojnë normalisht dhe se pikëpamjet e emetuesve, aksionarëve ekzistues dhe investitorëve të rinj potencialë janë të përafërta. Ato mund të jenë veçanërisht të dobishme kur tregjet nuk kanë besim ose një pikë referimi përkatëse, ose janë të paqëndrueshme. Kështu, aftësia për të kryer sondazhe të tregut është e rëndësishme për funksionimin e duhur të tregjeve financiare dhe sondazhet e tregut nuk duhet të konsiderohen në vetvete si abuzime në treg.

33. Shembuj të sondazheve të tregut përfshijnë situata në të cilat firma shitëse ka qenë në diskutime me një emetues në lidhje me një transaksion të mundshëm dhe ka vendosur të vlerësojë interesin potencial të investitorit për të përcaktuar kushtet që do të përbëjnë një transaksion; ku një emetues ka për qëllim të shpallë një emetim të borxhit ose një ofertë shtesë të kapitalit dhe investitorët kryesorë janë kontaktuar nga një firmë shitëse dhe duke marrë parasysh kushtet e plota të marrëveshjes për të marrë një angazhim financiar për të marrë pjesë në transaksion; ose ku pala e shitjes po kërkon të shesë një sasi të madhe të titujve në emër të një investitori dhe kërkon të vlerësojë interesin potencial ndaj atyre titujve nga investitorë të tjerë potencialë.

34. Kryerja e sondazheve të tregut mund të kërkojë zbulimin e investitorëve potencialë të informacionit të brendshëm. Në përgjithësi do të jetë vetëm potenciali për të përfutur financiarisht nga tregtimi në bazë të informacionit të brendshëm të kaluar në një sondazh tregu ku ka një treg ekzistues në instrumentin financiar që është subjekt i sondazhit të tregut ose në një instrumenti financiar përkatës. Duke pasur parasysh kohën e diskutimeve të tilla, është e mundur që informacioni i brendshëm të zbulohet tek investitori potencial gjatë sondazhit të tregut pasi një instrument financiar është pranuar për tregtim në një treg të rregulluar ose është tregtuar në një MTF ose një OTF. Para se të përfshihet në sondazhi e tregut, pjesëmarrësi zbulues i tregut duhet të vlerësojë nëse ai do të përfshijë zbulimin e informacionit të brendshëm.

35. Informacioni i brendshëm duhet të konsiderohet si i zbuluar në mënyrë të ligjshme nëse zbulohet në rrjedhën normale të ushtrimit të punës, profesionit ose detyrave të një personi. Kur një sondazh tregu përfshin zbulimin e informacionit të brendshëm, pjesëmarrësi zbulues i tregut do të konsiderohet se vepron brenda rrjedhës normale të punës, profesionit ose detyrave të tij, kur, në kohën e zbulimit, ai njofton dhe merr pëlqimin e personit të cilit i bëhet zbulimi që atij mund t'i jepet informacionin i brendshëm; se ai do të kufizohet nga dispozitat e kësaj rregulloreje

nga tregtimi ose veprimi sipas atij informacioni; që duhet të ndërmerren hapa të arsyeshëm për të mbrojtur konfidencialitetin e vazhdueshëm të informacionit; dhe se ai duhet të informojë pjesëmarrësin zbulues të tregut për identitetet e të gjithë personave fizikë dhe juridikë të cilëve u është dhënë informacioni gjatë zhvillimit të një sondazhi në treg. Pjesëmarrësi zbulues i tregut duhet gjithashtu të përmbushë detyrimet që do të përcaktohen me detaje në standardet teknike rregullatore, lidhur me mbajtjen e shënimeve të informacionit të zbuluar. Nuk duhet të ketë prezumim se pjesëmarrësit e tregut që nuk janë në përputhje me këtë rregullore gjatë kryerjes së një sondazhi tregu, kanë zbuluar në mënyrë të paligjshme informacionin e brendshëm, por nuk duhet të jenë në gjendje të përfitojnë nga përjashtimi që u është dhënë atyre që janë pajtuar me këto dispozita. Çështja nëse ata kanë shkelur ndalimin e zbulimit të paligjshëm të informacionit të brendshëm duhet të analizohet në kuadër të të gjitha dispozitave përkatëse të kësaj rregulloreje dhe të gjithë pjesëmarrësit zbulues të tregut duhet të jenë të detyruar të regjistrojnë me shkrim vlerësimin e tyre, para se të angazhohen në një sondazh tregu, nëse ky i fundit do të përfshijë zbulimin e informacionit të brendshëm.

36. Investitorët potencialë të cilët janë subjekt i një sondazhi tregu duhet, nga ana tjetër, të marrin në konsideratë nëse informacioni që u është zbuluar atyre përbën informacionin e brendshëm i cili do t'i ndalonte ata që të tregtonin në bazë të tij apo zbulimin e mëtejshëm të atij informacioni. Investitorët potencialë u nënshtrohen rregullave për abuzimi me informacionin e privilegjuar dhe zbulimin e paligjshëm të informacionit të brendshëm, siç përcaktohet në këtë rregullore. Për të ndihmuar investitorët potencialë në konsideratat e tyre dhe në lidhje me hapat që duhet të ndërmarrin për të mos shkelur këtë rregullore, ESMA duhet të nxjerrë udhëzime.

37. Rregullorja (BE) nr. 1031/2010 parashikon dy regjime paralele të abuzimit në treg të zbatueshme për ankandet e kuotave të shkarkimeve. Megjithatë, si pasojë e klasifikimit të kuotës së emetimeve si instrumente financiare, kjo rregullore duhet të përbëjë një libër të vetëm rregullash mbi masat e abuzimit në tregu të zbatueshme në tërësinë e tregjeve kryesore dhe dytësore në kuotat e emetimeve. Kjo rregullore duhet të zbatohet gjithashtu për sjelljet ose transaksionet, duke përfshirë ofertat, në lidhje me nxjerrjen në një platformë ankandi të autorizuar si treg i rregulluar të kuotave të emetimeve ose të produkteve të tjera të nxjerra në ankand që bazohen në to, edhe kur këto produkte nuk janë instrumente financiare, sipas Rregullores (BE) nr. 1031/2010.

38. Kjo rregullore duhet të sigurojë masa për sa i përket manipulimit të tregut që mund të përshtaten në forma të reja të tregtimit ose strategji të reja që mund të jenë abuzive. Për të pasqyruar faktin se tregtimi në instrumente financiarë automatizohet gjithnjë e më shumë, është e dëshirueshme që përkufizimi i manipulimit të tregut të ofrojë shembuj të strategjive specifike abuzive që mund të kryhen nga çdo mjet i disponueshëm i tregtimit duke përfshirë tregtimin algoritmik dhe me frekuencë të lartë. Shembujt e ofruar nuk synojnë të jenë shterues dhe as të sugjerojnë se të njëjtat strategji të kryera me mjete të tjera nuk do të ishin gjithashtu abuzive.

39. Ndalimet kundër abuzimit në treg duhet të mbulojnë edhe ata persona që veprojnë në bashkëpunim për ta kryer atë. Shembujt mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në, brokerat që krijojnë dhe rekomandojnë një strategji tregtie të projektuar që të çojë në abuzim në treg, persona që inkurajojnë një person me informacion të brendshëm për ta zbuluar atë informacion në mënyrë të paligjshme ose për personat që zhvillojnë softuer në bashkëpunim me një tregtar me qëllim lehtësimin e abuzimit në treg.

40. Për të siguruar që përgjegjësia i jepet personit juridik dhe çdo personi fizik që merr pjesë në vendimmarrjen e personit juridik, është e nevojshme të njohësh mekanizmat e ndryshëm të legjislacionit të brendshëm në shtetet anëtare. Mekanizma të tillë duhet të lidhen drejtpërdrejt me metodat e atribuimit të përgjegjësisë në legjislacionin e brendshëm.

41. Për të plotësuar ndalimin e manipulimit të tregut, kjo rregullore duhet të përfshijë një ndalim kundër përpjekjes për t'u angazhuar në manipulimin e tregut. Një përpjekje për t'u angazhuar në manipulimin e tregut duhet të dallohet nga sjellja e cila ka gjasa të rezultojë në manipulimin e tregut pasi të dy aktivitetet janë të ndaluara sipas kësaj rregulloreje. Një përpjekje e tillë mund të përfshijë situata ku aktiviteti ka nisur, por nuk ka përfunduar, për shembull si rezultat i një teknologjie të dështuar ose një udhëzimi për të tregtuar sipas të cilit nuk është vepruar. Ndalimi i përpjekjeve për t'u angazhuar në manipulimin e tregut është i nevojshëm për t'u mundësuar autoriteteve kompetente të vendosin sanksione për përpjekje të tilla.

42. Pa cenuar qëllimin e kësaj rregulloreje dhe dispozitat e saj drejtpërdrejt të zbatueshme, një person i cili bën transaksione ose emeton urdhra për tregtim, të cilat janë elementë përbërës të manipulimit të tregut, mund të vërtetohet se arsyet e tij për të hyrë në të tilla transaksione ose për të emetuar urdhra të tillë për tregtim ishin të ligjshme dhe se transaksionet dhe urdhrat për tregtim ishin në përputhje me praktikën e pranuar në tregun e rregulluar në fjalë. Një praktikë e pranuar tregtimi mund të vendoset nga autoriteti kompetent përgjegjës për mbikëqyrjen e abuzimit në treg të tregut në fjalë. Një praktikë e pranuar në një treg të caktuar nuk mund të konsiderohet e zbatueshme për tregjet e tjera përveç nëse autoritetet kompetente të tregjeve të tjera të tilla e kanë pranuar zyrtarisht atë praktikë. Mund të konsiderohet se ka ndodhur një shkelje nëse autoriteti kompetent vërteton se ekzistonte një arsye tjetër e jashtëligjshme pas këtyre transaksioneve apo urdhrave për tregtim.

43. Kjo rregullore duhet gjithashtu të sqarojë se angazhimi në manipulimin e tregut ose përpjekjet për t'u angazhuar në manipulimin e tregut në një instrument financiar mund të marrë formën e përdorimit të instrumenteve financiare përkatëse, siç janë instrumentet derivative që tregtohen në një vend tjetër tregtar ose në një OTC.

44. Çmimi i një numri të madh instrumentesh financiare vendoset duke ju referuar pikave të referimit. Manipulimi aktual ose përpjekja për manipulimin e referencave, duke përfshirë normat e ofertës ndërbankare, mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në besimin e tregut dhe mund të rezultojë në humbje të konsiderueshme për investitorët ose në shtrembërimin e ekonomisë reale. Prandaj, kërkohen dispozita specifike në lidhje me standardet e ruajtjes së integritetit të tregjeve dhe për të siguruar që autoritetet kompetente mund të zbatojnë një ndalim të qartë të manipulimit të kriterëve. Këto dispozita duhet të mbulojnë të gjitha standardet e publikuara, duke përfshirë ato që janë të aksesueshme nëpërmjet internetit, qoftë falas ose jo, siç janë standardet e CDS-së dhe indekset e indekseve. Duhet të plotësohet ndalimi i përgjithshëm i manipulimit të tregut duke ndaluar manipulimin e vetë standardit dhe transmetimin e informacionit të rremë ose çorientues, dhënien e inputeve të rreme ose çorientuese, ose çdo veprim tjetër që manipulon llogaritjen e një pikë referimi, aty ku ajo llogaritje është përcaktuar gjerësisht për të përfshirë marrjen dhe vlerësimin e të gjitha të dhënave që lidhen me llogaritjen e atij standardi dhe të përfshijë në veçanti të dhënat e shkurta, dhe duke përfshirë metodologjinë e pikave të referimit, qoftë ajo algoritmike ose e bazuar në gjykimin tërësor apo të pjesshëm. Këto rregulla janë përveç Rregullores (BE) nr. 1227/2011 e cila ndalon ofrimin e qëllimshëm të

informacionit të rremë për ndërmarrjet të cilat ofrojnë vlerësime të çmimeve ose raportet e tregut për produktet energjetike me shumicë me qëllim çorientimin e pjesëmarrësve të tregut që veprojnë në bazë të këtyre vlerësimeve të çmimeve ose raporteve të tregut.

45. Për të siguruar kushte të njëjta të tregut ndërmjet vendeve të tregtimit dhe objekteve që i nënshtrohen kësaj rregulloreje, çdo person që vepron në tregje të rregulluara, MTF dhe OTF, duhet të krijojë dhe të ruajë marrëveshje, sisteme dhe procedura efektive për parandalimin dhe zbulimin e manipulimit të tregut dhe praktikave abuzive.

46. Manipulimi ose përpjekja për të manipuluar instrumentet financiare mund të konsistojë në vendosjen e urdhrave që nuk mund të ekzekutohen. Për më tepër, një instrument financiar mund të manipulohet nëpërmjet sjelljes që ndodh jashtë një vendi tregtimi. Personat që rregullojnë ose ekzekutojnë transaksionet në mënyrë profesionale, duhet të krijojnë dhe ruajnë marrëveshje, sisteme dhe procedura efektive për zbulimin dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta. Ata gjithashtu duhet të raportojnë urdhra dhe transaksione të dyshimta që ndodhin jashtë një vendi tregtimi.

47. Manipulimi ose përpjekja për manipulimin e instrumenteve financiare mund të konsistojë në shpërndarjen e informacionit të rremë ose çorientues. Përhapja e informacionit të rremë ose çorientues mund të ndikojë ndjeshëm në çmimet e instrumenteve financiare në një periudhë relativisht të shkurtër kohore. Mund të konsistojë në shpikjen e informacionit të rremë, por edhe në lëshimin me paramendim të fakteve materiale, si dhe në raportimin e pasaktë të informacionit. Kjo formë e manipulimit të tregut është veçanërisht e dëmshme për investitorët, sepse bën ata të mbështesin vendimet e tyre për investimet në informacione të pasakta ose të shtrembëruara. Është gjithashtu e dëmshme për emetuesit, sepse zvogëlon besimin në informacionin e disponueshëm që lidhet me ta. Mungesa e besimit në tregu mund të rrezikojë aftësinë e një emetuesi për të nxjerrë instrumente të reja financiare ose për të siguruar kredi nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut për të financuar operacionet e tij. Informacioni përhapet në treg shumë shpejt. Si rezultat, dëmi ndaj investitorëve dhe emetuesve mund të vazhdojë për një kohë relativisht të gjatë derisa informacioni të vërtetohet se është i rremë apo çorientues dhe të mund të korrigjohet nga emetuesi ose ata që janë përgjegjës për shpërndarjen e tij. Prandaj është e nevojshme që përhapja e informacionit të rremë ose çorientues, duke përfshirë thashethemet dhe lajmet e rreme ose çorientuese, të kualifikohet si shkelje e kësaj rregulloreje. Prandaj është e përshtatshme që të mos i lejojnë ata që veprojnë në tregjet financiare që të shprehin lirisht informacion në kundërshtim me mendimin e tyre ose gjykimin më të mirë, të cilin ata e dinë ose duhet ta dinë si të rremë apo çorientues, në dëm të investitorëve dhe emetuesve.

48. Duke pasur parasysh rritjen e përdorimit të faqeve të internetit, blogjeve dhe mediave sociale, është e rëndësishme të qartësohet se shpërndarja e informacionit të rremë ose çorientues nëpërmjet internetit, duke përfshirë faqet e mediave sociale ose blogjet jotransparente, duhet të konsiderohet, për qëllime të kësaj rregulloreje, si ekuivalent e bërjes së kësaj nëpërmjet kanaleve tradicionale të komunikimit.

49. Zbulimi i informacionit të brendshëm nga një emetues është thelbësor për të shmangur abuzimin me informacionin e privilegjuar dhe për të siguruar që investitorët të mos mashtrohen. Prandaj, emetuesit duhet të informojnë publikun sa më parë të jetë e mundur për informacionin e brendshëm. Megjithatë, ky detyrim, në rrethana të veçanta, mund të cenojë

interesat e ligjshme të emetuesit. Në rrethana të tilla, zbulimi i vonuar duhet të lejohet me kusht që vonesa të mos ketë mundësi të çorientojë publikun dhe emetuesi të jetë në gjendje të sigurojë konfidencialitetin e informacionit. Emetuesi ka detyrimin të zbulojë informacionin e brendshëm vetëm nëse ka kërkuar ose ka miratuar pranimin e instrumentit financiar në tregtim.

50. Për qëllimet e zbatimit të kërkesave që kanë të bëjnë me zbulimin publik të informacionit të brendshëm dhe vonimit të publikimit të tillë, siç parashikohet në këtë rregullore, interesat e ligjshme mund të lidhen në veçanti me rrethanat e mëposhtme jo shteruese: a) negociatat e vazhdueshme, ose elementet përkatëse, ku rezultati ose modeli normal i këtyre negociatave ka gjasa të ndikohet nga publikimi. Në veçanti, në rast se qëndrueshmëria financiare e emetuesit është në rrezik të rëndë dhe të afërt, edhe pse nuk është në kuadër të legjislacionit për paaftësinë paguese, zbulimi i informacionit publik mund të shtyhet për një periudhë të kufizuar, kur një zbulim i tillë publik do të rrezikonte seriozisht interesin e aksionarëve ekzistues dhe potencialë duke minuar përfundimin e negociatave specifike të hartuara për të siguruar rikuperimin afatgjatë të emetuesit; b) vendimet e marra ose kontratat e bëra nga organi drejtues i një emetuesi që kanë nevojë për miratimin e një organi tjetër të emetuesit për të hyrë në fuqi, kur organizimi i një emetuesi të tillë kërkon ndarjen midis këtyre organeve, me kusht që zbulimi publik i informacioni përpara miratimit të tillë, së bashku me njoftimin e njëkohshëm se miratimi mbetet në pritje, do të rrezikonte vlerësimin e saktë të informacionit nga publiku.

51. Për më tepër, kërkesa për të zbuluar informacionin e brendshëm duhet t'u adresohet pjesëmarrësve në tregun e kuotave të emetimeve. Për të shmangur ekspozimin e tregut ndaj raportimit të padobishëm dhe për të ruajtur kosto-efikasitetin e masës së parashikuar, duket se është e domosdoshme të kufizohet ndikimi rregullator i kësaj kërkesë vetëm ndaj atyre operatorëve të BE ETS-së nga të cilët, për shkak të madhësisë dhe veprimtarisë së tyre, mund të pritët që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në çmimin e kuotave emetimit, të produkteve të ankanduara në bazë të tij, ose të instrumenteve financiare derivative që lidhen me to dhe për të bërë oferta në ankand sipas Rregullores (BE) nr. 1031/2010. Komisioni duhet të miratojë masa që përcaktojnë një prag minimal për qëllimet e zbatimit të atij përjashtimi me anë të një akti të deleguar. Informacioni që do të zbulohet duhet të ketë të bëjë me operacionet fizike të palës që zbulon informacionin dhe jo të planeve ose strategjive të saj për tregtimin e emetimeve, produktet e ankanduara të bazuara në të, ose instrumentet financiare derivative që lidhen me to. Aty ku pjesëmarrësit e tregut të kuotave të emetimit janë në përputhje me kërkesat e barasvlershme të zbulimit të informacionit, sidomos në pajtim me Rregulloren (BE) nr. 1227/2011, detyrimi për të zbuluar informacionin e brendshëm në lidhje me kuotat e emetimit nuk duhet të çojë në dyfishimin e dhënies së informacioneve të detyrueshme që kanë përmbajtje të njëjtë në thelb. Në rastin e pjesëmarrësve në tregun e kuotave të emetimeve me emetime agregate ose të dhëna termike nominale në ose nën përcaktimin e pragut, pasi informacioni në lidhje me operacionet e tyre fizike konsiderohet jo-material për qëllime të zbulimit, gjithashtu duhet të konsiderohet sikur nuk ka një ndikim të rëndësishëm në çmimin e kuotave të emetimit, të produkteve të ankanduara në bazë të tyre, ose të instrumenteve financiare derivative që lidhen me to. Megjithatë, pjesëmarrësit e tillë në tregun e kuotave të emetimeve duhet të mbulohen nga ndalimi i abuzimit me informacionin e brendshëm në lidhje me çdo informacion tjetër në të cilin ata kanë akses dhe që është informacion i brendshëm.

52. Për të mbrojtur interesin publik, për të ruajtur stabilitetin e sistemit financiar dhe për shembull për të shmangur krizat e likuiditetit në institucionet financiare nga shndërrimi i tyre në

kriza të aftësisë paguese për shkak të tërheqjes së papritur të fondeve, mund të jetë e përshtatshme të lejohet, në rrethana të jashtëzakonshme, vonesa e zbulimit të informacionit të brendshëm për institucionet e kredisë ose për ato financiare. Kjo mund të zbatohet në veçanti për informacionin që lidhet me problemet e përkohshme të likuiditetit, ku ata duhet të marrin hua nga banka qendrore duke përfshirë asistencën emergjente të likuiditetit nga një bankë qendrore ku zbulimi i informacionit do të kishte një ndikim sistemik. Kjo vonesë duhet të kushtëzohet me dhënien e pëlqimit nga autoriteti përkatës kompetent dhe duke qenë i qartë se interesi më i gjerë publik dhe ekonomik në shtyrjen e zbulimit tejkalon interesin e tregut në marrjen e informacionit që është subjekt i vonesës.

53. Për sa u përket institucioneve financiare, në veçanti kur ato marrin hua nga banka qendrore, duke përfshirë asistencën emergjente të likuiditetit, vlerësimi nëse informacioni është me rëndësi sistematike dhe nëse vonesa e zbulimit është në interes të publikut duhet të bëhet nga autoriteti kompetent, pas konsultimit me, sipas rastit, bankën qendrore kombëtare, autoritetin makroprudencial ose çdo autoritet tjetër përkatës kombëtar.

54. Përdorimi ose përpjekja për të përdorur informacionin e brendshëm për të tregtuar për llogarinë e tij ose për llogari të një pale të tretë, duhet të ndalohej në mënyrë të qartë. Përdorimi i informacionit të brendshëm mund të konsistojë gjithashtu në tregtimin e kuotave të emetimeve dhe derivateve të tyre dhe produkteve të tjera të ankanduar të bazuara në to që janë mbajtur sipas Rregullores së Komisionit (BE) nr. 1031/2010 nga persona të cilët kanë dijeni ose duhet të kenë dijeni, se informacioni që ata zotërojnë përbën informacion të brendshëm. Informacioni në lidhje me planet dhe strategjitë e vetë pjesëmarrësit të tregut për tregtinë, nuk duhet të konsiderohet si informacion i brendshëm, megjithëse informacioni në lidhje me planet dhe strategjitë e një tregtari të një pale të tretë mund të përbëjë informacion të brendshëm.

55. Kërkesa për të zbuluar informacionin e brendshëm mund të jetë e tepërt për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, siç përcaktohet në Direktivën 2014/65/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit¹⁰, instrumentet financiare të cilave janë të pranuar në tregti në tregjet e rritjes së SME-ve, duke pasur parasysh kostot e monitorimit të informacionit që kanë në zotërim dhe duke kërkuar këshilla ligjore nëse dhe kur duhet të zbulohet informacioni. Megjithatë, zbulimi i menjëhershëm i informacionit të brendshëm është thelbësor për të siguruar besimin e investitorëve në ata emetues. Prandaj, ESMA duhet të jetë në gjendje të lëshojë udhëzime që i ndihmojnë emetuesit për të përmbushur detyrimin e zbulimit të informacionit të brendshëm pa kompromentuar mbrojtjen e investitorëve.

56. Listat e personave të brendshëm janë një mjet i rëndësishëm për rregullatorët kur hetojnë mundësinë e abuzimit të mundshëm në treg, por dallimet kombëtare në lidhje me të dhënat që përfshihen në ato lista imponojnë detyrime administrative të panevojshme ndaj emetuesve. Fushat e të dhënave të kërkuara për listat e personave të brendshëm duhet të jenë të njëtrajtshme në mënyrë që të zvogëlohen këto kosto. Është e rëndësishme që personat e përfshirë në listat e personave të brendshëm të informohen për këtë fakt dhe për implikimet e tij sipas kësaj rregulloreje dhe Direktivës 2014/57/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹¹. Kërkesa për të mbajtur dhe përditësuar vazhdimisht listat e personave të brendshëm imponon detyrime administrative në mënyrë specifike për emetuesit në tregjet e rritjes së SME-ve. Duke qenë se autoritetet kompetente janë në gjendje të ushtrjnë mbikëqyrje efektive të abuzimit në treg pa i pasur këto lista në dispozicion gjatë gjithë kohës për ata emetues, ato duhet të përjashtohen nga

ky detyrim me qëllim të reduktimit të shpenzimeve administrative të vendosura nga kjo rregullore. Megjithatë, emetuesit e tillë duhet të ofrojnë një listë të personave të brendshëm tek autoritetet kompetente sipas kërkesës.

57. Vendosja, nga emetuesit ose çdo person që vepron në emër ose për llogari të tyre, të listave të personave që punojnë për ta në bazë të një kontrate pune ose në ndonjë mënyrë tjetër dhe që kanë akses në informacione të brendshme që lidhen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me emetuesit është një masë e vlefshme për mbrojtjen e integritetit të tregut. Listat e tilla mund t'u shërbejnë emetuesve ose personave të tillë për të kontrolluar rrjedhën e informacionit të brendshëm dhe në këtë mënyrë të ndihmojnë në menaxhimin e detyrave të tyre të konfidencialitetit. Për më tepër, listat e tilla mund të përbëjnë një mjet të dobishëm për autoritetet kompetente për të identifikuar çdo person që ka akses në informacionin e brendshëm dhe datën në të cilën ata kanë fituar akses. Aksesit në informatat e brendshme që lidhen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me emetuesit nga personat e përfshirë në një listë të tillë, nuk cenon ndalimet e përcaktuara në këtë rregullore.

58. Një tjetër masë parandaluese kundër abuzimit me tregun, në veçanti abuzimit me informacionin e brendshëm, është edhe vendosja e një transparencë më të madhe të transaksioneve të kryera nga persona me përgjegjësi drejtuese në nivel emetuesi dhe, kur është e zbatueshme, edhe nga persona të lidhur ngushtë me ta. Edhe publikimi i këtyre transaksioneve të paktën në baza individuale mund të jetë një burim shumë i vlefshëm i informacionit për investitorët. Është e nevojshme të qartësohet se detyrimi për të publikuar transaksionet e këtyre menaxherëve përfshin gjithashtu premtimin ose huadhënien e instrumenteve financiare, pasi zotimi i aksioneve mund të rezultojë në një ndikim material dhe potencialisht destabilizues ndaj kompanisë në rast të një humbje të papritur dhe të paparashikuar. Pa zbulimin, tregu nuk do të dinte se ekziston mundësia e rritur, për shembull, e një ndryshimi të rëndësishëm në aksione në të ardhmen, një rritje e ofertës së aksioneve në treg ose një humbje e të drejtave të votës në atë shoqëri. Për këtë arsye, njoftimi sipas kësaj rregulloreje kërkohet kur lënia peng e titujve është kryer si pjesë e një transaksioni më të gjerë në të cilin menaxherët vendosin titujt si kolateral për të fituar kredi nga një palë e tretë. Përveç kësaj, transparenca e plotë dhe e duhur e tregut është një parakusht për besimin e aktorëve të tregut dhe, në veçanti, besimin e aksionarëve të një shoqërie. Është gjithashtu e nevojshme të qartësohet se detyrimi për të publikuar transaksionet e këtyre menaxherëve përfshin transaksione nga një person tjetër që ushtron gjykimin për menaxherin. Në mënyrë që të sigurohet ekuilibri i duhur ndërmjet nivelit të transparencës dhe numrit të raporteve të njoftuara tek autoritetet kompetente dhe publiku, në këtë rregullore duhet të futen pragje nën të cilat nuk duhet të njoftohen transaksionet.

59. Njoftimi i transaksioneve të kryera nga personat me përgjegjësi drejtuese për llogari të tyre, ose nga një person i lidhur ngushtë me ta, nuk është vetëm informacion i vlefshëm për pjesëmarrësit në treg, por gjithashtu përbën një mjet shtesë për mbikëqyrjen e tregjeve për autoritetet kompetente. Detyrimi për të njoftuar transaksionet nuk cenon ndalimet e përcaktuara në këtë rregullore.

60. Njoftimi i transaksioneve duhet të jetë në përputhje me rregullat për transferimin e të dhënave personale të përcaktuara në Direktivën 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹².

61. Personat me përgjegjësi drejtuese duhet të ndalohen të tregtojnë para shpalljes së raportit të përkohshëm financiar ose raportit të fundvitit që emetuesi përkatës është i detyruar të bëjë publik sipas rregullave të vendit të tregtimit ku aksionet e emetuesit janë pranuar për tregtim ose sipas legjislacionit të brendshëm, përveç nëse ekzistojnë rrethana specifike dhe të kufizuara që do të justifikonin një leje nga emetuesi duke lejuar një person me përgjegjësi drejtuese të tregtojë. Megjithatë, çdo leje e tillë nga emetuesi nuk cenon ndalimet e përcaktuara në këtë rregullore.

62. Një sërë mjetesh efektive, kompetencash dhe burimesh për autoritetin kompetent të secilit shtet anëtar garanton efektivitetin e mbikëqyrjes. Rrjedhimisht, kjo rregullore, në veçanti, parashikon një grup minimal të kompetencave mbikëqyrëse dhe hetuese të autoriteteve kompetente të cilat duhet t'u besohen shteteve anëtare, sipas legjislacionit të brendshëm. Këto kompetenca duhet të ushtrohen, aty ku ato lejohen sipas të drejtës së brendshme, përmes aplikimit pranë autoriteteve kompetente. Gjatë ushtrimit të kompetencave sipas kësaj rregulloreje, autoritetet kompetente duhet të veprojnë në mënyrë objektive dhe të paanshme, dhe duhet të qëndrojnë të pavarur gjatë marrjes së vendimeve.

63. Edhe ndërmarrjet e tregut dhe të gjithë aktorët ekonomikë duhet të kontribuojnë në integritetin e tregut. Në këtë kuptim, caktimi i një autoriteti të vetëm kompetent për abuzimet në treg nuk duhet të përjashtojë lidhje bashkëpunimi ose delegime nën përgjegjësinë e autoritetit kompetent, mes atij autoriteti dhe ndërmarrjeve në treg, me synim garantimin e një mbikëqyrjeje efikase të pajtueshmërisë me dispozitat e miratuara në zbatim të kësaj rregulloreje. Kur personat që prodhojnë ose shpërndajnë rekomandime për investime ose informacione të tjera që rekomandojnë ose sugjerojnë një strategji investimi në një ose më shumë instrumente financiare, gjithashtu tregtojnë për llogari të tyre instrumente të tilla, autoritetet kompetente duhet, ndër të tjera, të jenë në gjendje të kërkojnë nga këta persona informacionin e nevojshëm për të përcaktuar nëse rekomandimet e prodhuara ose të shpërndarë nga ai person përputhen me këtë rregullore.

64. Me qëllim të zbulimit të rasteve të abuzimit me informacionin e brendshëm dhe të manipulimit të tregut, është e nevojshme që autoritetet kompetente, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, të kenë mundësinë të aksesojnë në ambientet e personave fizikë dhe juridikë me qëllim konfiskimin e dokumenteve. Aksesin në këto ambiente është i nevojshëm në rastin kur ka dyshime të arsyeshme mbi ekzistencën e dokumenteve dhe të dhënave të tjera dhe që lidhen me çështjen në fjalë të investigimit, si të rëndësishme për të provuar një çështje të abuzimit me informacionin e brendshëm ose të abuzimit në treg. Përveç kësaj, aksesin në këto ambiente është i nevojshëm në rastin kur personi, të cilit i është kërkuar informacioni, nuk arrin të veprojë në përputhje me këtë kërkesë, plotësisht ose pjesërisht; ose në rastin kur ka baza të arsyeshme për të besuar se kërkesa nuk do të përputhej me ose që dokumentet ose informacionin me të cilin lidhen kërkesat e informacionit do të hiqej, dëmtohej apo shkatërrohej. Nëse, në përputhje me të drejtën e brendshme, kërkohet autorizimi paraprak i autoritetit gjyqësor për shtetin anëtar përkatës, aksesin në ambiente duhet të ndodhë pas marrjes paraprake të autorizimit gjyqësor.

65. Regjistrimet ekzistuese të bisedave telefonike dhe të qarkullimit të të dhënave për shoqëritë e investimit, institucionet kredituese dhe ato financiare që ekzekutojnë dhe dokumentojnë ekzekutimin e transaksioneve, si dhe regjistrimet ekzistuese telefonike dhe

qarkullimit të të dhënave për operatorët e telekomunikacionit, përbëjnë evidencën thelbësore dhe ndonjëherë të vetmen evidencë për zbulimin dhe për të provuar ekzistencën e abuzimit me informacionin e privilegjuar dhe manipulimin e tregut. Regjistrimet telefonike dhe ato të qarkullimit të të dhënave të trafikut mund të përcaktojnë identitetin e një personi përgjegjës për shpërndarjen e informacionit të rremë ose çorientues ose që personat kanë qenë në kontakt në një kohë të caktuar dhe se ekziston një marrëdhënie midis dy ose më shumë njerëzve. Kështu, autoritetet kompetente duhet të jenë të afta të kërkojnë regjistrime të bisedave telefonike, të komunikimeve elektronike dhe të qarkullimit të të dhënave të trafikut në dispozicion të një shoqërie investimi, të një institucioni kreditues ose të një financiar në përputhje me Direktivën 2014/65/BE. Aksesin në të dhënat dhe regjistrimet telefonike është i nevojshëm për të siguruar prova dhe për të hetuar pista mbi abuzimin e mundshëm me informacionin e privilegjuar ose manipulimin e tregut, dhe për këtë arsye për zbulimin dhe imponimin e sanksioneve për abuzimin në treg. Për prezantimin e rregullave të barabarta në Bashkimin Evropian, në lidhje me aksesin në regjistrimet telefonike ose ato ekzistuese të trafikut të të dhënave në dispozicion të operatorit të telekomunikacionit ose regjistrimet ekzistuese telefonike ose të qarkullimit të të dhënave në dispozicion të një shoqërie investuese, një institucioni kreditues ose financiar, autoritetet kompetente duhet, në përputhje me të drejtën e brendshme, të kërkojnë regjistrime ekzistuese telefonike ose të të dhënave të trafikut që disponohen nga operatori i telekomunikacioneve, në masën e lejuar sipas të drejtës së brendshme dhe regjistrimet apo bisedat telefonike ekzistuese, si dhe qarkullimin e të dhënave në dispozicion të shoqërisë së investimit, në rastet e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm që këto regjistrime të lidhura me çështjen e hetimit mund të jenë të rëndësishme për të provuar një çështje të abuzimit me informacionin e brendshëm ose të abuzimit në treg. Aksesin në regjistrimet telefonike dhe qarkullimin e të dhënave në dispozicion të operatorit të telekomunikacionit nuk përfshin aksesin në përmbajtjen e komunikimeve zanore me anë të telefonit.

66. Ndërsa kjo rregullore specifikon grupin minimal të kompetencave të autoriteteve kompetente, këto kompetenca ushtrohen brenda sistemit të plotë të së drejtës së brendshme, e cila garanton respektimin e të drejtave themelore, duke përfshirë të drejtën e privatësisë. Për ushtrimin e këtyre kompetencave, të cilat mund të përbëjnë ndërhyrje serioze në të drejtën e respektimit të jetës private, familjare dhe të komunikimit, shtetet anëtare duhet të kenë mbrojtje të përshtatshme dhe efektive kundër çdo abuzimi, për shembull, sipas rastit, një kërkesë për të marrë autorizim paraprak nga autoritetet gjyqësore të një shteti anëtar në fjalë. Shtetet anëtare duhet t'i lejojnë autoriteteve kompetente mundësinë e ushtrimit të kompetencave të tilla ndërhyrëse, në masën e nevojshme për investigimin e duhur të rasteve serioze, në të cilat nuk disponohen mjete të barasvlershme për arritjen e efikasë të të njëjtit rezultat.

67. Meqenëse abuzimi në treg mund të ndodhë përtej kufijve dhe tregjeve, në të gjitha rastet, përveç atyre të jashtëzakonshme, autoritetet kompetente duhet të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion me autoritetet e tjera kompetente dhe rregullatore, dhe me ESMA-n, veçanërisht në lidhje me aktivitetet hetimore. Kur një autoritet kompetent është i bindur se abuzimi në treg është duke u kryer ose është kryer në një shtet tjetër anëtar ose ka ndikuar në instrumentet financiare të tregtuara në një shtet tjetër anëtar, ai duhet ta njoftojë këtë fakt tek autoriteti kompetent dhe ESMA. Në rastet e abuzimit në treg me efekte ndërkuftare, ESMA duhet të jetë në gjendje të koordinojë hetimin nëse kërkohet nga njëri prej autoriteteve kompetente përkatëse.

68. Është e nevojshme që autoritetet kompetente të kenë mjetet e nevojshme për mbikëqyrjen efektive të librit ndërtregtar të urdhrave. Në përputhje me Direktivën 2014/65/BE, autoritetet kompetente janë në gjendje të kërkojnë dhe të marrin të dhëna nga autoritetet e tjera kompetente në lidhje me librin e urdhrave për të ndihmuar në monitorimin dhe zbulimin e manipulimit të tregut në baza ndërkufitare.

69. Për të siguruar shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin me autoritetet e vendeve të treta në lidhje me zbatimin efektiv të kësaj rregulloreje, autoritetet kompetente duhet të përfundojnë marrëveshjet e bashkëpunimit me homologët e tyre në vendet e treta. Çdo transferim i të dhënave personale i kryer në bazë të këtyre marrëveshjeve duhet të përputhet me Direktivën 95/46/KE dhe me Rregulloren (KE) nr. 45/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹³.

70. Një sjellje e matur dhe e kujdesshme e kuadrit të biznesit për sektorin financiar duhet të mbështetet në regjime të forta mbikëqyrëse, hetimore dhe sanksionuese. Për këtë qëllim, autoritetet mbikëqyrëse duhet të pajisen me kompetenca të mjaftueshme për të vepruar dhe duhet të jenë në gjendje të mbështeten në regjime të barabarta, të forta dhe parandaluese sanksionuese kundër të gjitha shkeljeve financiare dhe sanksionet duhet të zbatohen në mënyrë efektive. Megjithatë, Grupi "de Larosière" konsideroi që asnjë nga këto elemente nuk është aktualisht në fuqi. Në Komunikatën e Komisionit të 8 dhjetorit 2010 "Për përforcimin e regjimeve sanksionuese në sektorin financiar" është kryer rishikimi i kompetencave ekzistuese për të imponuar sanksione dhe zbatimin praktik të tyre që synojnë nxitjen e konvergencës së sanksioneve në të gjithë aktivitetet mbikëqyrëse.

71. Prandaj, duhet të sigurohen një sërë sanksionesh dhe masash të tjera administrative për të garantuar një qasje të përbashkët në shtetet anëtare dhe për të rritur efektin e tyre pengues. Mundësia e ndalimit të ushtrimit të funksioneve të menaxhimit brenda firmave investuese duhet të jetë në dispozicion të autoritetit kompetent. Sanksionet e imponuara në raste specifike duhet të përcaktohen duke marrë parasysh faktorët e duhur si garantimi i çdo përfitimi financiar të identifikuar, rëndësia dhe kohëzgjatja e shkeljes, çdo faktor rëndues ose lehtësues, nevoja që gjobat të ketë efekt pengues dhe kur është e përshtatshme, të përfshijnë një zbritje për bashkëpunimin me autoritetin kompetent. Në veçanti, shuma aktuale e gjobave administrative që do të vendosen në një rast specifik mund të arrijë nivelin maksimal të parashikuar në këtë rregullore, ose nivelin më të lartë të parashikuar në të drejtën e brendshme, për shkelje shumë serioze, ndërsa gjobat dukshëm më të ulëta se niveli maksimal mund të vendosen për shkelje të vogla ose në rast zgjidhjeje të çështjes. Kjo rregullore nuk kufizon aftësinë e shteteve anëtare për të parashikuar sanksione më të larta ose masa të tjera administrative.

72. Pavarësisht se asgjë nuk i pengon shtetet anëtare që të parashikojnë rregulla për sanksione administrative dhe penale për të njëjtat shkelje, atyre nuk duhet t'u kërkohej të vendosin rregulla për sanksione administrative për shkeljet e kësaj rregulloreje të cilat tashmë i nënshtrohen të drejtës penale kombëtare që nga 3 korriku 2016. Në përputhje me të drejtën e brendshme, shtetet anëtare nuk detyrohen të vendosin njëkohësisht sanksione administrative dhe penale për të njëjtën shkelje, por kjo mund të bëhet kur e drejta e brendshme e lejon këtë veprim. Megjithatë, mbajtja e sanksioneve penale në vend të sanksioneve administrative, për shkeljet e kësaj rregulloreje ose të Direktivës 2014/57/BE nuk duhet të ulë ose të ndikojë në aftësinë e autoriteteve kompetente për të bashkëpunuar, për të pasur akses dhe për të shkëmbyer

informacion në kohën e përshtatshme me autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare, për qëllimet e kësaj rregulloreje, duke përfshirë çdo referim të shkeljeve përkatëse pranë autoriteteve kompetente juridike për ndjekje penale.

73. Për garantimin e efektit parandalues të vendimeve të marra nga autoritetet kompetente për publikun e gjerë, ato zakonisht duhet të publikohen. Publikimi i vendimeve gjithashtu shërben si mjet i rëndësishëm i autoriteteve kompetente për informimin e pjesëmarrësve në treg në lidhje me llojin e sjelljes, që konsiderohet si shkelje e kësaj rregulloreje, si dhe për promovimin e sjelljes pozitive të pjesëmarrësve në treg. Nëse ky publikim shkakton dëme joproporcionale te personat e përfshirë ose rrezikon stabilitetin e tregjeve financiare ose investimet e vazhdueshme, autoriteti kompetent duhet të publikojë, në mënyrë anonime, sanksionet dhe masat administrative në përputhje me të drejtën e brendshme ose të vonojë datën e publikimit të tyre. Autoriteteve kompetente duhet t'i jepet mundësia e mos publikimit të sanksioneve apo masave të tjera administrative, në rastin kur publikimi anonim ose i vonuar konsiderohet i pamjaftueshëm për garantimin e stabilitetit të tregjeve financiare. Autoriteteve kompetente gjithashtu nuk duhet të kërkohet të publikojnë masa të cilat konsiderohen të lehta dhe publikimi i të cilave do të ishte joproporcional.

74. Sinjalizuesit mund të sjellin informacione të reja në vëmendjen e autoriteteve kompetente që i ndihmojnë ata në zbulimin dhe vendosjen e sanksioneve në rastet e abuzimit me informacionin e privilegjuar dhe manipulimit të tregut. Megjithatë, sinjalizimi mund të pengohet nga frika e hakmarrjes, ose për shkak të mungesës së stimujve. Raportimi i shkeljeve të kësaj rregulloreje është i domosdoshëm për të siguruar që një autoritet kompetent të mund të zbulojë dhe të vendosë sanksione për abuzimin e në treg. Masat që lidhen me sinjalizimin janë të domosdoshme për të lehtësuar zbulimin e abuzimit në treg dhe për të siguruar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të sinjalizuesit dhe personit të akuzuar. Prandaj, kjo rregullore duhet të sigurojë që ekzistojnë masa të përshtatshme për t'u mundësuar sinjalizuesve që të lajmërojnë autoritetet kompetente për shkeljet e mundshme të kësaj rregulloreje dhe për t'i mbrojtur ata nga hakmarrja. Shtetet anëtare duhet të lejohen të ofrojnë stimuj financiarë për ata persona që ofrojnë informata të rëndësishme rreth shkeljeve të mundshme të kësaj rregulloreje. Megjithatë, sinjalizuesit duhet të kenë të drejtë për këta stimuj financiarë, kur ata zbulojnë informacione të reja të cilat nuk janë të detyruar ligjërisht t'i njoftojnë dhe kur ky informacion rezulton në një sanksion për shkeljen e kësaj rregulloreje. Shtetet anëtare duhet gjithashtu të sigurojnë që skemat e sinjalizimit që zbatojnë përfshijnë mekanizma që sigurojnë mbrojtjen e duhur të një personi të akuzuar, veçanërisht në lidhje me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave të tij personale dhe procedura për të siguruar të drejtën e personit të akuzuar për mbrojtje dhe për t'u dëgjuar para miratimit të një vendimi në lidhje me të, si dhe të drejtën për të kërkuar mjet efikas ankimi përpara gjykatës kundër një vendimi në lidhje me të.

75. Duke qenë se shtetet anëtare kanë miratuar legjislacionin për zbatimin e Direktivës 2003/6/Ke dhe se aktet e deleguara, standardet teknike rregullatore dhe standardet teknike të zbatimit të parashikuara në këtë rregullore duhet të miratohen përpara se kuadri që do të prezantohet të zbatohet me efektivitet, është e nevojshme të shtyhet zbatimi i dispozitave kryesore të kësaj rregulloreje për një periudhë të mjaftueshme kohore.

76. Për të bërë të mundur hyrjen e lehtë në zbatim të kësaj rregulloreje, praktikat e tregut ekzistues përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe të pranuar nga autoritetet kompetente

në përputhje me Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 2273/2003¹⁴ për qëllimin e zbatimit të pikës 2, germa "a" të nenit 1 të Direktivës 2003/6/KE, mund të vazhdojnë të jenë të zbatueshme me kusht që ato t'i njoftohen ESMA-s brenda një periudhe të caktuar kohore, derisa autoriteti kompetent të marrë një vendim lidhur me vazhdimin e këtyre praktikave në përputhje me këtë rregullore.

77. Rregullorja respekton të drejtat themelore dhe zbaton parimet e njohura në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta). Rrjedhimisht, kjo rregullore duhet të zbatohet në përputhje me këto të drejta dhe parime. Në veçanti, kur kjo rregullore u referohet rregullave që rregullojnë lirinë e shtypit dhe lirinë e shprehjes në mediat e tjera dhe rregullave ose kodeve që rregullojnë profesionin e gazetarëve, duhet të merren parasysh ato liri siç garantohen në Bashkimin Evropian dhe në shtetet anëtare dhe siç njihen në nenin 11 të Kartës dhe të dispozitave të tjera përkatëse.

78. Për të rritur transparencën dhe për të informuar më mirë funksionimin e regjimeve të sanksioneve, autoritetet kompetente duhet të sigurojnë të dhëna anonime dhe të grumbulluara në ESMA në baza vjetore. Këto të dhëna duhet të përfshijnë numrin e hetimeve që janë hapur, numrin e atyre që janë në vazhdim dhe numrin e atyre që janë mbyllur gjatë periudhës përkatëse.

79. Direktiva 95/46/KE dhe Rregullorja (KE) nr. 45/2001 rregullon përpunimin e të dhënave personale që kryhet nga ESMA në kuadër të kësaj rregulloreje dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve kompetente të shteteve anëtare, sidomos të autoriteteve të pavarura publike të caktuara nga shtetet anëtare. Çdo shkëmbim ose transmetim i informacionit nga autoritetet kompetente duhet të përputhet me rregullat për transferimit e të dhënave personale, të përcaktuara në Direktivën 95/46/KE. Çdo shkëmbim ose transmetim i informacionit nga ESMA duhet të përputhet me rregullat për transferimit e të dhënave personale, të përcaktuara në Rregulloren (KE) nr. 45/2001.

80. Kjo rregullore, si dhe aktet e deleguara, aktet zbatuese, standardet teknike rregullatore, zbatim i standardeve teknike dhe udhëzimet e miratuara në përputhje me to, nuk cenojnë zbatimin e rregullave të Bashkimit Evropian për konkurrencën.

81. Për të specifikuar kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, kompetenca për të miratuar akte në përputhje me nenin 290 të TFBE duhet t'i delegohet Komisionit në lidhje me përjashtimin nga fushëzbatimi i kësaj rregulloreje, të disa organeve publike dhe bankave qendrore të vendeve të treta dhe të disa organeve të caktuara publike të vendeve të treta që kanë një marrëveshje lidhëse me Bashkimin Evropian sipas kuptimit të nenit 25 të Direktivës 2003/87/KE; treguesit për sjelljen manipuluese të renditur në shtojcën I të kësaj rregulloreje; pragjet për përcaktimin e zbatimit të detyrimit të publikimit për pjesëmarrësit e tregut të kuotave të emetimit; rrethanat në të cilat është i lejuar tregtimi gjatë një periudhe të mbyllur; dhe llojet e transaksioneve të caktuara të kryera nga personat që kanë përgjegjësi drejtuese ose persona të lidhur ngushtë me ta që do të nxisnin një kërkesë për të njoftuar. Është shumë e rëndësishme që gjatë punës së tij përgatitore Komisioni të kryejë konsultimet e duhura, duke përfshirë ato në nivel ekspertësh. Komisioni, gjatë përgatitjes dhe hartimit të akteve të deleguara, duhet të sigurojë një transmetim të njëkohshëm, në kohën dhe mënyrën e duhur, të dokumenteve përkatëse pranë Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

82. Për të siguruar kushte të njëtrajtshme për zbatimin e kësaj rregulloreje në lidhje me procedurat për raportimin e shkeljeve të saj, Komisionit duhet t'i jepen kompetencat zbatuese për të specifikuar ato procedura, duke përfshirë masat në vijim të raporteve dhe masat për mbrojtjen e personave që punojnë me një kontratë pune dhe masat për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto kompetenca duhet të ushtrohen në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 182/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹⁵.

83. Standardet teknike në shërbime financiare duhet të garantojnë kushte të njëtrajtshme përmes Bashkimit Evropian në çështje që mbulohen nga kjo rregullore. Si organ tepër i specializuar i ekspertizës, është efikase dhe e përshtatshme që ESMA-s t'i besohet përpunimi i draftit të standardeve teknike rregullatore dhe drafti i zbatimit të standardeve teknike, të cilat nuk përfshijnë zgjedhjet e politikave, që i dërgohen Komisionit.

84. Komisioni duhet të jetë i autorizuar të miratojë draftin e standardeve teknike rregullatore të zhvilluara nga ESMA për të specifikuar përmbajtjen e njoftimeve që duhet të kryhen nga operatorët e tregjeve të rregulluara, MTF-ve dhe OTF-ve në lidhje me instrumentet financiare që pranohen për tregtim, janë tregtuar ose për të cilat është bërë një kërkesë për t'u pranuar në tregtimin në vendin e tyre të tregtimit; mënyrën dhe kushtet e përpilimit, publikimit dhe mirëmbajtjes së listës së këtyre instrumenteve nga ESMA; kushtet që programet e blerjes dhe masat e stabilizimit duhet të plotësojnë duke përfshirë kushtet për tregtim, kufizimet kohore dhe të vëllimit, detyrimet e zbulimit dhe të raportimit dhe kushtet e çmimeve për stabilizimin; në lidhje me procedurat dhe masat, sistemet për vendet e tregtimit që kanë për qëllim parandalimin dhe zbulimin e abuzimeve në treg dhe të sistemeve dhe modeleve që do të përdoren nga personat me qëllim zbulimin dhe njoftimin e urdhrave dhe transaksioneve të dyshimta; masat, procedurat dhe kërkesat e duhura të mbajtjes së shënimeve në procesin e sondazheve të tregut; dhe në lidhje me masat teknike për kategoritë e personave për paraqitjen objektive të informacionit që rekomandon një strategji investimi dhe për zbulimin e interesave të veçantë ose treguesve të konfliktit të interesave me anë të akteve të deleguara në përputhje me nenin 290 TFBE dhe në përputhje me nenet 10 deri 14 të Rregullores (BE) nr. 1093/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹⁶. Është shumë e rëndësishme që gjatë punës së tij përgatitore Komisioni të kryejë konsultimet e duhura, duke përfshirë ato në nivel ekspertësh.

85. Komisionit duhet gjithashtu t'i jepet kompetenca e miratimit të zbatimit të standardeve teknike përmes akteve zbatuese, sipas nenit 291 të TFBE-së dhe në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1093/2010. ESMA-s duhet t'i besohet draftimi i standardeve teknike të zbatimit për t'u dorëzuar në Komision sa i përket publikimit të informacionit të brendshëm, formateve të listave të personave të brendshëm dhe formateve dhe procedurave për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit të autoriteteve kompetente mes tyre dhe me ESMA-n.

86. Meqenëse qëllimi i kësaj rregulloreje, përkatësisht parandalimi i abuzimit në treg në formën e abuzimit me informacionin e privilegjuar, zbulimit të paligjshëm të informacionit të brendshëm dhe i manipulimit të tregut, nuk mund të përmbushet mjaftueshëm nga shtetet anëtare, për shkak të shkallës dhe efekteve të tij, mund të arrihet më mirë në nivelin e Bashkimit Evropian, ky i fundit mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç përcaktohet në nenin 5 të Traktatit për Bashkimin Evropian. Në përputhje me parimin e

proporcionalitetit, sipas përcaktimit në atë nen, kjo rregullore nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij objekti.

87. Meqë dispozitat e Direktivës 2003/6/KE nuk janë më relevante ose të mjaftueshme, kjo direktivë duhet të shfuqizohet nga 3 korriku 2016. Kërkesat dhe ndalimet e kësaj rregulloreje janë të lidhura ngushtë me ato të Direktivës 2014/65/BE dhe prandaj duhet të hyjnë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të kësaj direktive.

88. Që kjo rregullore të zbatohet si duhet, është e nevojshme që shtetet anëtare të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që legjislacioni i tyre i brendshëm të përputhet deri më 3 korrik 2016, me dispozitat e kësaj rregulloreje në lidhje me autoritetet kompetente dhe kompetencat e tyre, sanksionet dhe masat e tjera administrative, raportimin e shkeljeve dhe publikimin e vendimeve.

89. Mbikëqyrësi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale shpreh mendimin e tij më 10 shkurt 2012¹⁷,

MIRATOJNË KËTË RREGULLORE:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton një kuadër të përbashkët rregullator për abuzimin me informacionet e privileguara, zbulimin e paligjshëm të informacionit të brendshëm dhe manipulimin e tregut (abuzimin në treg) si dhe masat për parandalimin e abuzimit në treg për të garantuar integritetin e tregjeve financiare në BE dhe për të fuqizuar mbrojtjen dhe besimin e investitorëve në këto tregje.

Neni 2

Objekti

1. Kjo rregullore zbatohet për sa më poshtë:

a) instrumentet financiare të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar ose për të cilat është bërë një kërkesë për pranim për tregtim në një treg të tillë;

b) instrumentet financiare që tregtohen, janë pranuar për tregtim ose për të cilat është bërë një kërkesë për pranim për tregtim një MTF;

c) instrumentet financiare të tregtuara në një platformë të përbashkët tregtimi;

d) instrumentet financiare që nuk mbulohen nga germa "a", "b", ose "c", çmimi ose vlera e të cilave varet ose ndikon në çmimin ose vlerën e një prej instrumenteve financiare të

përmendura në këto germa, duke përfshirë por pa u kufizuar me "credit default swaps" dhe kontratat për diferencat.

Kjo rregullore zbatohet gjithashtu për sjelljet ose transaksionet, duke përfshirë ofertat, në lidhje me nxjerrjen në një platformë ankandi të autorizuar si treg i rregulluar të kuotave të emetimeve ose të produkteve të tjera të hedhura në ankand që bazohen në to, edhe kur këto produkte nuk janë instrumente financiare, sipas Rregullores (BE) nr. 1031/2010. Për ofertat e dorëzuara në kontekstin e një aksioni zbatohen të gjitha kërkesat dhe ndalimet e kësaj rregulloreje në lidhje me urdhrat për tregtim, pa cenuar dispozitat specifike që i referohen këtyre ofertave.

2. Nenet 12 dhe 15 zbatohen për:

a) kontratat spot të mallrave, të cilat nuk janë produkte energjetike të tregtuara me shumicë, nëse transaksioni, urdhri ose sjellja ka ose ka gjasa të ketë ndikim në çmimin ose vlerën e instrumentit financiar të përmendur në paragrafin 1;

b) llojet e instrumenteve financiare, duke përfshirë kontratat ose instrumentet derivative për transferimin e rrezikut të kredisë, nëse transaksioni, urdhri, oferta ose sjellja ka ose ka gjasa të ketë ndikim në çmimin ose vlerën e kontratës spot të mallrave kur çmimi ose vlera varen nga çmimi ose vlera e instrumenteve financiare; dhe

c) sjelljen në raport me referencat.

3. Kjo rregullore zbatohet për çdo transaksion, urdhër ose sjellje në lidhje me instrumentet financiare siç përmendet në paragrafët 1 dhe 2, pavarësisht nga fakti nëse këto transaksione, urdhra ose sjellje bëhen ose jo në një vend tregtimi.

4. Ndalimet dhe kërkesat në këtë rregullore zbatohen për veprimet dhe mosveprimet, në BE dhe në një vend të tretë, në lidhje me instrumentet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2.

Neni 3

Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "instrument financiar" është një instrument financiar sipas përkufizimit në pikën 15 të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2014/65/BE;

2. "shoqëri investimi" është një shoqëri investimi sipas përkufizimit në pikën 1 të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2014/65/BE;

3. "institucion krediti" është një institucion krediti siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 4, paragrafi 1 të Rregullores (BE) nr. 575/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹⁸;

4. "institucion financiar" është një institucion financiar siç përcaktohet në pikën 26 të nenit 4, paragrafi 1 të Rregullores (BE) nr. 575/2013;

5. "operator tregu" është një operator tregu sipas përkufizimit në pikën 18 të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2014/65/BE;

6. "treg i rregulluar" është një treg i rregulluar sipas përkufizimit në pikën 21 të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2014/65/BE;

7. "platformë shumëpalëshe tregtimi" ose "MTF" është një platformë shumëpalëshe tregtimi, sipas përkufizimit në pikën 22 të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2014/65/BE;

8. "platformë e përbashkët tregtimi" ose "OTF" është një sistem ose platformë në BE sipas përkufizimit në pikën 23 të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2014/65/BE;

9. "praktikë e pranuar tregu" është një praktikë specifike e tregut e pranuar nga një autoritet kompetent në përputhje me nenin 13;

10. "vend tregtimi" është një vend tregtimi sipas përkufizimit në pikën 24 të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2014/65/BE;

11. "treg në rritje i SME-ve" është tregu në rritje i SME-ve sipas përkufizimit në pikën 12 të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2014/65/BE;

12. "autoriteti kompetent" është autoriteti, që caktohet në përputhje me nenin 22, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë rregullore;

13. "person" është një person fizik ose juridik;

14. "mallra" janë mallrat sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 2 të Rregullores së Komisionit (KE) nr. 1287/2006¹⁹;

15. "kontratë spot e mallrave" është një kontratë për furnizim me mallra të tregtuara në një treg spot që dorëzohen menjëherë pas pagesës së transaksionit dhe një kontratë për furnizimin me mallra që nuk janë instrumente financiare, duke përfshirë një kontratë të ardhshme që mund të parashikojë dorëzimin fizik;

16. "treg spot" është një treg ku mallrat shiten me kesh dhe dërgohen menjëherë pas pagesës së transaksionit dhe tregje të tjera jofinanciare, si tregjet e ardhshme për mallra;

17. "program i riblerjes" është tregtimi i aksioneve të veta në përputhje me nenin 21 deri në 27 të Direktivës 2012/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit²⁰;

18. "tregti algoritmike" është një tregti algoritmike siç përcaktohet në pikën 39 të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2014/65/BE;

19. "kuotë emetimi" është një kuotë emetimi siç përshkruhet në pikën 11 të seksionit C të shtojcës I të Direktivës 2014/65/BE;

20. "pjesëmarrës në tregun e kuotave të emetimit" është çdo person që hyn në transaksione, duke përfshirë kalimin e urdhrave për tregtim, në kuota emetimi, produkte të

hedhura në ankand që bazohen në to ose derivate të tyre dhe që nuk përfiton nga ndonjë përjashtim sipas nënparagrafit të dytë të nenit 17, paragrafi 2;

21. "emetues" është një person juridik që rregullohet nga e drejta private ose publike, i cili lëshon ose propozon lëshimin e instrumenteve financiare, ku emetuesi, në rastin e faturave të depozitarit që përfaqësojnë instrumentet financiare, është emetuesi i instrumentit financiar të përfaqësuar;

22. "produkte energjetike të tregtuara me shumicë" janë produktet energjetike të tregtuara me shumicë, të përkufizuara në pikën 4 të nenit 2 të Rregullores (BE) nr. 1227/2011;

23. "autoritet kombëtar rregullator" është organi kombëtar rregullator, sipas përkufizimit në pikën 10 të nenit 2 të Rregullores (BE) nr. 1227/2011;

24. "derivate të mallrave" janë derivatet e mallrave siç përcaktohen në pikën 30 të nenit 2, paragrafi 1 të Rregullores (BE) nr. 600/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit²¹;

25. "personi që ushtron përgjegjësitë menaxheriale" është personi brenda një shoqërie emetuese, një pjesëmarrës në tregun e kuotave të emetimit ose një subjekt tjetër i përmendur në nenin 19, paragrafi 10, i cili është:

a) një anëtar i organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës të këtij subjekti; ose

b) një drejtues i lartë i cili nuk është anëtar i organeve të përmendura në germën "a", që ka akses të përhershëm në informacionin e brendshëm që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me këtë subjekt si dhe kompetencat për të marrë vendime menaxheriale që ndikojnë në zhvillimet e ardhshme dhe perspektivat e biznesit të këtij subjekti;

26. "person i lidhur ngushtë" është:

a) bashkëshorti/bashkëshortja ose partneri që konsiderohet ekuivalent me bashkëshortin/bashkëshorten në përputhje me legjislacionin e brendshëm;

b) fëmija në varësi në përputhje me legjislacionin e brendshëm;

c) një i afërm që ka ndarë të njëjtën shtëpi për të paktën një vit në datën e transaksionit në fjalë; ose

d) një person juridik, trust ose partneritet, përgjegjësitë menaxheriale e të cilit bien mbi një person që ushtron përgjegjësitë menaxheriale ose mbi personin e përmendur në germën "a", "b" ose "c", që kontrollohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga ky person, që është ngritur për përfitimin e këtij personi ose interesat ekonomike të të cilit janë në thelb ekuivalente me ato të këtij personi;

27. "regjistrime të qarkullimit të të dhënave" janë regjistrimet e të dhënave të trafikut sipas përcaktimit në germën "b" të paragrafit të dytë të nenit 2 të Direktivës 2002/58/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit²²;

28. "person që organizon ose ekzekuton transaksionet me profesionalizëm" është personi i përfshirë profesionalisht në marrjen dhe dërgimin e urdhrave ose në ekzekutimin e transaksioneve në instrumente financiare;

29. "referencë" është çdo normë, indeks apo shifër që publikohet ose vihet në dispozicion të publikut, që përcaktohet periodikisht ose rregullisht me anë të zbatimit të një formule ose në bazë të vlerës së një ose më shumë aktiveve primare ose çmimeve, duke përfshirë çmimet e parashikuara, normat aktuale ose të parashikuara të interesit ose vlerat apo sondazhet e tjera dhe me referencë ndaj të cilës përcaktohet shuma që do të paguhet sipas një instrumenti financiar ose vlera e këtij të fundit;

30. "krijues tregu" është një krijues i tregut sipas përkufizimit në pikën 7 të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2014/65/BE;

31. "krijimi i kapitalit" është blerja e titujve në një shoqëri, e cila nuk nxit një detyrim ligjor ose rregullator për të komunikuar ofertat e marrjes nën kontroll në lidhje me këtë shoqëri;

32. "pjesëmarrës zbulues në treg" është personi që bën pjesë në një nga kategoritë e përcaktuara në germat "a" deri në "d" të nenit 11, paragrafi 1 ose të nenit 11, paragrafi 2 dhe që publikon informacionet gjatë sondazhit të tregut;

33. "tregtim me frekuencë të lartë" është teknika e tregtimit algoritmik me frekuencë të lartë sipas përcaktimit në pikën 40 të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2014/65/BE;

34. "informacion që rekomandon ose sugjeron një strategji investimi" është informacioni:

I. i përpiluar nga një analist i pavarur, një firmë investimi, një institucion krediti apo çdo person tjetër, veprimtaria kryesore e të cilit është hartimi i rekomandimeve për investime ose një person fizik që punon për ta me kontratë pune ose në ndonjë mënyrë tjetër, i cili në mënyrë direkte ose indirekte shpreh një propozim të veçantë investimi në lidhje me një instrument financiar ose një emetues; ose

II. i përpiluar nga persona të ndryshëm nga ata që janë përmendur në pikën I, që propozon drejtpërdrejt një vendim të veçantë investimi në lidhje me një instrument financiar;

35. "rekomandim për investim" është informacioni i destinuar për kanalet e shpërndarjes ose për publikun i cili rekomandon ose sugjeron një strategji investimi, në mënyrë eksplicite ose implicite, në lidhje me një ose disa instrumente financiare ose emetuesit, duke përfshirë çdo opinion për vlerën aktuale apo të ardhshme ose çmimin e këtyre instrumenteve.

2. Për qëllimet e nenit 5 zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) "tituj" janë:

I. aksionet dhe titujt e tjerë ekuivalent me aksionet;

II. obligacionet dhe format e tjera të borxhit të titullzuar; ose

III. borxhi i titullizuar i konvertueshëm ose i këmbyeshëm në aksione ose në tituj të tjerë ekuivalentë me këto aksione.

b) "instrumente të lidhura" janë instrumentet e mëposhtme financiare, duke përfshirë ato që nuk janë pranuar për tregtim ose nuk janë tregtuar në një vend tregtimi ose për të cilat nuk është bërë kërkesë për pranim për tregtim në një vend tregtimi:

I. kontratat ose të drejtat për nënshkrimin, blerjen ose shitjen e titujve;

II. derivatet financiare të titujve;

III. nëse titujt janë instrumente borxhi të konvertueshme ose të këmbyeshme, titujt në të cilat këto instrumente mund të konvertohen ose të këmben;

IV. instrumentet që janë lëshuar ose garantuar nga emetuesi ose garantuesi i titujve dhe çmimi i tregut i të cilave mund të ndikojë materialisht në çmimin e titujve ose e kundërta;

V. kur titujt janë ekuivalentë me aksionet, aksionet e përfaqësuara nga titujt dhe të gjithë titujt ekuivalentë me këto aksione;

c) "shpërndarje e konsiderueshme" është oferta fillestare ose dytësore e titujve e ndryshme nga tregtimi i zakonshëm si në aspektin e shumës në vlerë të titujve që ofrohen ashtu dhe në atë të metodës së shitjes që do të përdoret;

d) "stabilizim" është blerja apo oferta për të blerë tituj ose një transaksion në instrumente të lidhura ekuivalente me to, që ndërmerret nga një institucion krediti ose një firmë investimi në kontekstin e shpërndarjes së konsiderueshme të këtyre titujve ekskluzivisht për mbështetjen e çmimit të tyre të tregut për një periudhë të paracaktuar kohore, për shkak të presionit të shitjes së këtyre titujve.

Neni 4

Njoftimet dhe lista e instrumenteve financiare

1. Operatorët e tregut të tregjeve të rregulluara, shoqëritë e investimit dhe operatorët e tregut që operojnë në një MTF ose platformë të përbashkët tregtimi, njoftojnë pa vonesa autoritetin kompetent të vendit të tregtimit në lidhje me çdo instrument financiar të pranuar për tregtim ose të tregtuar për herë të parë, për të cilin bëhet një kërkesë për pranim për tregtim në vendin e tyre të tregtimit.

Ata njoftojnë gjithashtu autoritetin kompetent të vendit të tregtimit nëse ndërpritet tregtimi ose pranimi për tregtim i një instrumenti financiar, përveç nëse dita e ndërprerjes së tregtimit ose pranimit për tregtim të instrumentit financiar dihet dhe është komunikuar në njoftimin e bërë në përputhje me nënparagrafin e parë.

Njoftimet e përmendura në këtë paragraf përfshijnë, sipas rastit, emrat dhe identifikuesit e instrumenteve financiare në fjalë si dhe datën dhe kohën e kërkesës për pranim për tregtim, pranimin për tregtim dhe datën dhe orën e tregtimit të parë.

Operatorët e tregut dhe firmat e investimeve i transmetojnë autoritetit kompetent të vendit të tregtimit edhe informacionet e përcaktuara në nënparagrafin e tretë në lidhje me instrumentet financiare që kanë qenë objekt i kërkesës së pranimit për tregtim ose që janë pranuar për tregtim përpara datës 2 korrik 2014 dhe që pranohen ende për tregtim ose tregtohen në atë datë.

2. Autoritetet kompetente të vendit të tregtimit transmetojnë pa vonesa njoftimet që marrin në përputhje me paragrafin 1 të ESMA-s. Menjëherë pas marrjes së njoftimeve ESMA i publikon ato në faqen e saj të internetit në formën e një liste. ESMA e përditëson këtë listë menjëherë pas marrjes së njoftimit nga një autoritet kompetent i vendit të tregtimit. Lista nuk e kufizon fushën e zbatimit të kësaj rregulloreje.

3. Lista përmban informacionin e mëposhtëm:

a) emrat dhe identifikuesit e instrumenteve financiare që janë objekt i kërkesës së pranimit për tregtim, janë pranuar për tregtim ose janë tregtuar për herë të parë, në tregje të rregulluara, MTF ose platforma të përbashkëta tregtimit;

b) datat dhe orët e kërkesave të pranimit për tregtim, të pranimeve për tregtim ose të tregtimeve të para;

c) të dhënat e vendeve të tregtimit në të cilat instrumentet financiare janë objekt i kërkesës së pranimit për tregtim, janë pranuar për tregtim ose janë tregtuar për herë të parë; dhe

d) data dhe ora në të cilën është ndërprerë tregtimi ose pranimi për tregtim i instrumenteve financiare.

4. Me qëllim garantimin e harmonizimit e qëndrueshëm të këtij neni, ESMA harton draft standarde teknike rregullatore për përcaktimin e:

a) përmbajtjes së njoftimeve të përmendura në nenin 1; dhe

b) mënyrës dhe kushteve të përpilimit, publikimit dhe përditësimit të listës së përmendur në paragrafin 3.

ESMA, jo më vonë se 3 korriku 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit²³.

5. Për të garantuar kushte uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA harton draft standarde teknike zbatuese për përcaktimin e kohës, formatit dhe modelit të dorëzimit të njoftimeve sipas paragrafëve 1 dhe 2.

ESMA i dorëzon Komisionit, jo më vonë se 3 korriku 2015, draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 5

Përrjashtimi për programet e riblerjes dhe stabilizimi

1. Ndalimet në nenet 14 dhe 15 të kësaj rregulloreje nuk zbatohen për tregtimin e aksioneve të veta në programet e riblerjes nëse:

- a) të dhënat e plota të programit bëhen të ditura para fillimit të tregtimit;
- b) tregtimet i raportohen autoritetit kompetent të vendit të tregtimit si pjesë e programit të riblerjes në përputhje me paragrafin 3 dhe bëhen më pas publike;
- c) përmbushen kufizimet përkatëse në lidhje me çmimin dhe vëllimin; dhe
- d) kryhet në përputhje me objektivat e përmendura në paragrafin 2 dhe me kushtet e përcaktuara në këtë nen dhe në standardet teknike rregullatore të përmendura në paragrafin 6.

2. Me qëllim përfitimin nga përjashtimi i parashikuar në paragrafin 1, programi i riblerjes ka si qëllim të vetëm:

- a) reduktimin e kapitalit të emetuesit;
- b) përmbushjen e detyrimeve që lindin nga instrumentet financiare të borxhit që mund të këmbëhen në instrumente kapitali; ose
- c) përmbushjen e detyrimeve që lindin nga programet e opsioneve të aksioneve ose ndarjet e tjera të aksioneve për punonjësit ose për anëtarët e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit ose të një shoqërie të lidhur.

3. Për të përfituar nga përjashtimi i parashikuar në paragrafin 1, emetuesi i raporton autoritetit kompetent të vendit të tregtimit ku aksionet janë pranuar për tregtim ose janë tregtuar, për çdo transaksion që lidhet me programin e riblerjes, duke përfshirë informacionin e specifikuar në nenin 25, paragrafi 1 dhe 2 dhe në nenin 26, paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores (BE) nr. 600/2014.

4. Ndalimet në nenet 14 dhe 15 të kësaj rregulloreje nuk zbatohen për tregtimin e titujve ose instrumenteve të ngjashme për stabilizimin e titujve nëse:

- a) stabilizimi kryhet për një periudhë të kufizuar;
- b) informacioni përkatës për stabilizimin zbulohet dhe i komunikohet autoritetit kompetent të vendit të tregtimit në përputhje me paragrafin 5;
- c) përmbushen kufizimet përkatëse në lidhje me çmimin; dhe

d) tregtimi përmbush kushtet e stabilizimit të përcaktuara në standardet teknike rregullatore të përmendura në paragrafin 6.

5. Pa cenuar nenin 23, paragrafi 1, të dhënat e të gjitha transaksioneve të stabilizimit i komunikohen emetuesve, ofruesve ose subjekteve që ndërmarrin stabilizimin, pavarësisht nëse ata vepron në emër të këtyre personave dhe autoritetit kompetent të vendit të tregtimit jo më vonë sesa në përfundim të seancës së shtatë të tregtimit të përditshëm pas datës së ekzekutimit të këtyre transaksioneve.

6. Për të garantuar harmonizimin e vazhdueshëm të këtij neni, ESMA harton draft standarde teknike rregullatore për të specifikuar kushtet që duhet të përmbushin programet e riblerjes dhe masat e stabilizimit të përmendura në paragrafët 1 dhe 4, duke përfshirë kushtet për tregtim, kufizimet në lidhje me kohën dhe vëllimin, deklarimin dhe raportimin e detyrimeve dhe kushtet e çmimit.

ESMA, jo më vonë se 3 korriku 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 6

Përfshirjet për veprimtaritë e menaxhimit monetar dhe të borxhit publik dhe për veprimtaritë e politikës klimatike

1. Kjo rregullore nuk zbatohet për transaksionet, urdhrat ose sjelljet në ndjekje të politikës së menaxhimit monetar, kursit të këmbimit ose borxhit publik nga:

- a) një shtet anëtar;
- b) anëtarët e SEBQ-së;
- c) ministritë, agjencitë ose mjetet me qëllime të veçanta të një ose disa shteteve anëtare ose nga një person që vepron në emër të tyre;
- d) në rastin një shteti anëtar federal, një anëtar që është pjesë e kësaj federate.

2. Kjo Rregullore nuk zbatohet për transaksionet, urdhrat ose sjelljet e Komisionit ose ndonjë organi tjetër të caktuar zyrtarisht ose të cilido person që vepron në emër të tyre, në ndjekje të politikës së menaxhimit të borxhit publik.

Kjo Rregullore nuk zbatohet për transaksionet, urdhrat ose sjelljet e:

- a) Bashkimit Evropian;
- b) një mjeti për qëllime të veçanta të një ose disa shteteve anëtare;

- c) Bankës Evropiane të Investimeve;
- d) Institutit Evropian të Stabilitetit Financiar;
- e) Mekanizmit Evropian të Stabilitetit;

f) institucionit financiar ndërkombëtar të themeluar nga dy ose më shumë shtete anëtare, me qëllim mobilizimin e fondeve dhe sigurimin e asistencës financiare në përfitim të anëtarëve të saj, të cilët përballen ose kërcënohen nga probleme të rënda financiare.

3. Kjo Rregullore nuk zbatohet për veprimtaritë e shteteve anëtare, Komisionit, organeve të tjera të caktuara zyrtarisht ose të çdo personi që vepron në emër të tyre, të cilat kanë të bëjnë me kuotat e emetimeve dhe që ndërmerren në ndjekje të politikës klimatike të Bashkimit Evropian në përputhje me Direktivën 2003/87/KE.

4. Kjo Rregullore nuk zbatohet për veprimtaritë e shteteve anëtare, Komisionit, organeve të tjera të caktuara zyrtarisht ose të çdo personi që vepron në emër të tyre, të cilat ndërmerren në ndjekje të Politikës së Përbashkët Bujqësore të Bashkimit Evropian ose të Politikës së Përbashkët të Peshkimit të Bashkimit Evropian, në përputhje me aktet e miratuara ose me marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura në kuadër të TFBE-së.

5. Komisioni ka kompetencën të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 35 për zgjerimin e përjashtimit të përmendur në paragrafin 1 tek organet e caktuara publike dhe bankat qendrore të vendeve të treta.

Për këtë qëllim, deri më 3 janar 2016, Komisioni përgatit dhe paraqet para Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport që vlerëson trajtimin ndërkombëtar të organeve publike përgjegjëse për menaxhimin e borxhit publik ose që ndërhyjnë në këtë të fundit dhe të bankave qendrore në vendet e treta.

Raporti përfshin një analizë krahasuese të trajtimit të këtyre organeve dhe bankave qendrore në kuadrin ligjor të vendeve të treta si dhe standardet e menaxhimit të rrezikut të zbatueshme për transaksionet e lidhura nga këto organe dhe banka qendrore në këto juridiksione. Nëse raporti arrin në përfundimin që, veçanërisht në lidhje me analizën krahasuese, përjashtimi i përgjegjësive monetare të bankave qendrore të vendeve të treta nga detyrimet dhe ndalimet e kësaj rregulloreje është i nevojshëm, Komisioni e zgjeron përjashtimin e përmendur në paragrafin 1 edhe për bankat qendrore të këtyre vendeve të treta.

6. Komisioni ka gjithashtu kompetencën për të miratuar akte të deleguara në përputhje me nenin 35 për të zgjeruar përjashtimin e përcaktuar në paragrafin 3 tek disa organe të caktuara publike të vendeve të treta që kanë lidhur marrëveshje me Bashkimin Evropian në përputhje me nenin 25 të Direktivës 2003/87/KE.

7. Ky nen nuk zbatohet për personat që punojnë në bazë të një kontrate pune ose forme tjetër për subjektet e përmendura në këtë nen, kur këta persona kryejnë transaksione apo urdhra ose përfshihen në sjellje, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për llogari të vet.

KREU II

INFORMACIONI I BRENDSHËM, ABUZIMI ME INFORMACIONIN E PRIVILEGJUAR, ZBULIMI I PALIGJSHËM I INFORMACIONIT TË BRENDSHËM DHE MANIPULIMI I TREGUT

Neni 7

Informacioni i brendshëm

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, informacioni i brendshëm përfshin llojet e mëposhtme të informacionit:

a) informacioni i një natyre specifike që nuk është bërë publik dhe që lidhet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë emetues ose me një ose më shumë instrumente financiare dhe i cili nëse do të ishte bërë publik, do të kishte pasur ndikim të konsiderueshëm në çmimet e këtyre instrumenteve financiare ose në çmimin e instrumenteve financiare derivative përkatëse;

b) në lidhje me derivatet e mallrave, informacioni i një natyre specifike që nuk është bërë publik dhe që lidhet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë nga këto derivate ose që lidhet drejtpërdrejt me kontratën përkatëse spot të mallrave dhe i cili, nëse do të ishte bërë publik, mund të kishte pasur ndikim të konsiderueshëm në çmimet e këtyre derivateve ose në kontratat përkatëse spot të mallrave dhe kur është informacion që pritet ose kërkohet të zbulohet në përputhje me dispozitat ligjore ose rregullatore në nivel kombëtar ose BE-je, rregullat e tregut, kontratat, praktikat ose zakonet, në tregjet përkatëse të derivateve të mallrave ose në tregjet spot;

c) në lidhje me kuotat e emetimeve ose produktet e hedhura në ankand, informacioni i një natyre specifike që nuk është bërë publik dhe që lidhet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë instrumente dhe i cili nëse do të ishte bërë publik, do të kishte pasur ndikim të konsiderueshëm në çmimet e këtyre instrumenteve financiare ose në çmimet e instrumenteve financiare derivative përkatëse;

d) për personat e ngarkuar me ekzekutimin e urdhrave në lidhje me instrumentet financiare, është gjithashtu informacioni i dhënë nga një klient që lidhet me urdhrat në pritje të klientit në instrumente financiare, i një natyre specifike, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me një ose më shumë emetues apo me një ose më shumë instrumente financiare dhe i cili nëse do të ishte bërë publik, do të kishte ndikim të konsiderueshëm në çmimet e këtyre instrumenteve financiare, çmimin e kontratave përkatëse spot të mallrave ose në çmimin e instrumenteve financiare derivative përkatëse.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, informacioni konsiderohet të jetë i një natyre specifike nëse tregon një sërë rrethanash që ekzistojnë ose që në mënyrë të arsyeshme priten të ekzistojnë ose një ngjarje që ka ndodhur ose që në mënyrë të arsyeshme pritet të ndodhë, kur është mjaftueshëm specifik për të mundësuar nxjerrjen e një konkluzioni në lidhje me ndikimin e mundshëm të këtij grupi rrethanash ose ngjarjesh në çmimet e instrumenteve financiare ose të instrumentit financiar derivativ përkatës, të kontratave përkatëse spot të mallrave ose të produkteve të hedhura në ankand në bazë të kuotave të emetimit. Në këtë aspekt, në rastin e një procesi të zgjatur që ka për qëllim të sjellë apo të rezultojë në rrethana ose ngjarje të veçanta, këto rrethana ose ngjarje të ardhshme si dhe hapat e ndërmjetëm të këtij procesi që sjellin ose rezultojnë në këto rrethana ose ngjarje të ardhshme, mund të konsiderohen si informacion specifik.

3. Një hap i ndërmjetëm në një proces të zgjatur konsiderohet si informacion i brendshëm nëse, në vetvete, plotëson kriteret e informacionit të brendshëm të përmendura në këtë nen.

4. Për qëllimet e paragrafit 1, informacioni i cili nëse do të ishte bërë publik, do të mund të kishte pasur një ndikim të konsiderueshëm në çmimet e instrumenteve financiare, instrumenteve financiare derivative, kontratave përkatëse spot të mallrave ose produkteve të hedhura në ankand në bazë të kuotave të emetimit, është informacion që një investitor i arsyeshëm mund ta përdorte si pjesë të bazës së vendimeve të tij ose të saj të investimeve.

Në rastin e pjesëmarrësve në tregun e kuotave të emetimit me emetime agregate ose të dhëna termike nominale në ose nën përcaktimin e pragut të vendosur në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 17, paragrafi 2, informacioni në lidhje me operacionet e tyre fizike konsiderohet të mos ketë ndonjë ndikim të rëndësishëm në çmimin e kuotave të emetimit, të produkteve të hedhura në ankand në bazë të tyre ose të instrumenteve financiare derivative.

5. ESMA nxjerr udhëzime për të krijuar një listë treguese jo-shteruese të informacionit që në mënyrë të arsyeshme pritet ose kërkohet të zbulohet në përputhje me dispozitat ligjore apo rregullatore të legjislacionit kombëtar ose atij të BE-së, rregullat e tregut, kontratën, praktikën ose zakonet, në lidhje me tregjet përkatëse të derivateve të mallrave ose me tregjet spot të përmendura në germën "b" të paragrafit 1. ESMA i merr në konsideratë specifikat e këtyre tregjeve.

Neni 8

Abuzimi me informacionin e privilegjuar

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, abuzimi me informacionin e privilegjuar ndodh kur një person zotëron informacione të brendshme dhe e përdor atë duke blerë ose shitur, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për llogari të vet ose për llogari të një pale të tretë, instrumentet financiare me të cilat lidhet ky informacion. Përdorimi i informacionit të brendshëm duke anuluar ose ndryshuar urdhrat në lidhje me instrumentet financiare me të cilat ka lidhje informacioni, kur urdhri është caktuar përpara se personi në fjalë të zotëronte informacionin e brendshëm, konsiderohet gjithashtu si abuzim me informacionin e privilegjuar. Për sa i përket ankandeve të kuotave të emetimit ose të produkteve të tjera të hedhura në ankand, të cilat organizohen në pajtim me Rregulloren (BE) nr. 1031/2010, përdorimi i informacionit të brendshëm përfshin gjithashtu dorëzimin, modifikimin ose tërheqjen e ofertës nga një person për llogari të tij ose për llogari të një pale të tretë.

2. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, rekomandimi ose nxitja e një personi tjetër për të abuzuar me informacionin e privilegjuar, lind kur personi zotëron informacion të brendshëm dhe:

a) rekomandon, mbi bazën e këtij informacioni, që një person tjetër të blejë ose të shesë instrumentet financiare me të cilat lidhet ky informacion ose nxit këtë person për të bërë këtë blerje apo shitje, ose

b) rekomandon, mbi bazën e këtij informacioni, që një person tjetër të anulojë ose të ndryshojë urdhrin në lidhje me instrumentin financiar me të cilin lidhet ky informacion ose nxit këtë person për të bërë këtë anulim ose ndryshim.

3. Përdorimi i rekomandimeve ose nxitjeve të përmendura në paragrafin 2 përbën abuzim me informacionin e privilegjuar në kuptimin e këtij neni, nëse personi që përdor rekomandimin ose nxitjen është ose duhet të jetë në dijeni se këto bazohen në informacione të brendshme.

4. Ky nen zbatohet për çdo person që zotëron informacion të brendshëm për shkak se:

a) është anëtar i organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit ose pjesëmarrësit në tregun e kuotave të emetimit;

b) ka pjesëmarrje në kapitalin e emetuesit ose pjesëmarrësit në tregun e kuotave të emetimit;

c) ka akses në informacion nga ushtrimi i punës, profesionit ose detyrave; ose

d) është përfshirë në veprimtari kriminale.

Ky nen zbatohet gjithashtu për çdo person që zotëron informacion të brendshëm në rrethana të ndryshme nga ato të përmendura në nënparagrafin e parë, kur ky person është ose duhet të jetë në dijeni që ky informacion është i brendshëm.

5. Në rastin e një personi juridik, në përputhje me legjislacionin kombëtar, ky nen zbatohet gjithashtu për personat fizikë që marrin pjesë në vendimin për të kryer blerjen, shitjen, anulimin ose ndryshimin e një urdhri për llogari të personit juridik në fjalë.

Neni 9

Sjellje legjitime

1. Për qëllimet e neneve 8 dhe 14, thjesht fakti se personi juridik ka ose ka pasur informacion të brendshëm nuk mjafton që të konsiderohet se ky person e ka përdorur këtë informacion dhe është përfshirë rrjedhimisht në abuzimin me informacionin e privilegjuar në bazë të një blerjeje ose shitjeje, nëse ky person juridik:

a) ka krijuar, zbatuar dhe ruajtur masa dhe procedura të brendshme të përshtatshme dhe efikase që garantojnë në mënyrë efektive që as personi fizik që ka marrë vendimin në emër të tij për të blerë apo shitur instrumentet financiare me të cilat ka lidhje informacioni as ndonjë person tjetër fizik i cili mund të ketë pasur një ndikim në këtë vendim, të mos zotërojnë informacion të brendshëm; dhe

b) nuk ka inkurajuar, rekomanduar, nxitur apo influencuar në ndonjë mënyrë tjetër personin fizik i cili ka blerë ose shitur, në emër të personit juridik, instrumente financiare me të cilat lidhet ky informacion.

2. Për qëllimet e neneve 8 dhe 14, thjesht fakti se një person ka ose ka pasur informacion të brendshëm nuk mjafton që të konsiderohet se ky person e ka përdorur këtë informacion dhe është përfshirë rrjedhimisht në abuzimin me informacionin e privilegjuar në bazë të një blerjeje ose shitjeje, nëse ky person:

a) për instrumentin financiar me të cilin ka lidhje ky informacion, është një krijues tregu ose një person i autorizuar për të vepruar si kundërpalë dhe nëse blerja ose shitja e instrumenteve financiare me të cilat ka lidhje ky informacion bëhet në mënyrë të ligjshme në rrjedhën normale të ushtrimit të funksionit të tij si krijues i tregut ose si kundërpalë për këtë instrument financiar; ose

b) është i autorizuar të ekzekutojë urdhra në emër të palëve të treta dhe nëse blerja ose shitja e instrumenteve financiare me të cilat lidhet urdhri, bëhet për të ekzekutuar këtë urdhër në mënyrë të ligjshme në rrjedhën normale të ushtrimit të punës, profesionit ose detyrave të këtij personi.

3. Për qëllimet e neneve 8 dhe 14, thjesht fakti se një person ka ose ka pasur informacion të brendshëm nuk mjafton që të konsiderohet se ky person e ka përdorur këtë informacion dhe është përfshirë rrjedhimisht në abuzimin me informacionin e privilegjuar në bazë të një blerjeje ose shitjeje, nëse ky person kryen një transaksion për blerjen ose shitjen e instrumenteve financiare dhe nëse transaksioni kryhet në përmbushje të një detyrimi në mirëbesim dhe jo për të anashkaluar ndalimin ndaj abuzimit me informacionin e privilegjuar dhe:

a) nëse detyrimi rrjedh nga një urdhër i caktuar ose marrëveshje e lidhur para se personi në fjalë të zotëronte informacion të brendshëm; ose

b) nëse transaksioni është kryer për të përmbushur një detyrim ligjor ose rregullator që ka lindur para se personi në fjalë të zotëronte informacionin e brendshëm.

4. Për qëllimet e nenit 8 dhe 14, thjesht fakti se një person ka ose ka pasur informacion të brendshëm nuk mjafton që të konsiderohet se ky person e ka përdorur këtë informacion dhe është përfshirë rrjedhimisht në abuzimin me informacionin e privilegjuar, nëse ky person e ka marrë këtë informacion të brendshëm gjatë marrjes nën kontroll ose shkrirjes me një kompani dhe e përdor atë vetëm për qëllimin e procedimit me shkrirjen ose marrjen nën kontroll, me kusht që në momentin e miratimit të shkrirjes ose pranimit të ofertës nga aksionarët e kësaj shoqërie të gjitha këto informacione të jenë bërë publike ose të mos përbëjnë më informacione të brendshme.

Ky paragraf nuk zbatohet për krijimin e kapitalit.

5. Për qëllimet e nenit 8 dhe 14, thjesht fakti se një person përdor faktin se e di që ai ka vendosur të blejë ose të shesë instrumente financiare për blerjen ose shitjen e këtyre instrumenteve financiare nuk përbën në vetvete përdorim të informacionit të brendshëm.

6. Pavarësisht paragrafëve 1 deri 5 të këtij neni, shkelja e ndalimit të abuzimit me informacionin e privilegjuar e përcaktuar në nenin 14 mund të konsiderohet ende të ketë ndodhur, nëse autoriteti kompetent del në përfundimin se ka pasur një arsye të paligjshme për urdhrat për tregtim, transaksionet ose sjelljet në fjalë.

Neni 10

Zbulimi i paligjshëm i informacionit të brendshëm

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, zbulimi i paligjshëm i informacionit të brendshëm ndodh kur personi zotëron informacion të brendshëm dhe e zbulon këtë informacion tek ndonjë person tjetër, përveçse kur zbulimi bëhet gjatë ushtrimit normal të punës, profesionit ose detyrës.

Ky paragraf zbatohet për çdo person fizik dhe juridik në situatat ose rrethanat e përmendura në nenin 8, paragrafi 4.

2. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, zbulimi i mëtejshëm i rekomandimeve ose nxitjeve të përmendura në nenin 8, paragrafi 2 përbën zbulim të paligjshëm të informacionit të brendshëm sipas këtij neni nëse personi që e zbulon këtë rekomandim ose nxitje është ose duhet të jetë në dijeni që ato bazohen në informacionin e brendshëm.

Neni 11

Sondazhet e tregut

1. Sondazhi i tregut përfshin komunikimin e informacionit, përpara shpalljes së një transaksioni, me qëllim vlerësimin e interesit të investitorëve potencialë në një transaksion të mundshëm dhe kushteve që lidhen me të, të tilla si përmasat e mundshme ose çmimi, për një ose më shumë investitorë potencialë nga:

a) një emetues;

b) një ofrues dytësor i një instrumenti financiar, në një sasi ose vlerë të tillë që transaksioni të jetë i ndryshëm nga tregtimi i zakonshëm dhe të përfshijë një metodë shitjeje të bazuar në vlerësimin paraprak të interesit të mundshëm të investitorëve potencialë;

c) një pjesëmarrës në tregun e kuotave të emetimit; ose

d) një palë e tretë që vepron në emër ose në llogari të një personi të përmendur në germën "a", "b" ose "c".

2. Pa cenuar nenin 23, paragrafi 3, zbulimi i informacionit të brendshëm tek palët që gëzojnë të drejta mbi titujt nga një person që synon të bëjë një ofertë për marrjen nën kontroll të titujve të një shoqërie ose shkrirjen me një kompani, përbën gjithashtu një sondazh tregu, me kusht që:

a) informacioni të jetë i nevojshëm për të garantuar që palët që gëzojnë të drejta mbi titujt të krijojnë një opinion në lidhje me gatishmërinë e tyre për t'i ofruar këta tituj: dhe

b) gatishmëria e palëve që gëzojnë të drejta mbi titujt për t'i ofruar ato të jetë e nevojshme për vendimin e realizimit të ofertës së marrjes nën kontroll ose të shkrirjes.

3. Përpara se të zhvillojë një sondazh të tregut, pjesëmarrësi zbulues në treg, merr veçanërisht në konsideratë faktin nëse ky sondazh përbën zbulim të informacionit të brendshëm. Pjesëmarrësi zbulues në treg i mban me shkrim të dhënat e konkluzioneve të tij dhe arsyet përkatëse. Këto të dhëna me shkrim i jepen autoritetit kompetent, me kërkesë. Ky detyrim

zbatohet për çdo zbulim informacioni përgjatë sondazhit të tregut. Rrjedhimisht, pjesëmarrësi zbulues në treg i përditëson të dhënat me shkrim të përmendura në këtë paragraf.

4. Për qëllimet e nenit 10, paragrafi 1, nëse pjesëmarrësi zbulues në treg përmbush kërkesat e paragrafëve 3 dhe 5 të këtij neni, zbulimi i informacionit të brendshëm gjatë një sondazhi të tregut konsiderohet të jetë bërë gjatë ushtrimit normal të punës, profesionit ose detyrave të një personi.

5. Për qëllimet e paragrafit 4, para zbulimit të informacionit, pjesëmarrësi zbulues në treg:

a) merr miratimin e personit për të cilin synohet sondazhi i tregut për të marrë këtë informacion të brendshëm;

b) informon personin për të cilin synohet sondazhi i tregut se ndalohet përdorimi ose tentativa e përdorimit të këtij informacioni, duke blerë ose shitur, për llogari të vet ose për llogari të një pale të tretë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, instrumentet financiare me të cilat lidhet ky informacion;

c) informon personin për të cilin synohet sondazhi i tregut se ndalohet përdorimi ose tentativa e përdorimit të këtij informacioni, duke anuluar ose ndryshuar një urdhër që është caktuar tashmë në lidhje me një instrument financiar me të cilin lidhet ky informacion; dhe

d) informon personin për të cilin synohet sondazhi i tregut se duke rënë dakord për marrjen e këtij informacioni është i detyruar ta mbajë të fshehtë atë.

Pjesëmarrësi zbulues në treg krijon dhe mban një regjistër me të gjitha informacionet që i jepen personit për të cilin synohet sondazhi i tregut, duke përfshirë informacionin e dhënë në përputhje me germat "a" deri në "d" të nënparagrafit të parë dhe identitetin e investitorëve potencialë të cilëve u është zbuluar ky informacion, duke përfshirë por pa u kufizuar me personat juridikë dhe fizikë që veprojnë në emër të investitorit potencial si dhe datën dhe orën e çdo zbulimi. Pjesëmarrësi zbulues në treg ia jep këtë regjistër autoritetit kompetent, me kërkesë.

6. Nëse informacioni që është zbuluar gjatë sondazhit të tregut nuk është më informacion i brendshëm në vlerësimin e pjesëmarrësit zbulues në treg, ky i fundit rrjedhimisht njofton marrësin sa më shpejt që të jetë e mundur.

Pjesëmarrësi zbulues në treg mban një regjistër me informacionet e dhëna në përputhje me këtë paragraf dhe ia dërgon ato autoritetit kompetent, me kërkesë.

7. Pavarësisht nga dispozitat e këtij neni, personi për të cilin synohet sondazhi i tregut vlerëson vetë nëse zotëron apo ndalon së zotëruari informacione të brendshme.

8. Pjesëmarrësi zbulues në treg i ruan regjistrat e përmendur në këtë nen për një periudhë prej të paktën pesë vitesh.

9. Me qëllim garantimin e harmonizimit të vazhdueshëm të këtij neni, ESMA harton draft standarde teknike rregullatore për përcaktimin e masave, procedurave dhe kërkesave të ruajtjes

së regjistrave, në mënyrë që këta persona të përmbushin kushtet e parashikuara nga paragrafët 4, 5, 6 dhe 8.

ESMA, jo më vonë se 3 korriku 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

10. Për të garantuar kushte të njëtrajtshe të zbatimit të këtij neni, ESMA harton draft standarde teknike zbatuese për të specifikuar sistemet dhe modelet e njoftimit që do të përdoren nga personat për të përmbushur kushtet e përcaktuara në paragrafët 4, 5, 6 dhe 8 të këtij neni, veçanërisht formatin specifik të të dhënave të përmendura në paragrafët 4 deri 8 dhe mjetet teknike për komunikimin e duhur të informacionit të përmendur në paragrafin 6 për personin për të cilin synohet sondazhi i tregut.

ESMA i dorëzon Komisionit, jo më vonë se 3 korriku 2015, draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

11. ESMA nxjerr udhëzime në përputhje me nenin 16 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010, drejtuar personave për të cilët synohet sondazhi i tregut, në lidhje me:

a) faktorët që këta persona duhet të marrin në konsideratë kur informacioni u zbulohet si pjesë e një sondazhi tregu në mënyrë që ata të vlerësojnë nëse informacioni përbën informacion të brendshëm;

b) hapat që këta persona duhet të ndërmarrin nëse informacioni i brendshëm u është zbuluar për të përmbushur kërkesat e neneve 8 dhe 10 të kësaj rregulloreje; dhe

c) regjistrat që këta persona duhet të mbajnë për të vërtetuar përputhshmërinë me nenet 8 dhe 10 të kësaj rregulloreje.

Neni 12

Manipulimi i tregut

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, manipulimi i tregut përfshin veprimtaritë e mëposhtme:

a) hyrjen në një transaksion, caktimin e një urdhri për tregtim ose çdo sjellje tjetër e cila:

I. përçon ose ka të ngjarë të përçojë sinjale të rreme ose çorientuese në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e një instrumenti financiar, një kontrate spot të mallrave ose një produkti të hedhur në ankand në bazë të kuotave të emetimit; ose

II. fikson ose ka të ngjarë të fiksojë, çmimin e një ose disa instrumenteve financiare, një kontrate spot të mallrave ose një produkti të hedhur në ankand në bazë të kuotave të emetimit në një nivel jonormal ose artificial;

përveç nëse personi që hyn në një transaksion, që cakton një urdhër për tregtim ose që përfshihet në ndonjë sjellje tjetër, vërteton që ky transaksion, urdhër apo sjellje është kryer për arsye të ligjshme dhe është në përputhje me praktikën e pranuar të tregut të përcaktuar në përputhje me nenin 13;

b) hyrjen në një transaksion, caktimin e një urdhri për tregtim ose çdo veprimtari ose sjellje tjetër që ndikon apo ka të ngjarë të ndikojë në çmimin e një ose disa instrumenteve financiare, të një kontrate spot të mallrave ose të një produkti të hedhur në ankand në bazë të kuotave të emetimit, që përdor pajisje fiktive apo çdo formë tjetër mashtrimi apo sajimi;

c) shpërndarjen e informacionit nëpërmjet medias, përfshirë përmes internetit ose çdo mjeti tjetër që përçon ose ka të ngjarë të përçojë sinjale të rreme ose çorientuese për furnizimin, kërkesën ose çmimin e një instrumenti financiar, një kontrate spot të mallrave ose një produkti të hedhur në ankand në bazë të kuotave të emetimit apo fikson ose ka të ngjarë të fiksojë çmimin e një ose disa instrumenteve financiare, një kontrate spot të mallrave ose një produkti të hedhur në ankand në bazë të kuotave të emetimit në një nivel jonormal ose artificial, duke përfshirë edhe përhapjen e thashethemeve, në rastin kur personi që shpërndan informacionin ka pasur dijeni ose duhet të ketë pasur dijeni se informacioni ka qenë i rremë ose çorientues;

d) përcjelljen e informacioneve të rreme ose çorientuese ose sigurimin e të dhënave të rreme ose çorientuese në lidhje me një referencë nëse personi që ka përcjellë ose siguruar të dhënat ka pasur dijeni ose duhet të ketë pasur dijeni që ato kanë qenë të rreme ose çorientuese ose çdo sjellje tjetër që manipulon llogaritjen e referencave.

2. Sjelljet e mëposhtme konsiderohen ndër të tjera si manipulim i tregut:

a) sjellja e një personi ose personave që veprojnë në bashkëpunim, për të siguruar një pozitë dominuese në furnizimin ose kërkesën për një instrument financiar, kontratë spot të mallrave ose produkte të hedhura në ankand në bazë të kuotave të emetimit, që ka apo ka të ngjarë të ketë ndikim rregullues, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në çmimet e blerjes ose shitjes ose krijon apo ka të ngjarë të krijojë kushte të tjera të padrejta tregtimi;

b) blerja ose shitja e instrumenteve financiare, në hapjen ose mbylljen e tregut, që ka apo ka të ngjarë të ketë ndikim çorientues për investitorët që veprojnë në bazë të çmimeve të paraqitura, duke përfshirë çmimet e hapjes ose mbylljes;

c) caktimi i urdhrave në një vend tregtimi, duke përfshirë çdo anulim ose modifikim të tyre, me anë të çdo mjeti të disponueshëm tregtimi, duke përfshirë edhe mjetet elektronike, siç janë strategjitë e tregtimit algoritmik dhe me frekuencë të lartë dhe që ka një nga efektet e përmendura në paragrafin 1, germa "a" ose "b":

I. duke ndërprerë ose ngadalësuar funksionimin e sistemit tregtar të vendit të tregtimit ose duke pasur të ngjarë ta bëjë këtë;

II. duke vështirësuar identifikimin nga personat e tjerë të urdhrave të mirëfillta në sistemin e tregtimit të vendit të tregtimit ose duke pasur të ngjarë të bëjë këtë, si dhe duke caktuar urdhra që rezultojnë në mbingarkimin ose destabilizimin e librit të urdhrave; ose

III. duke krijuar ose duke pasur të ngjarë të krijojë një sinjal të rremë ose çorientues për furnizimin, kërkesën ose çmimin e një instrumenti financiar, në veçanti duke caktuar urdhra për të nisur ose intensifikuar një prirje;

d) përfitimi nga aksesit rastësor apo i rregullt në median tradicionale ose elektronike përmes shprehjes së mendimit mbi një instrument financiar, kontratë spot të mallrave ose produkt të hedhur në ankand në bazë të kuotave të emetimit (ose tërthorazi për emetuesin e tij) pasi të kenë siguruar paraprakisht pozita në këtë instrument financiar, kontratë spot të mallrave ose produkt të hedhur në ankand në bazë të kuotave të emetimit dhe duke përfituar rrjedhimisht nga ndikimi i mendimeve të dhëna për çmimin e këtij instrumenti financiar, kontrate spot të mallrave ose produkti të hedhur në ankand në bazë të kuotave të emetimit, pa e bërë njëkohësisht publik këtë konflikt interesi, në mënyrë të përshtatshme dhe efikase;

e) blerja ose shitja në tregun dytësor e kuotave të emetimit ose derivateve në lidhje me to, përpara ankandit të organizuar në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1031/2010, që ndikon në palëvizshmërinë e çmimit të mbylljes të ankandit për produktet e hedhura në ankand në një nivel jonorimal ose artificial ose që çorienton ofertuesit që bëjnë ofertat në ankande.

3. Për qëllimet e zbatimit të paragrafit 1, germa "a" dhe "b" dhe pa cenuar format e sjelljes të përcaktuara në paragrafin 2, shtojca I përcakton treguesit jo-shterues në lidhje me përdorimin e pajisjeve fiktive ose të ndonjë forme tjetër të mashtrimit ose të sajimit si dhe treguesit jo-shterues në lidhje me sinjalet e rreme ose çorientuese dhe fiksimin e çmimit.

4. Në rastin e një personi juridik, në përputhje me legjislacionin kombëtar, ky nen zbatohet gjithashtu për personat fizikë që marrin pjesë në vendimin për të kryer veprimtari për llogari të personit juridik në fjalë.

5. Komisioni ka kompetencën të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 35, duke specifikuar treguesit e përcaktuar në shtojcën I me qëllim qartësimin e elementeve të tyre dhe marrjen parasysh të zhvillimeve teknike në tregjet financiare.

Neni 13

Praktikat e pranuar të tregut

1. Ndalimi në nenin 15 nuk zbatohet për veprimtaritë e përmendura në nenin 12, paragrafi 1, germa "a", nëse personi që hyn në një transaksion, që cakton një urdhër për tregtim ose që përfshihet në ndonjë sjellje tjetër, vërteton që ky transaksion, urdhër ose sjellje është kryer për arsye legjitime dhe në përputhje me praktikën e pranuar të tregut, siç është përcaktuar në përputhje me këtë nen.

2. Autoriteti kompetent mund të vendosë një praktikë të pranuar tregu, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- a) nëse praktika e tregut siguron një nivel të konsiderueshëm transparence në treg;
- b) nëse praktika e tregut garanton një nivel të lartë masash mbrojtëse për funksionimin e forcave të tregut dhe bashkëveprimin e përshtatshëm të forcave të kërkesës dhe ofertës;
- c) nëse praktika e tregut ka ndikim pozitiv në likuiditetin dhe efikasitetin e tregut;
- d) nëse praktika e tregut merr parasysh mekanizmin e tregtimit të tregut përkatës dhe u mundëson pjesëmarrësve në treg që të reagojnë në mënyrë dhe në kohën e duhur në situatën e re të tregut të krijuar nga kjo praktikë;
- e) nëse praktika e tregut nuk rrezikon integritetin e tregjeve të lidhura drejtpërdrejtë ose tërthorazi, të rregulluara ose jo, në instrumentin përkatës financiar brenda BE-së;
- f) rezultatin e hetimeve të praktikës përkatëse të tregut nga autoritetet kompetente ose nga një autoritet tjetër, veçanërisht nëse praktika përkatëse e tregut ka shkelur rregullat ose rregulloret e hartuara për të parandaluar abuzimin në treg ose kodet e sjelljes, pavarësisht nëse ka të bëjë me tregun përkatës apo tregjet e lidhura drejtpërdrejtë ose tërthorazi brenda BE-së; dhe
- g) karakteristikat strukturore të tregut përkatës, ndër të tjera, nëse është i rregulluar apo jo, llojet e instrumenteve financiare të tregtuara dhe llojin e pjesëmarrësve në treg, duke përfshirë edhe shkallën e pjesëmarrjes së investitorëve individë në tregun përkatës.

Praktika e tregut e caktuar nga një autoritet kompetent si një praktikë e pranuar në një treg të caktuar, nuk konsiderohet të jetë e zbatueshme në tregjet e tjera përveç nëse autoritetet kompetente të këtyre tregjeve të tjera e kanë pranuar këtë praktikë në përputhje me këtë nen.

3. Përpara se të caktohet një praktikë e pranuar tregu në përputhje me paragrafin 2, autoriteti kompetent njofton ESMA-n dhe autoritetet e tjera kompetente për qëllimin e tij për të caktuar një praktikë të pranuar tregu dhe siguron të dhënat e këtij vlerësimi të bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin 2. Ky njoftim bëhet të paktën tre muaj para se praktika e pranuar e tregut të hyjë në fuqi.

4. Dy muaj nga marrja e njoftimit, ESMA i jep autoritetit kompetent njoftues një mendim ku vlerësohet përputhshmëria e praktikës së pranuar të tregut me paragrafin 2 dhe me standardet teknike rregullatore të miratuara sipas paragrafit 7. ESMA vlerëson gjithashtu nëse besimi në tregun financiar të BE-së do të kërcënohej nga caktimi i praktikës së pranuar të tregut. Opinioni botohet në faqen e internetit të ESMA-s.

5. Nëse një autoritet kompetent cakton një praktikë të pranuar tregu në kundërshtim me mendimin e dhënë nga ESMA në përputhje me paragrafin 4, ai publikon në faqen e tij të internetit, brenda 24 orëve nga caktimi i praktikës së pranuar të tregut një njoftim që shpjegon plotësisht arsyet përkatëse, duke përfshirë arsyen se pse praktika e pranuar e tregut nuk e kërcënon besimin në tregut.

6. Nëse një autoritet kompetent konsideron se një autoritet tjetër kompetent ka caktuar një praktikë të pranuar tregut që nuk plotëson kriteret e përcaktuara në paragrafin 2, ESMA asiston

autoritetet në fjalë për të arritur një marrëveshje në përputhje me kompetencat e saj sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Nëse autoritetet kompetente nuk arrijnë një marrëveshje, ESMA mund të marrë një vendim në përputhje me nenin 19, paragrafi 3, të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

7. Për të garantuar harmonizimin e vazhdueshëm të këtij neni, ESMA duhet të hartojë draft standarde teknike rregullatore që specifikojnë kriteret, procedurën dhe kërkesat për krijimin e një praktike të pranuar të tregut sipas paragrafëve 2, 3 dhe 4 si dhe kërkesat për vazhdimin, ndërprerjen ose modifikimin e kushteve për pranimin e saj.

ESMA, jo më vonë se 3 korriku 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

8. Autoritetet kompetente rishikojnë rregullisht dhe të paktën çdo dy vjet praktikën e pranuar të tregut që kanë caktuar, në veçanti duke marrë parasysh ndryshimet e konsiderueshme në mjedisin përkatës të tregut, siç janë ndryshimet në rregullat e tregtimit ose në infrastrukturën e tregut, me synimin për të vendosur nëse do ta vazhdojnë, ndërpresin apo do të modifikojnë kushtet për pranimin e saj.

9. ESMA publikon në faqen e saj të internetit një listë të praktikave të pranuar të tregut dhe të shteteve anëtare ku ato janë të zbatueshme.

10. ESMA monitoron zbatimin e praktikave të pranuar të tregut dhe i paraqet Komisionit një raport vjetor për mënyrën e zbatimit të tyre në tregjet në fjalë.

11. Autoritetet kompetente njoftojnë ESMA-n për praktikën e pranuar të tregut që kanë caktuar, para datës 2 korrik të vitit 2014, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e standardeve teknike rregullatore të përmendura në paragrafin 7.

Praktikat e pranuar të tregut të përmendura në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi vazhdojnë të zbatohen në shtetin anëtar në fjalë derisa autoriteti kompetent të ketë marrë një vendim lidhur me vazhdimin e kësaj praktike duke respektuar mendimin e ESMA-s në përputhje me paragrafin 4.

Neni 14

Ndalimi i abuzimit me informacionin e privilegjuar dhe i zbulimit të paligjshëm të informacionit të brendshëm

Një person nuk mund:

a) të përfshihet ose të tentojë të përfshihet në abuzimin me informacionin e privilegjuar;

b) të rekomandojë ose të nxisë një person tjetër që të përfshihet në abuzimin me informacionin e privilegjuar; ose

c) të zbulojë në mënyrë të paligjshme informacione të brendshme.

Neni 15

Ndalimi i manipulimit të tregut

Një person nuk mund të përfshihet ose të përpiqet të përfshihet në manipulimin e tregut.

Neni 16

Parandalimi dhe zbulimi i abuzimit në treg

1. Operatorët e tregut dhe shoqëritë e investimit që operojnë në një vend tregtimi krijojnë dhe mbajnë masa, sisteme dhe procedura efikase që synojnë parandalimin dhe zbulimin e abuzimit me informacionin e privilegjuar, manipulimin e tregut dhe përpjekjet për abuzimin me informacionin e privilegjuar dhe manipulimin e tregut, në përputhje me nenet 31 dhe 54 të Direktivës 2014/65/BE.

Personi i përmendur në nënparagrafin e parë i raporton pa vonesa autoritetit kompetent të vendit të tregtimit urdhrat dhe transaksionet, duke përfshirë të gjitha anulimet ose modifikimet e tyre, të cilat mund të përbëjnë abuzim me informacionin e privilegjuar, manipulim të tregut ose përpjekje për abuzimin me informacionin e privilegjuar ose manipulimin e tregut.

2. Çdo person që rregullon ose ekzekuton në mënyrë profesionale transaksionet, krijon dhe mban masa, sisteme dhe procedura efikase për zbulimin dhe raportimin e urdhrave dhe transaksioneve të dyshimta. Kur ky person dyshon me arsye se një urdhër ose transaksion në ndonjë instrument financiar, qoftë i caktuar ose i ekzekutuar në ose jashtë një vendi tregtimi, mund të përbëjë abuzim me informacionin e privilegjuar, manipulim të tregut ose përpjekje për abuzim me informacionin e privilegjuar ose manipulim të tregut, ai njofton pa vonesa autoritetin kompetent siç përmendet në paragrafin 3.

3. Pa paragjykuar nenin 22, personat që rregullojnë ose ekzekutojnë në mënyrë profesionale transaksionet i nënshtrohen rregullave të njoftimit të shtetit anëtar në të cilin janë regjistruar ose kanë selinë e tyre ose në rastin e një dege shteti anëtar ku është vendosur kjo degë. Njoftimi i drejtohet autoritetit kompetent të këtij shteti anëtar.

4. Autoritetet kompetente të përmendura në paragrafin 3 që marrin njoftimin për urdhrat dhe transaksionet e dyshimta, ia transmetojnë këto informacione menjëherë autoriteteve kompetente të vendeve të tregtimit në fjalë.

5. Me qëllim garantimin e harmonizimit e qëndrueshëm të këtij neni, ESMA harton draft standarde teknike rregullatore për përcaktimin e:

a) masave, sistemeve dhe procedurave përkatëse në mënyrë që personat të përmbushin kushtet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2; dhe

b) modeleve të njoftimit që do të përdoren nga personat për të përmbushur kushtet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2.

ESMA ia dorëzon Komisionit këto draft standarde teknike rregullatore, jo më vonë se 3 korriku 2016.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

KREU III

KËRKESAT PËR ZBULIMIN E INFORMACIONIT

Neni 17

Zbulimi i informacionit të brendshëm për publikun

1. Emetuesi duhet të informojë publikun sa më shpejt të jetë e mundur për informacionin e brendshëm që përbën shqetësim direkt për emetuesin.

Emetuesi duhet të sigurohet që informacioni i brendshëm bëhet publik në mënyrë të atillë që mundëson akses të shpejtë dhe vlerësim të plotë, korrekt dhe në kohë të informacionit nga publiku dhe, kur është e mundur, në mekanizmin e përcaktuar zyrtarisht që përmendet në nenin 21 të Direktivës 2004/109/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit²⁴. Emetuesi nuk duhet ta kombinojë zbulimin e informacionit të brendshëm për publikun me marketimin e aktiviteteve të tij. Emetuesi duhet të postojë dhe mbajë në faqen e tij të internetit për një periudhë prej të paktën pesë vitesh, të gjithë informacionin e brendshëm që i kërkohet të zbulojë publikisht.

Ky nen zbatohet për emetuesit të cilët kanë kërkuar ose miratuar pranimin për tregtim të instrumenteve të tyre financiare në një treg të rregulluar në një shtet anëtar ose, në rastin e instrumenteve që tregtohen vetëm në një MTF ose një OTF, emetuesit të cilët kanë miratuar tregtimin e instrumenteve të tyre financiare në një MTF ose OTF apo që kanë kërkuar pranim për tregtim të instrumenteve të tyre financiare në një MTF në shtetin anëtar.

2. Pjesëmarrësi në tregun e të drejtave të emetimit do të zbulojë publikisht, me efikasitet dhe në kohë informacionin e brendshëm për të drejtat e emetimit që mban lidhur me biznesin e tij, duke përfshirë aktivitetet e aviacionit siç specifikohen në shtojcën I të direktivës 2003/87/KE ose instalimet sipas kuptimit të nenit 3 germa "e" të asaj direktive që zotërohen ose kontrollohen nga pjesëmarrësi në fjalë apo nga shoqëria mëmë ose shoqëritë e lidhura me të, ose për çështjet operationale për të cilat pjesëmarrësi apo shoqëria e tij mëmë ose shoqëria e lidhur me të është përgjegjëse plotësisht ose pjesërisht. Sa i përket instalimeve, ky zbulim do të përfshijë informacionin për kapacitetin dhe shfrytëzimin e instalimeve, duke përfshirë padisponueshmërinë e planifikuar ose të paplanifikuar të këtyre instalimeve.

Paragrafi i parë nuk do të zbatohet për pjesëmarrësin në tregun e të drejtave të emetimit në rastin kur instalimet ose veprimtaritë e aviacionit që ai zotëron, kontrollon ose është përgjegjës, në vitin paraardhës kanë pasur emetime që nuk e tejkalojnë prapun minimal të

dyoksidit të karbonit ekuivalent dhe, kur kryejnë aktivitete djegieje, kanë pasur energji termike nominale që nuk e tejkalon pragun minimal.

Komisioni ka kompetencën të miratojë akte të deleguara në pajtim me nenin 35 që përcakton një prag minimal të dyoksidit të karbonit ekuivalent dhe pragun minimal të energjisë termike nominale për qëllime të zbatimit të përjashtimit që parashikohet në nënparagrafin e dytë të këtij paragrafi.

3. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 35 që specifikon autoritetin kompetent për njoftimet e paragrafëve 4 dhe 5 të këtij neni.

4. Emetuesi ose pjesëmarrësi në tregun e të drejtave të emetimit, me përgjegjësinë e tij vetjake, mund të vonojë zbulimin e informacionit të brendshëm për publikun me kusht që të përmbushen të gjitha kushtet vijuese:

a) zbulimi i menjëhershëm ka gjasa të cenojë interesat legjitime të emetuesit ose të pjesëmarrësit në tregun e të drejtave të emetimit;

b) vonesa në zbulim nuk ka gjasa të çorientojë publikun;

c) emetuesi ose pjesëmarrësi në tregun e të drejtave të emetimit ka aftësi të garantojë konfidencialitetin e atij informacioni.

Në rastin e një procesi të zgjatur që ndodh në faza dhe që ka për qëllim të sjellë apo të rezultojë në rrethana të caktuara apo ngjarje të caktuara, emetuesi ose pjesëmarrësi në tregun e të drejtave të emetimit me përgjegjësi të tij mund të vonojë zbulimin e informacionit të brendshëm për publikun që lidhet me këtë proces, në bazë të germave "a", "b" dhe "c" të paragrafit të parë.

Në rastin kur emetuesi ose pjesëmarrësi në tregun e të drejtave të emetimit ka vonuar zbulimin e informacionit të brendshëm sipas këtij paragrafi, ai duhet ta informojë autoritetin kompetent të specifikuar në paragrafin 3 se zbulimi i informacionit është vonuar dhe duhet të japë një shpjegim me shkrim për mënyrën se si janë përmbushur kushtet e parashtruara në këtë paragraf, menjëherë pasi informacioni të jetë zbuluar për publikun. Përndryshe, shtetet anëtare mund të parashikojnë se regjistri i këtij shpjegimi duhet të jepet vetëm me kërkesë të autoritetit kompetent të specifikuar në paragrafin 3.

5. Me qëllim ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar, emetuesi i cili është institucion krediti ose institucion financiar, me përgjegjësi të tij, mund ta vonojë zbulimin e informacionit të brendshëm për publikun, duke përfshirë informacionin i cili lidhet me probleme të përkohshme likuiditeti dhe, në veçanti, me nevojën për të marrë asistencë likuiditeti të përkohshëm nga banka qendrore ose huadhënësi i fundit, me kusht që të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) zbulimi i informacionit të brendshëm përfshin rrezikun e cenimit të stabilitetit financiar të emetuesit dhe të sistemit financiar;

b) është në interes të publikut për të vonuar zbulimin e informacionit;

c) mund të garantohet konfidencialiteti i atij informacioni; dhe

d) autoriteti kompetent i specifikuar sipas paragrafit 3 ka dhënë miratimin për këtë vonesë me kusht që të përmbushen kushtet në germa "a", "b" dhe "c".

6. Për qëllime të germave "a" deri në "d" të paragrafit 5, emetuesi duhet të njoftojë autoritetin kompetent të specifikuar në paragrafin 3 për qëllimin e tij për të vonuar zbulimin e informacionit të brendshëm dhe të japë prova se kushtet e parashtruara në pikat "a", "b" dhe "c" të paragrafit 5 janë përmbushur. Autoriteti kompetent i specifikuar sipas paragrafit 3, sipas rastit, duhet të konsultohet me bankën qendrore ose autoritetin makroprudencial, në vendin e themelimit, ose në të kundërt, me autoritetet vijuese:

a) në rastin kur emetuesi është një institucion krediti ose një firmë investimi autoriteti i caktuar në pajtim me nenin 133 paragrafi 1 të Direktivës 2013/36/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit²⁵;

b) në raste të ndryshme nga ato të përmendura në germën "a", çdo autoritet tjetër i brendshëm përgjegjës për mbikëqyrjen e emetuesit.

Autoriteti kompetent i specifikuar në paragrafin 3 duhet të sigurojë se zbulimi i informacionit të brendshëm vonohet vetëm për një periudhë të caktuar në favor të interesit publik. Autoriteti kompetent i specifikuar sipas paragrafit 3 duhet të vlerësojë të paktën çdo javë nëse vijojnë të përmbushen kushtet që parashtrohen në germa "a", "b" dhe "c" të paragrafit 5.

Nëse autoriteti kompetent i specifikuar në paragrafin 3 nuk jep miratimin për vonesën në zbulimin e informacionit të brendshëm, emetuesi duhet ta zbulojë menjëherë informacionin e brendshëm.

Ky paragraf zbatohet për rastet kur emetuesi nuk vendos të vonojë zbulimin e informacionit të brendshëm në pajtim me paragrafin 4.

Referenca në këtë paragraf për autoritetin kompetent të specifikuar në paragrafin 3 nuk cenon aftësinë e autoritetit kompetent për të ushtruar funksionet e tij në një nga mënyrat e përmendura në nenin 23 paragrafi 1.

7. Në rastin kur zbulimi i informacionit të brendshëm është vonuar në pajtim me paragrafin 4 ose 5 dhe konfidencialiteti i atij informacioni të brendshëm nuk garantohet më, emetuesi ose pjesëmarrësi në tregun e të drejtave të emetimit do ta zbulojë informacionin e brendshëm për publikun sa më shpejt të jetë e mundur.

Ky paragraf përfshin situatat kur një thashethem lidhet në mënyrë eksplicite me informacionin e brendshëm, zbulimi i të cilit është vonuar në pajtim me paragrafin 4 ose 5, në rastin kur ai thashethem është mjaftueshëm i saktë për të treguar se konfidencialiteti i atij informacioni tashmë nuk është më i garantuar.

8. Në rastin kur emetuesi ose pjesëmarrësi në tregun e të drejtave të emetimit, ose një person i cili vepron për llogari të tyre ose në emër të tyre, zbulon ndonjë informacion të brendshëm për çdo palë të tretë gjatë veprimtarisë normale të ushtrimit të punës, profesionit ose detyrave siç përmenden në nenin 10 paragrafi 1, ata duhet ta zbulojnë informacionin plotësisht dhe me efikasitet, njëkohësisht në rastin e një zbulimi të qëllimtë, dhe menjëherë në rastin e një

zbulimi të paqëllimtë. Ky paragraf nuk zbatohet nëse personi që e merr i informacionin ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit, pavarësisht nëse ky detyrim bazohet në ligj, rregullore, akt themelimi ose kontratë.

9. Informacioni i brendshëm që lidhet me emetues instrumentet financiare të të cilëve pranohen për tregtim në një treg në rritje të SME-ve, mund të postohet në faqen e internetit të vendit të tregtimit në vend të postimit në faqen e internetit të emetuesit, gjithmonë në rastet kur vendi i tregtimit e ofron këtë instrument për emetuesit në atë treg.

10. Me qëllim garantimin e kushteve uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA do të hartojë draft standardet teknike zbatuese për të përcaktuar:

a) mjetet teknike për zbulimin e duhur të informacionit të brendshëm siç përmendet në paragrafët 1, 2, 8 dhe 9; dhe

b) mjetet teknike për të vonuar zbulimin e informacionit të brendshëm për publikun siç përmendet në paragrafët 4 dhe 5.

ESMA i dorëzon Komisionit, jo më vonë se 3 korriku 2016, draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

11. ESMA nxjerr udhëzime për të përcaktuar listën treguese joshteruese të interesave legjitimë të emetuesve, siç përmenden në germën "a" të paragrafit 4 dhe të situatave në të cilat vonesa në zbulimin e informacionit të brendshëm ka gjasa ta çorientojë publikun siç përmendet në germën "b" të paragrafit 4.

Neni 18

Lista e personave të brendshëm

1. Emetuesit apo çdo person i cili vepron për llogarinë e tyre ose në emër të tyre, do

a) të hartojë një listë të të gjithë personave që kanë akses në informacionin e brendshëm dhe që punojnë për ta sipas një kontrate pune, apo që kryejnë detyra përmes të cilave ata kanë akses në informacionin e brendshëm, të tillë si këshilltarë, kontabilistë ose agjencitë e vlerësimit të kredive (lista e personave të brendshëm);

b) të përditësojë siç duhet listën e personave të brendshëm në pajtim me paragrafin 4; dhe

c) t'ia japë sa më shpejt të jetë e mundur listën e personave të brendshëm autoritetit kompetent me kërkesë të këtij të fundit.

2. Emetuesit ose çdo person që vepron për llogari të tyre ose në emër të tyre, duhet të marrë të gjitha hapat e arsyeshme për të garantuar që çdo person në listën e personave të brendshëm i njeh me shkrim detyrat ligjore dhe rregullatore që përfshihen dhe është i

ndërgjegjshëm për sanksionet e zbatueshme lidhur me abuzimin me informacionin e privilegjuar dhe zbulimin e paligjshëm të informacionit të brendshëm.

Në rastin kur personi që vepron për llogari ose në emër të emetuesit merr përsipër detyrën e hartimit dhe përditësimit të listës së personave të brendshëm, emetuesi mban përgjegjësi të plotë për pajtueshmërinë me këtë nen. Emetuesi duhet të mbajë gjithmonë të drejtën e aksesit në listën e personave të brendshëm.

3. Lista e personave të brendshëm duhet të përfshijë të paktën:

- a) identitetin e çdo personi që ka akses në informacionin e brendshëm;
- b) arsyen për përfshirjen e atij personi në listën e personave të brendshëm;
- c) datën dhe orën në të cilën ai persona ka marrë aksesin në informacionin e brendshëm; dhe
- d) datën në të cilën është hartuar lista e personave të brendshëm.

4. Emetuesit ose çdo person që vepron për llogari të tyre ose në emër të tyre duhet ta përditësojë siç duhet listën e personave të brendshëm, duke përfshirë datën e përditësimit, sipas rrethanave vijuese:

- a) në rastin kur ka ndryshim në arsyen për përfshirjen e personave që tashmë gjenden në listën e personave të brendshëm;
- b) në rastin kur ka një person të ri i cili ka akses në informacionin e brendshëm dhe, si rrjedhojë, duhet të shtohet në listën e personave të brendshëm; dhe
- c) në rastin kur personi pushon së pasuri akses në informacionin e brendshëm.

Çdo përditësim duhet të specifikojë datën dhe orën kur ka ndodhur ndryshimi që ka nxitur përditësimin.

5. Emetuesit ose çdo person që vepron për llogari të tyre ose në emër të tyre duhet ta mbajë listën e personave të brendshëm për një periudhë të paktën pesë vjeçare pas hartimit ose përditësimit të saj.

6. Emetuesit, instrumentet financiare të të cilëve pranohen për tregtim në një treg në rritje të SME-ve, përjashtohen nga hartimi i listës së personave të brendshëm, me kusht që të përmbushen kushtet e mëposhtme:

- a) emetuesit të ketë marrë të gjitha hapat e arsyeshme për të garantuar që çdo person me akses në informacionin e brendshëm t'i njohë me shkrim detyrat ligjore dhe rregullatore që përfshihen dhe të jetë i ndërgjegjshëm për sanksionet e zbatueshme lidhur me abuzimin me informacionin e privilegjuar dhe zbulimin e paligjshëm të informacionit të brendshëm; dhe

b) emetuesi të jetë në gjendje të sigurojë, me kërkesë të autoritetit kompetent, listën e personave të brendshëm.

7. Ky nen zbatohet për emetuesit të cilët kanë kërkuar ose miratuar pranimin për tregtim të instrumenteve të tyre financiare në një treg të rregulluar në një shtet anëtar ose, në rastin e një instrumenti që tregtohet vetëm në një MTF ose një OTF, emetuesit kanë miratuar tregtimin e instrumenteve të tyre financiare në një MTF ose OTF apo kanë kërkuar pranim për tregtim të instrumenteve të tyre financiare në një MTF në shtetin anëtar.

8. Paragrafët 1 deri në 5 të këtij neni zbatohen edhe për:

a) pjesëmarrësit në tregun e kuotave të emetimeve, në lidhje me informacionin e brendshëm për kuotat e emetimeve, i cili rrjedh nga operacionet fizike të pjesëmarrësit në fjalë të tregut të kuotave të emetimeve;

b) çdo platformë ankandi, drejtues ankandi dhe monitorues ankandi në lidhje me ankandet e kuotave të emetimeve ose produktet e tjera të nxjerra në ankand të bazuara në to, të cilat mbahen sipas Rregullores së Komisionit (BE) nr. 1031/2010.

9. Me qëllim garantimin e kushteve uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA harton draft standarde teknike zbatuese për përcaktimin e formatit preciz të listave të personave të brendshëm dhe të formatit të përditësimit të listave të përmendura në këtë nen.

ESMA i dorëzon Komisionit, jo më vonë se 3 korriku 2016, draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 19

Transaksionet e administratorëve

1. Personat me përgjegjësi administruese si dhe personat e lidhur ngushtë me ta, njoftojnë emetuesin ose pjesëmarrësin në tregun e kuotave të emetimeve dhe autoritetin kompetent të përmendur në nënparagrafin e dytë të paragrafit 2:

a) në lidhje me emetuesit, për çdo transaksion të kryer për llogari të tyre, në lidhje me aksionet ose instrumentet e borxhit të emetuesit në fjalë, ose për derivativët ose instrumentet e tjera financiare të lidhura me to.

b) në lidhje me pjesëmarrësit në tregun e kuotave të emetimeve, për çdo transaksion të kryer për llogari të tyre, në lidhje me kuotat e emetimeve, produktet e ankandit ose derivativët të lidhura me to.

Këto njoftime jepen menjëherë dhe jo më vonë se tri ditë pune pas datës së transaksionit.

Nënparagrafi i parë zbatohet pasi të jetë arritur kufiri i shumës totale të transaksioneve të përcaktuar në paragrafin 8 ose 9, sipas rastit, brenda një viti kalendarik.

2. Për qëllime të paragrafit 1 dhe pa cenuar të drejtën e shteteve anëtare për të parashikuar detyrime për dhënie njoftimi të ndryshme nga ato të përmendura në këtë nen, të gjitha transaksionet e kryera për llogari të personave të përmendur në paragrafin 1 i njoftohen autoriteteve kompetente nga vetë këta persona.

Rregullat e zbatueshme për dhënien e njoftimeve, të cilat duhet të respektohen nga personat e përmendur në paragrafin 1, janë ato të shtetit anëtar ku është regjistruar emetuesi ose pjesëmarrësi në tregun e kuotave të emetimeve. Njoftimet i jepet autoritetit kompetent të shtetit anëtar në fjalë brenda tre ditëve pune nga data e transaksionit. Nëse emetuesi nuk është i regjistruar në një shtet anëtar, njoftimi i jepet autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës në përputhje me pikën I të nenit 2, paragrafi 1, të Direktivës 2004/109/KE ose, në mungesë të tij, i jepet autoritetit kompetent të vendit të tregtimit.

3. Emetuesi ose pjesëmarrësi në tregun e kuotave të emetimeve sigurohet që informacioni i përcjellë në përputhje me paragrafin 1 të bëhet publik menjëherë dhe jo më vonë se tri ditë pune pas datës së transaksionit, në një mënyrë të tillë që mundësohet akses i shpejtë në informacionin në fjalë, mbi baza jodiskriminuese, në përputhje me standardet teknike zbatuese të përmendura në germën "a" të nenit 17, paragrafi 10.

Emetuesi ose pjesëmarrësi në tregun e kuotave të emetimeve përdor mjete të tilla komunikimi që mund të garantojnë përhapjen efikase në publik të informacionit kudo në BE dhe, sipas rastit, ai përdor mekanizmin e përcaktuar zyrtarisht të përmendur në nenin 21 të Direktivës 2004/109/KE.

Përndryshe, legjislacioni i brendshëm mund të parashikojë që autoriteti kompetent të bëjë vetë publik informacionin.

4. Ky nen zbatohet për emetuesit, të cilët:

a) kanë kërkuar ose miratuar pranimin për tregtim të instrumenteve të tyre financiare në një treg të rregulluar; ose

b) në rastin e një instrumenti që tregtohet vetëm në një MTF ose një OTF, kanë miratuar tregtimin e instrumenteve të tyre financiare në një MTF ose OTF ose kanë kërkuar pranim për tregtim të instrumenteve të tyre financiare në një MTF.

5. Emetuesit ose pjesëmarrësit në tregun e kuotave të emetimeve njoftojnë me shkrim personin me përgjegjësi administruese për detyrimet që ka në përputhje me këtë nen. Emetuesit ose pjesëmarrësit në tregun e kuotave të emetimeve hartojnë listën e të gjithë personave me përgjegjësi administruese dhe të personave të lidhur ngushtë me ta.

Personat me përgjegjësi administruese njoftojnë me shkrim personat e lidhur ngushtë me ta për detyrimet që kanë sipas këtij neni dhe mbajnë një kopje të këtij njoftimi.

6. Njoftimi për transaksionet të përmendura në paragrafin 1 përmban informacionin si më poshtë:

a) emrin e personit;

b) arsyen e dhënies së njoftimit;

c) emrin e emetuesit përkatës ose të pjesëmarrësit në tregun e kuotave të emetimeve;

d) përshkrimin dhe identifikuesin e instrumentit financiar;

e) natyrën e transaksioneve (p.sh. blerje ose shitje), duke treguar nëse ka të bëjë me përdorimin e programeve të opsioneve të aksioneve ose me shembujt specifikë të përcaktuar në paragrafin 7;

f) datën dhe vendin e transaksionit; dhe

g) çmimin dhe volumin e transaksioneve. Në rastin e një garancie kushtet e së cilës parashikojnë ndryshimin e vlerës së saj, ky ndryshim duhet të jepet bashkë me vlerën e tij në datën e dhënies së garancisë.

7. Për qëllime të paragrafit 1, transaksionet që duhet të njoftohen, përfshijnë edhe:

a) lënien si garanci ose huadhënien e instrumenteve financiare nga ose në emër të një personi me përgjegjësi administruese ose të personit të lidhur ngushtë me të, siç përmendet në paragrafin 1;

b) transaksionet e ndërmarra nga personat që organizojnë ose ekzekutojnë transaksione me profesionalizëm ose nga një person tjetër në emër të një personi me përgjegjësi administruese ose nga një person të lidhur ngushtë me të, siç përmendet në paragrafin 1, duke përfshirë rastet e ushtrimit të diskrecionit;

c) transaksionet e kryera sipas policës së sigurimit të jetës, të parashikuar në Direktivën 2009/138/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit²⁶, kur:

I. mbajtësi i policës është një person me përgjegjësi administruese ose një person i lidhur ngushtë me të, siç përmendet në paragrafin 1,

II. risku i investimit mbulohet nga mbajtësi i policës dhe

III. mbajtësi i policës ka kompetencën ose diskrecionin të marrë vendime investimi lidhur me instrumentet specifike në policën në fjalë të sigurimit të jetës ose të kryejë transaksionet në lidhje me instrumentet specifike për policën në fjalë të sigurimit të jetës.

Për qëllime të germës "a", nuk është e nevojshme të bëhet e ditur garancia ose një interes i ngjashëm sigurie i instrumenteve financiare në lidhje me depozitimin e instrumenteve financiare në një llogari në kujdestari, përveç nëse dhe për sa kohë që garancia në fjalë ose interesi tjetër i sigurisë ka për qëllim sigurimin e një strukture të veçantë krediti.

Për sa kohë që mbajtësit të policës së kontratës së sigurimit i kërkohet të njoftojë për transaksionet sipas këtij paragrafi, shoqëria e sigurimeve nuk ka detyrimin për të njoftuar.

8. Paragrafi 1 zbatohet për çdo transaksion vijues pasi të jetë arritur shuma totale prej 5000 euro brenda një viti kalendarik. Kufiri prej 5000 euro llogaritet duke shtuar të gjitha transaksionet jo të netuara të përmendura në paragrafin 1.

9. Autoriteti kompetent mund të vendosë të rrisë kufirin e përcaktuar në paragrafin 8 deri në 20 000 euro dhe duhet të informojë ESMA-n për vendimin e tij dhe arsyet për marrjen e vendimit, duke iu referuar në mënyrë specifike kushteve të tregut për të miratuar kufirin më të lartë përpara zbatimit të vendimit. ESMA publikon në faqen e saj të internetit listën e kufijve që zbatohen në përputhje me këtë nen dhe arsyet e dhëna nga autoritetet kompetente për kufijtë në fjalë.

10. Ky nen zbatohet edhe për transaksionet e kryera nga personat me përgjegjësi administruese në çdo platformë ankandi, drejtues ankandi ose monitorues ankandi të përfshirë në ankandet e mbajtura në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1031/2010 dhe për personat e lidhur ngushtë me ta, për sa kohë që transaksionet e tyre kanë të bëjnë me kuotat e emetimeve, derivativët e tyre ose produktet e nxjerra në ankand të bazuara në to. Për transaksionet e tyre këta persona njoftojnë platformën përkatëse të ankandit, drejtuesin e ankandit dhe monitoruesin e ankandit dhe, sipas rastit, autoritetin kompetent ku është regjistruar platforma e ankandit, drejtuesi ose monitoruesi i ankandit, sipas rastit. Informacioni që përcillet në këtë mënyrë, bëhet publik nga platformat e ankandit, drejtuesit e ankandit, monitoruesi i ankandit ose autoriteti kompetent në përputhje me paragrafin 3.

11. Pa cenuar nenet 14 dhe 15, personi me përgjegjësi administruese në strukturën e një emetuesi nuk do të kryejë asnjë transaksion për llogari të vet ose për llogari të një pale të tretë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në lidhje me aksionet ose instrumentet e borxhit të emetuesit ose në lidhje me derivativët ose instrumentet e tjera financiare të lidhura me to, gjatë një periudhe të mbyllur prej 30 ditësh kalendarike përpara shpalljes së një raporti financiar të përkohshëm ose të një raporti fundviti që emetuesi është i detyruar ta bëjë publik sipas:

- a) rregullave të vendit të tregtimit ku janë pranuar për tregtim aksionet e emetuesit; ose
- b) legjislacionit të brendshëm.

12. Pa cenuar nenet 14 dhe 15, emetuesi mund të lejojë brenda strukturës së tij që një person me përgjegjësi administruese të kryejë tregti për llogari të vet ose për llogari të një pale të tretë, gjatë një periudhe të mbyllur siç përmendet në paragrafin 11, qoftë:

a) rast pas rasti, për shkak të ekzistencës së rrethanave të jashtëzakonshme, të tilla si vështirësi të rënda financiare, të cilat kërkojnë shitjen e menjëhershme të aksioneve; ose

b) për shkak të karakteristikave të tregtimit përkatës për transaksionet e kryera ose të lidhura me një skemë të aksioneve ose kursimeve të punonjësve, kualifikimit ose të drejtës së aksioneve ose transaksioneve ku interesi i përfitimit në sigurinë përkatëse nuk ndryshon.

13. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 35 që specifikon rrethanat sipas së cilave mund të lejohet tregtimi nga emetuesi gjatë një periudhe të mbyllur, siç përmendet në paragrafin 12, duke përfshirë rrethanat që do të konsideroheshin të jashtëzakonshme dhe llojet e transaksionit që do të arsyetonin lejen për tregtim.

14. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 35, që specifikon llojet e transaksioneve që do të nxiste kërkesën e përmendur në paragrafin 1.

15. Për të garantuar zbatimin uniform të paragrafit 1, ESMA harton draft standarde teknike zbatuese për formatin dhe modelin në të cilin do të përcillet dhe do të bëhet publik informacioni i përmendur në paragrafin 1.

ESMA i dorëzon Komisionit, jo më vonë se 3 korriku 2015, draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 20

Rekomandimet dhe statistikat e investimeve

1. Personat që bëjnë ose shkëmbejnë rekomandime për investime ose informacione të tjera që rekomandojnë ose sugjerojnë një strategji investimi, duhet të tregojnë kujdesin e arsyeshëm në mënyrë që ky informacion të prezantohet në mënyrë objektive dhe të paraqesë interesat e tyre ose të identifikojë konfliktet e interesit në lidhje me instrumentet financiare me të cilat lidhet informacioni.

2. Institucionet publike që shpërndajnë statistika ose parashikime të cilat kanë gjasa të kenë një ndikim të konsiderueshëm në tregjet financiare, duhet t'i shpërndajnë ato në mënyrë objektive dhe transparente.

3. Për të garantuar harmonizimin e vazhdueshëm të këtij neni, ESMA harton draft standarde teknike rregullatore për të përcaktuar masat teknike për kategoritë e personave të përmendur në paragrafin 1, për prezantimin objektiv të rekomandimeve të investimit dhe të informacioneve të tjera që rekomandojnë ose sugjerojnë një strategji investimi si dhe për dhënien e informacionit për interesa të veçanta ose identifikime të konflikteve të interesit.

ESMA, jo më vonë se 3 korriku 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Masat teknike të përcaktuara në standardet teknike rregullatore të përmendura në paragrafin 3 nuk zbatohen për gazetarët të cilët janë subjekt i një rregullimi të përshtatshëm përkatës në një shtet anëtar, duke përfshirë vetërregullimin ekuivalent të përshtatshëm, me kusht

që një rregullim i tillë të arrijë efekte të ngjashme me ato të masave teknike. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e këtij rregullimi ekuivalent të përshtatshëm.

Neni 21

Përhapja dhe shpërndarja e informacionit në media

Për qëllime të nenit 10, nenit 12, paragrafi 1, germa "c" dhe nenit 20, nëse informacioni përhapet ose shpërndahet dhe nëse rekomandimet jepen ose shpërndahen për qëllime gazetarie ose formash të tjera të shprehjes në media, një përhapje apo shpërndarje e tillë e informacionit vlerësohet duke marrë parasysh rregullat që rregullojnë lirinë e shtypit dhe lirinë e shprehjes në mediat e tjera si dhe rregullat ose kodet që rregullojnë profesionin e gazetarëve, përveç nëse:

a) personat në fjalë ose personat e lidhur ngushtë me ta, përftojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një avantazh ose fitime nga përhapja ose shpërndarja e informacionit në fjalë; ose

b) përhapja ose shpërndarja bëhet me synimin për të çorientuar tregun në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e instrumenteve financiare.

KREU IV

ESMA DHE AUTORITETET KOMPETENTE

Neni 22

Autoritetet kompetente

Pa cenuar kompetencat e autoriteteve juridike, çdo shtet anëtar cakton një autoritet kompetent të vetëm administrativ për qëllimet e kësaj direktive. Për sa më lart, shtetet anëtare informojnë Komisionin, ESMA-n dhe autoritetet e tjera kompetente të shteteve anëtare. Autoriteti kompetent garanton zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje në territorin e tij, lidhur me masat e marra në të dhe për masat e marra jashtë territorit të tij lidhur me instrumentet e pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, për të cilat është bërë një kërkesë për praninë tregtimi në një treg të tillë, të nxjerra në ankand në platformën e ankandit ose të cilat tregtohen në një MTF ose OTF ose për të cilat është bërë një kërkesë për tregtim në një MTF që operon brenda territorit të tij.

Neni 23

Kompetencat e autoriteteve kompetente

1. Autoritetet kompetente i ushtrojnë funksionet dhe kompetencat e tyre në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) në mënyrë të drejtpërdrejtë;

b) në bashkëpunim me autoritete të tjera ose me ndërmarrje të tregut;

c) duke ua deleguar ato këtyre autoriteteve ose ndërmarrjeve të tregut, nën përgjegjësinë e tyre;

d) duke aplikuar tek autoritetet kompetente gjyqësore.

2. Për të përmbushur detyrat e tyre sipas kësaj rregulloreje, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, autoritetet kompetente kanë së paku kompetencat mbikëqyrëse dhe hetimore si më poshtë:

a) të aksesojnë të gjitha dokumentet dhe të dhënat e çfarëdolloji dhe të marrin ose të zotërojnë një kopje të tyre;

b) të kërkojnë informacion nga çdo person, duke përfshirë edhe ata që përfshihen në përcjelljen e urdhrave apo kryerjen e veprimeve përkatëse, si dhe drejtorët e tyre, dhe nëse është e nevojshme, të thërrasin dhe pyesin këta persona për të marrë informacione;

c) në lidhje me derivatet e mallrave, të kërkojnë informacion nga pjesëmarrësit e tregut në tregjet përkatëse spot sipas formateve të standardizuara, të marrin raporte për transaksionet dhe të kenë akses të drejtpërdrejtë në sistemet e tregtarëve;

d) të kryejnë inspektime dhe hetime në terren në vende të ndryshme nga banesat private të personave fizikë;

e) në përputhje me nënparagrafin e dytë, të hyjnë në ambientet e personave fizikë dhe juridikë me qëllim konfiskimin e dokumenteve dhe të dhënave në çdo formë, në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se dokumentet ose të dhënat që kanë të bëjnë me rëndësinë e çështjes së inspektimit ose hetimit mund të jenë relevante për të provuar një rast të abuzimit me informacionet e privileguara apo të manipulimit të tregut që bie në kundërshtim me këtë rregullore;

f) të paraqesin çështje për hetim penal;

g) të kërkojnë regjistrimet ekzistuese të bisedave telefonike, komunikimet elektronike ose regjistrimet e qarkullimit të të dhënave të ruajtura nga shoqëritë e investimit, institucionet kredituese ose financiare;

h) të kërkojnë regjistrimet ekzistuese të qarkullimit të të dhënave, për aq kohë sa lejohet nga e drejta e brendshme, të cilat ruhen nga operatori i telekomunikacioneve, në rastin kur ka dyshime të arsyeshme për shkelje, dhe në rastin kur këto regjistra kanë rëndësi për hetimin lidhur me shkeljet e germës "a" ose "b" të nenit 14 ose 15;

i) të kërkojnë bllokimin ose sekuestrimin e aktiveve, ose të dyja bashkë;

j) të pezullojnë tregtimin e instrumenteve financiarë përkatës;

k) të kërkojnë ndërprerjen e përkohshme të çdo praktike që autoriteti kompetent e konsideron në kundërshtim me këtë rregullore;

l) të vendosin ndalimin e përkohshëm të ushtrimit të veprimtarisë profesionale; dhe

m) të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar që publiku të informohet saktë, ndër të tjera, duke korrigjuar informacionin e rremë ose çorientues, si dhe duke i kërkuar lëshuesit ose një personi tjetër që ka publikuar ose shpërndarë informacion të rremë ose çorientues që të publikojë një deklaratë korrigjuese.

Nëse, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, nevojitet autorizimi paraprak nga autoriteti gjyqësor i shtetit anëtar përkatës për të hyrë në mjediset e personave fizikë dhe juridikë të përmendur në germën "e" të nënparagrafit të parë, kompetencat e përmendura në këtë germë do të ushtrohen vetëm pas marrjes së këtij autorizimi paraprak.

3. Shtetet anëtare garantojnë caktimin e masave të përshtatshme, në mënyrë që autoritetet kompetente të kenë të gjitha kompetencat mbikëqyrëse dhe hetimore të nevojshme për të kryer detyrat e tyre.

Kjo rregullore nuk cenon ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të miratuara në lidhje me ofertat e marrjes nën kontroll, transaksionet e përqendrimit dhe transaksionet e tjera që ndikojnë në pronësinë ose kontrollin e shoqërive të rregulluara nga autoritetet mbikëqyrëse të caktuara nga shtetet anëtare në përputhje me nenin 4 të Direktivës 2004/25/KE, të cilat përveç kërkesave të kësaj rregulloreje vendosin dhe kërkesa të tjera.

4. Personi që i vë në dispozicion autoritetit kompetent informacion në pajtim me këtë rregullore nuk konsiderohet se shkel ndonjë kufizim për dhënien e informacionit, i vendosur me kontratë ose nga ndonjë dispozitë ligjore, rregulluese ose administrative dhe nuk e ngarkon personin që njofton me asnjë përgjegjësi të çdo lloji që ka të bëjë me një njoftim të tillë.

Neni 24

Bashkëpunimi me ESMA

1. Për qëllime të kësaj rregulloreje, autoritetet kompetente bashkëpunojnë me ESMA-n në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1095/2010.

2. Autoritetet kompetente, pa vonesa, i sigurojnë ESMA-s të gjithë informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të saj, në përputhje me nenin 35 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

3. Për të garantuar kushte uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike zbatuese për të përcaktuar procedurat dhe mënyrat e shkëmbimit të informacionit të përmendur në paragrafin 2.

ESMA i dorëzon Komisionit, jo më vonë se 3 korriku 2016, draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Detyrimi i bashkëpunimit

1. Autoritetet kompetente bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me ESMA, kur është e nevojshme për qëllimet e kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur zbatohet një nga përjashtimet e paragrafit 2. Autoritetet kompetente u ofrojnë ndihmën e tyre autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare dhe ESMA-s. Në veçanti, ato shkëmbejnë informacion pa vonesa të panevojshme dhe bashkëpunojnë në veprimtaritë hetimore, mbikëqyrëse dhe zbatuese.

Detyrimi për të bashkëpunuar dhe asistuar i përcaktuar në nënparagrafin e parë zbatohet edhe për Komisionin në lidhje me shkëmbimin e informacionit që ka të bëjë me mallrat që janë produkte bujqësore të renditura në shtojcën I të TFBE.

Autoritet kompetente dhe ESMA bashkëpunojnë në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1095/2010, dhe në veçanti me nenin 35 të saj.

Nëse shtetet anëtare zgjedhin, në përputhje me nenin 30, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, përcaktimin e sanksioneve penale për shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje të përmendura në këtë nen, ato garantojnë caktimin e masave të përshtatshme, në mënyrë që autoritetet kompetente të kenë të gjitha kompetencat e nevojshme të bashkëpunimit me autoritetet gjyqësore brenda juridiksionit të tyre për marrjen e informacionit specifik në lidhje me hetimet penale ose procedimet e nisura për shkeljet e mundshme të kësaj rregulloreje dhe i sigurojnë po këtë informacion autoriteteve të tjera kompetente dhe ESMA-s, me qëllim përmbushjen e detyrimit të tyre për bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe ESMA-n, për qëllime të kësaj rregulloreje.

2. Autoriteti kompetent mund të refuzojë veprimin sipas kërkesës për dhënie informacioni ose për të bashkëpunuar në një hetim vetëm në rrethanat përjashtimore si më poshtë, përkatësisht kur:

a) komunikimi i informacionit në fjalë mund të ndikojë negativisht në sigurinë e shtetit anëtar të cilit i drejtohet, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit dhe krimeve të tjera të rënda;

b) përmbushja e kërkesës ka të ngjarë të ndikojë negativisht në hetimin e vet, aktivitetet e zbatimit ose, sipas rastit, në një hetim penal;

c) është nisur tashmë një proces gjyqësor të lidhje me të njëjtat veprime dhe kundër të njëjtëve persona përpara autoriteteve të shtetit anëtar të cilit i drejtohet; ose

d) është dhënë një vendim i formës së prerë në lidhje me këta persona për të njëjtat veprime në shtetin anëtar të cilit i drejtohet.

3. Autoritetet kompetente dhe ESMA bashkëpunojnë me Agjencinë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë Elektrike (ACER), e krijuar në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 713/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit²⁷, si dhe me autoritetet rregullatore kombëtare të shteteve anëtare për të garantuar një qasje të koordinuar për zbatimin e rregullave përkatëse, në rastet kur transaksionet, urdhrat për tregtim apo veprimet ose sjelljet e tjera që kanë të bëjnë me një ose më shumë instrumente për të cilat zbatohet kjo rregullore dhe gjithashtu për një ose

më shumë produkte energjetike të tregtuara me shumicë për të cilat zbatohet neni 3, 4 dhe 5 i Rregullores (BE) nr. 1227/2011. Autoritetet kompetente marrin në konsideratë karakteristikat specifike të përkufizimeve të nenit 2 të Rregullores (BE) nr. 1227/2011 dhe dispozitat e nenit 3, 4 dhe 5 të Rregullores (BE) nr. 1227/2011 kur zbatojnë nenet 7, 8 dhe 12 të kësaj rregulloreje për instrumentet financiare që kanë të bëjnë me produktet energjetike të tregtuara me shumicë.

4. Autoritet kompetente japin menjëherë çdo informacion që u kërkohet për qëllimet e përcaktuara në paragrafin 1.

5. Kur një autoritet kompetent është i bindur që ndërmerren, apo janë ndërmarrë veprime në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, brenda territorit të një shteti tjetër anëtar apo që këto veprime po cenojnë instrumentet financiare të tregtuara në vend tregtimi që gjendet në një shtet tjetër anëtar, ai njofton në mënyrë sa më specifike autoritetin kompetent të shtetit tjetër anëtar dhe ESMA-n për këtë fakt, dhe për produktet energjetike të tregtuara me shumicë, njofton ACER. Autoritetet kompetente të shteteve të ndryshme anëtare të përfshira konsultohen me njëri-tjetrin dhe ESMA, dhe për produktet energjetike të tregtuara me shumicë konsultohen me ACER, për të marrë masat e duhura dhe për të informuar njëra-tjetrën për zhvillimet e rëndësishme të përkohshme. Ato i koordinojnë veprimet e tyre, me qëllim që të shmangen dublikimet dhe mbivendosijt e mundshme kur zbatohen sanksionet administrative dhe masat e tjera administrative për rastet ndërkufitare në përputhje me nenet 30 dhe 31 dhe ndihmojnë njëra-tjetrën në zbatimin e vendimeve të tyre.

6. Autoriteti kompetent i një shteti anëtar mund të kërkojë ndihmë nga autoriteti kompetent i një shteti tjetër anëtar në lidhje me inspektimet ose hetimet në terren.

Autoriteti kompetent që kërkon ndihmë mund të informojë ESMA-n për çdo kërkesë të përmendur në nënparagrafin e parë. Në rastin e një hetimi ose një inspektimi me efekt ndërkufitar, ESMA, nëse i kërkohet nga ndonjë prej autoriteteve kompetente, koordinon hetimin ose inspektimin.

Nëse autoriteti kompetent merr një kërkesë nga autoriteti kompetent i një shteti tjetër anëtar për të kryer një inspektim ose hetim në terren, ai mund të veprojë si më poshtë:

a) kryen vetë inspektimin ose hetimin në terren;

b) i mundëson autoritetit kompetent që ka paraqitur kërkesën pjesëmarrjen në inspektimin ose hetimin në terren;

c) i mundëson autoritetit kompetent që ka paraqitur kërkesën të kryejë vetë inspektimin ose hetimin në terren;

d) cakton auditues ose ekspertë për kryerjen e inspektimit ose hetimit në terren;

e) ndan detyrat specifike për veprimtaritë mbikëqyrëse me autoritetet e tjera kompetente.

Autoritetet kompetente gjithashtu mund të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare, në lidhje me rikuperimin e gjobave.

7. Pa cenuar nenin 258 të Traktatit, autoriteti kompetent, kërkesa për informacion ose ndihmë e të cilit, në pajtim me paragrafët 1, 3, 4 dhe 5, nuk shqyrtohet brenda një kohe të arsyeshme apo refuzohet, mund ta sjellë këtë refuzim ose mosveprim në vëmendjen e ESMA-s brenda një periudhe kohore të arsyeshme.

Në situata të tilla, ESMA mund të veprojë në përputhje me nenin 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010, pa cenuar përgjegjësinë e ESMA-së për të vepruar në përputhje me nenin 17 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

8. Autoritetet kompetente bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion me autoritetet rregullatore përkatëse kombëtare dhe të vendeve të treta përgjegjëse për tregjet spot në rastet kur kanë baza të arsyeshme për të dyshuar se po kryhen ose se janë kryer veprime që përbëjnë abuzim me informacionet e privileguara, zbulim të paligjshëm të informacionit ose manipulim tregu në kundërshtim me këtë rregullore. Me anë të këtij bashkëpunimi sigurohet një përmbledhje e konsoliduar e tregjeve financiare dhe të çastit, zbulohen dhe vendosen sanksionet për abuzimet në tregjet e ndryshme dhe ato ndërkufitare.

Në lidhje me kuotat e emetimeve, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit të parashikuar në nënparagrafin e parë sigurohet edhe me:

a) monitoruesin e ankandit, në lidhje me ankandet e kuotave të emetimeve ose produktet e tjera të hedhura në ankand të bazuara në to, të mbajtura në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1031/2010; dhe

b) autoritetet kompetente, administratorët e regjistrave, si dhe Administratorin Qendror dhe organet e tjera publike të ngarkuara me mbikëqyrjen e përputhjes sipas Direktivës 2003/87/KE.

ESMA kryen rol lehtësues dhe koordinues në lidhje me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe autoriteteve rregullatore në shtetet e tjera anëtare dhe vendet e treta. Sipas rastit, autoritetet kompetente lidhin marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet rregullatore të vendeve të treta përgjegjëse për tregjet përkatëse të çastit në përputhje me nenin 26.

9. Për të garantuar kushte uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike zbatuese për të përcaktuar procedurat dhe mënyrat e shkëmbimit të informacionit dhe ndihmës të përmendur në këtë nen.

ESMA i dorëzon Komisionit, jo më vonë se 3 korriku 2016, draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 26

Bashkëpunimi me vendet e treta

1. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare, sipas rastit, lidhin marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta për shkëmbimin e informacionit me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo rregullore në vendet e treta. Këto marrëveshje bashkëpunimi sigurojnë së paku një shkëmbim efikas të informacionit që u mundëson autoriteteve kompetente të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me këtë rregullore.

Autoriteti kompetent informon ESMA dhe autoritetet e tjera kompetente për rastet kur propozon lidhjen e këtyre marrëveshjeve.

2. ESMA, sipas rastit, lehtëson dhe koordinon zhvillimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe autoriteteve mbikëqyrëse përkatëse të vendeve të treta.

Për të siguruar harmonizimin e vazhdueshëm të këtij neni, ESMA duhet të hartojë draft standardet teknike rregullatore që përmbajnë një dokument model për marrëveshjet e bashkëpunimit që duhet të përdoren nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare, kur është e mundur.

ESMA, jo më vonë se 3 korriku 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohen kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore të përmendura në nënparagrafin e dytë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Gjithashtu, ESMA, sipas rastit, lehtëson dhe koordinon shkëmbimin ndërmjet autoriteteve kompetente të informacionit të marrë nga autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta që mund të jetë relevant për marrjen e masave sipas neneve 30 dhe 31.

3. Autoritetet kompetente lidhin marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta vetëm kur informacioni i nxjerrë i nënshtrohet garancive të sekretit profesional, të cilat janë të paktën të barasvlershme me ato të përcaktuara në nenin 27. Shkëmbimi i këtij informacioni kryhet me qëllim të performancës së detyrës së këtyre autoriteteve kompetente.

Neni 27

Sekreti profesional

1. Çdo informacion konfidencial i marrë, i shkëmbyer ose i transmetuar sipas kësaj rregulloreje i nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3.

2. I gjithë informacioni i shkëmbyer mes autoriteteve kompetente sipas kësaj rregulloreje në lidhje me kushtet operationale ose të biznesit dhe çështjet e tjera ekonomike ose personale konsiderohet konfidencial dhe i nënshtrohet kërkesave të sekretit profesional, përveç kur autoriteti kompetent deklaron në momentin e komunikimit të këtij informacioni se ky

informacion mund të jepet ose rastet kur dhënia e këtij informacioni është e nevojshme për procedurat gjyqësore.

3. Detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional zbatohet për të gjithë personat që punojnë ose kanë punuar më parë për autoritetin kompetent apo për çdo autoritet apo ndërmarrje tregtare, të cilës autoriteti kompetent i ka deleguar kompetencat, duke përfshirë audituesit dhe ekspertët e kontraktuar nga autoriteti kompetent. Informacioni i mbuluar nga sekreti profesional nuk mund t'i jepet një personi apo autoriteti tjetër përveçse në përputhje me dispozitat e përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm ose i BE-së.

Neni 28

Mbrojtja e të dhënave

Për sa i përket përpunimit të të dhënave personale në kuadër të kësaj rregulloreje, autoritetet kompetente i kryejnë detyrat e tyre për qëllimet e kësaj rregulloreje në përputhje me ligjet, rregullat ose dispozitat administrative kombëtare që transpozojnë Direktivën 95/46/KE. Në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në kuadër të kësaj rregulloreje, ESMA vepron në përputhje me dispozitat e Rregullores (KE) nr. 45/2001.

Të dhënat personale ruhen për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh.

Neni 29

Dhënia e të dhënave personale ndaj vendeve të treta

1. Autoriteti kompetent i një shteti anëtar mund të transferojë të dhënat personale në një vend të tretë, vetëm rast pas rasti dhe me kusht që të përmbushen kërkesat e Direktivës 95/46/KE. Autoriteti kompetent sigurohet që transferimi të jetë i domosdoshëm për qëllimet e kësaj rregulloreje dhe që vendi i tretë të mos i transferojë të dhënat në një vend tjetër të tretë, përveç nëse i jepet autorizim i shprehur me shkrim dhe nëse diçka e tillë është në përputhje me kushtet e përcaktuara nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar.

2. Autoriteti kompetent i një shteti anëtar i jep autoritetit mbikëqyrës të një vendi të tretë të dhënat personale të marra nga një autoritet kompetent i një tjetër shteti anëtar vetëm kur autoriteti kompetent i shtetit anëtar në fjalë ka marrë shprehimisht pëlqimin e autoritetit kompetent që ka transmetuar të dhënat dhe, sipas rastit, këto të dhëna jepen vetëm për qëllimet që autoriteti kompetent ka dhënë pëlqimin e tij.

3. Kur marrëveshja e bashkëpunimit parashikon shkëmbimin e të dhënave personale, ajo duhet të jetë në përputhje me ligjet, rregullat ose dispozitat administrative kombëtare që transpozojnë Direktivën 95/46/KE.

KREU V

MASAT DHE SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 30

Sanksionet administrative dhe masat e tjera administrative

1. Pa cenuar sanksionet penale dhe kompetencat mbikëqyrëse të autoriteteve kompetente në përputhje me nenin 23, shtetet anëtare, në përputhje me legjislacionin e brendshëm parashikojnë që autoritetet kompetente të kenë kompetenca për të marrë dhe vendosur sanksione dhe masa të tjera administrative të përshtatshme, të paktën për shkeljet e mëposhtme:

a) shkeljen e nenit 14 dhe 15, nenit 16, paragrafi 1 dhe 2, nenit 17, paragrafi 1, 2, 4, 5, dhe 8, nenit 18, paragrafi 1 deri në 6, nenit 19, paragrafi 1, 2, 3, 5, 6, 7 dhe 11 dhe nenit 20, paragrafi 1; dhe

b) mungesën e bashkëpunimit ose mospërputhjen, në lidhje me hetimin, inspektimin ose me kërkesën e përmendur në nenin 23, paragrafi 2.

Shtetet anëtare mund të vendosin parashikimin e rregullave për sanksionet administrative që përmenden në nënparagrafin e parë, kur shkeljet e përmendura në germën "a" ose "b" të këtij nënparagrafi tashmë u nënshtrohen sanksioneve penale të parashikuara në legjislacionin e tyre të brendshëm deri më 3 korrik 2016. Kur marrin këtë vendim, shtetet anëtare informojnë Komisionin dhe ESMA-n me detaje për pjesët përkatëse të legjislacionit të tyre penal.

Deri më 3 korrik 2016, shtetet anëtare i njoftojnë me detaje Komisionit dhe ESMA-s rregullat e përmendura në nënparagrafin e parë dhe të dytë. Ato i njoftojnë menjëherë Komisionit dhe ESMA-s çdo ndryshim të mëtejshëm të tyre.

2. Shtetet anëtare, në përputhje me legjislacionin kombëtar, sigurohen që autoritetet kompetente të kenë të drejtën të vendosin të paktën sanksionet administrative në vijim dhe të marrin të paktën masat e mëposhtme administrative në rastet e shkeljeve të përmendura në germën "a" të nënparagrafit të parë të paragrafit 1:

a) urdhrin që kërkon pushimin e sjelljes së personit përgjegjës për shkeljen dhe mospërsëritjen e kësaj sjelljeje;

b) garantimin e të ardhurave të fituara ose humbjeve të shmangura për shkak të shkeljes, për aq kohë sa mund të përcaktohen;

c) një paralajmërim publik, i cili tregon personin përgjegjës për shkeljen dhe natyrën e shkeljes;

d) tërheqjen ose pezullimin e autorizimit të një shoqërie investimi;

e) një përjashtim të përkohshëm nga ushtrimi i funksioneve drejtuese në një shoqëri investimi i çdo personi me përgjegjësi drejtuese në një shoqëri investimi ose i çdo personi tjetër fizik, i cili është përgjegjës për shkeljet;

f) në rastin e shkeljeve të përsëritura të nenit 14 ose 15, një përjashtim të përhershëm nga ushtrimi i funksioneve drejtuese në një shoqëri investimi i çdo personi me përgjegjësi drejtuese në një shoqëri investimi ose i çdo personi tjetër fizik, i cili është përgjegjës për shkeljet;

g) një përjashtim të përkohshëm nga ushtrimi për llogari të vet, në një shoqëri investimi, të çdo personi me përgjegjësi drejtuese në një shoqëri investimi ose i çdo personi tjetër fizik, i cili është përgjegjës për shkeljet;

h) sanksionet administrative në formë gjobe maksimale me vlerë monetare të paktën deri në trefishin e shumës së fitimeve të marra ose humbjeve të shmangura për shkak të shkeljes, kur këto mund të përcaktohen;

i) në rastin e personave fizikë, sanksionet administrative në formë gjobe maksimale prej të paktën:

I. 5 000 000 euro për shkeljet e nenit 14 dhe 15, ose në shtetet anëtare me monedha të ndryshme nga euro, vlerën korresponduese në monedhën kombëtare më 2 korrik 2014;

II. 1 000 000 euro për shkeljet e nenit 16 dhe 17, ose në shtetet anëtare me monedha të ndryshme nga euro, vlerën korresponduese në monedhën kombëtare më 2 korrik 2014; dhe

III. 500 000 euro për shkeljet e nenit 18, 19 dhe 20, ose në shtetet anëtare me monedha të ndryshme nga euro, vlerën korresponduese në monedhën kombëtare më 2 korrik 2014; dhe

j) në rastin e personave juridikë, sanksionet administrative në formë gjobe maksimale prej të paktën:

I. 15 000 000 euro ose 15 % të totalit të xhiros vjetore të personit juridik, sipas llogarive financiare të disponueshme më së fundmi, të miratuara nga organi drejtues ose, në shtetet anëtare me monedha të ndryshme nga euro, vlerën korresponduese në monedhën kombëtare më 2 korrik 2014, për shkeljet e nenit 14 dhe 15.

II. 2 500 000 euro ose 2 % të totalit të xhiros vjetore të tij, sipas llogarive financiare të disponueshme më së fundmi, të miratuara nga organi drejtues ose, në shtetet anëtare me monedha të ndryshme nga euro, vlerën korresponduese në monedhën kombëtare më 2 korrik 2014, për shkeljet e nenit 16 dhe 17; dhe

III. 1 000 000 euro për shkeljet e nenit 18, 19 dhe 20, ose në shtetet anëtare me monedha të ndryshme nga euro, vlerën korresponduese në monedhën kombëtare më 2 korrik 2014.

Referencat në këtë paragraf për autoritetin kompetent nuk cenojnë aftësinë e autoritetit kompetent për të ushtruar funksionet e tij në një nga mënyrat e përmendura në nenin 23, paragrafi 1.

Për qëllime të germave "j", pika I dhe II e nënparagrafit të parë, në rastin kur personi juridik është shoqëri mëmë ose filial i shoqërisë mëmë, i cili duhet të përgatisë pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me Direktivën 2013/34/BE²⁸, totali përkatës i xhiros vjetore është xhiroja vjetore ose lloji i të ardhurave korresponduese, në përputhje me direktivat përkatëse për kontabilitetin, Direktiva e Këshillit 86/635/KEE²⁹ për bankat dhe Direktiva e Këshillit 91/674/KEE³⁰ për shoqëritë e sigurimit, sipas pasqyrave të konsoliduara të disponuara më së fundmi, që miratohen nga organi drejtues i shoqërisë mëmë që është në krye.

3. Shtetet anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kompetente të kenë kompetenca të tjera përveç atyre të përmendura në paragrafin 2 dhe mund të parashikojnë sanksione më të larta se ato të përcaktuara në këtë paragraf.

Neni 31

Ushtrimi i kompetencave mbikëqyrëse dhe vendosja e sanksioneve

1. Shtetet anëtare sigurojnë që, gjatë përcaktimit të llojit dhe nivelit të sanksioneve administrative, autoritetet kompetente të marrin parasysh të gjitha rrethanat përkatëse dhe, në rast se janë të zbatueshme, duke përfshirë edhe:

- a) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes;
- b) shkallën e përgjegjësisë së personit përgjegjës për shkeljen;
- c) stabilitetin financiar të personit përgjegjës për shkeljen, siç tregohet, për shembull, nga xhiroja vjetore totale e personit juridik ose të ardhurat vjetore të një personi fizik;
- d) rëndësinë e fitimeve të marra ose humbjeve të shmangura nga personi përgjegjës për shkeljen, deri në masën që ato mund të përcaktohen;
- e) nivelin e bashkëpunimit me autoritetin kompetent, të personit përgjegjës për shkeljen, pa cenuar nevojën për garantimin e të ardhurave të fituara ose humbjeve të shmangura nga ky person;
- f) shkeljet e mëparshme të kryera nga personi përgjegjës i shkeljes; dhe
- g) masat e marra nga personi përgjegjës i shkeljes për të parandaluar përsëritjen e saj.

2. Gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre për vendosjen e sanksioneve dhe masave të tjera administrative në përputhje me nenin 30, autoritetet kompetente bashkëpunojnë ngushtë në mënyrë që të sigurohen se ushtrimi i kompetencave të tyre mbikëqyrëse dhe hetimore, sanksionet administrative që vendosin dhe masat e tjera administrative që marrin, janë efektive dhe të përshtatshme sipas kësaj rregulloreje. Ato i koordinojnë veprimet e tyre në përputhje me nenin 25, me qëllim që të shmangen dublikimet dhe mbivendosjet gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre mbikëqyrëse dhe hetimore dhe gjatë vendosjes së sanksioneve administrative për rastet ndërkufitare.

Neni 32

Raportimi i shkeljeve

1. Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet kompetente të vendosin mekanizma efektive për të mundësuar raportimin tek autoritetet kompetente të shkeljeve të mundshme ose aktuale të kësaj rregulloreje.

2. Mekanizmat e përmendur në paragrafin 1 përfshijnë të paktën:

a) procedurat specifike për marrjen e raporteve në lidhje me shkeljet dhe ndjekjen e tyre, duke përfshirë vendosjen e kanaleve të sigurta të komunikimit për këto raporte;

b) brenda punësimit të tyre, mbrojtjen e përshtatshme të personave që punojnë sipas një kontrate pune, të cilët raportojnë shkelje ose janë akuzuar për shkelje, minimalisht kundër hakmarrjes, diskriminimit ose llojeve të tjera të trajtimit të padrejtë; dhe

c) mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me personin që raporton shkeljet dhe personin fizik që pretendohet se ka kryer shkeljen, duke përfshirë mbrojtjen në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të identitetit të tyre, në të gjitha fazat e procedurës, pa cenuar zbulimin e informacionit që kërkohet nga legjislacionit në kontekstin e hetimeve të mëtejshme ose procedurave gjyqësore vijuese.

3. Shtetet anëtare kërkojnë punonjës të cilët kryejnë veprimtari që rregullohen nga rregulloret e shërbimeve financiare për të pasur procedura të brendshme të përshtatshme që punonjësit e tyre të raportojnë shkeljet e kësaj rregulloreje.

4. Shtetet anëtare mund të parashikojnë stimuj financiarë për personat që ofrojnë informata me rëndësi rreth shkeljeve të mundshme të kësaj rregulloreje, në përputhje me të drejtën e brendshme, kur personat e tillë nuk kanë detyrime të tjera ligjore apo kontraktuale të mëparshme për të raportuar informata të tilla dhe me kusht që informacioni të jetë i ri dhe që të rezultojë me vendosjen e një sanksioni administrativ ose penal ose marrjen e një mase tjetër administrative për shkeljen e kësaj rregulloreje.

5. Komisioni miraton akte zbatuese për të specifikuar procedurat e referuara në paragrafin 1, duke përfshirë masat për raportimin dhe raportet pasuese, si dhe masat për mbrojtjen e personave që punojnë me një kontratë pune dhe masat për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 36, paragrafi 2.

Neni 33

Shkëmbimi i informacionit me ESMA

1. Autoritetet kompetente i sigurojnë ESMA-s, një herë në vit, informacionin e agreguar në lidhje me çdo sanksion administrativ dhe masë tjetër të caktuar nga autoriteti kompetent në përputhje me nenet 30, 31 dhe 32. ESMA boton informacionin në raportin vjetor. Autoritetet kompetente i sigurojnë ESMA-s, një herë në vit, të dhënat anonime dhe të agreguara, në lidhje me hetimet administrative të ndërmarra në përputhje me këto nene.

2. Nëse shtetet anëtare, në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 30, paragrafi 1, parashikojnë sanksione penale për shkeljet e përmendura në këtë nen, autoritetet e tyre kompetente i sigurojnë ESMA-s çdo vit të dhëna anonime dhe të agreguara, në lidhje me të gjitha hetimet penale të ndërmarra dhe dënimet penale të caktuara nga autoritetet gjyqësore në përputhje me nenet 30, 31 dhe 32. ESMA boton të dhënat në lidhje me sanksionet penale të vendosura në raportin vjetor.

3. Nëse autoriteti kompetent nxjerr sanksionet administrative ose penale ose masat e tjera administrative për publikun, ai njoftojnë njëkohësisht edhe ESMA-n.

4. Në rastet kur sanksioni i botuar penal ose administrativ ka të bëjë me shoqërinë e investimit të autorizuar në përputhje me Direktivën 2014/65/BE, ESMA shton një referencë në këtë sanksion ose masë të botuar në regjistrin e shoqërive të investimit të krijuara sipas nenit 5, paragrafi 3 të kësaj direktive.

5. Për të garantuar kushte uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike zbatuese për të përcaktuar procedurat dhe mënyrat e shkëmbimit të informacionit të përmendur në këtë nen.

ESMA i dorëzon Komisionit, jo më vonë se 3 korriku 2016, draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 34

Botimi i vendimeve

1. Në përputhje me nënparagrafin e tretë, autoritetet kompetente botojnë në faqen e tyre të internetit çdo vendim që cakton një sanksion administrativ ose masë tjetër administrative për një shkelje të kësaj rregulloreje menjëherë pasi të jetë informuar për vendimin personi që është objekt i tij. Ky botim përfshin të paktën informacionin në lidhje me llojin dhe natyrën e shkeljes, dhe identitetin e personit që është objekt i vendimit.

Nënparagrafi i parë nuk zbatohet për masat e caktimit të vendimeve, që kanë natyrë hetimore.

Nëse autoriteti kompetent konsideron si joproporcionale bërjen publike të identitetit të personit juridik që është objekt i vendimit ose të të dhënave personale të personit fizik, pas një vlerësimi rast pas rasti, të kryer në lidhje me proporcionalitetin e publikimit të këtyre të dhënave, ose në rastin kur publikimi rrezikon vazhdimësinë e hetimit ose stabilitetin e tregjeve financiare, ai vepron si më poshtë:

a) shtyn publikimin e vendimit deri në momentin kur arsyet e mospublikimit të tij pushojnë së ekzistuari;

b) publikon vendimin në baza anonime dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm, nëse ky publikim anonim garanton mbrojtjen efikase të të dhënave personale përkatëse;

c) nuk publikon vendimin në rast se autoriteti kompetent është i mendimit se publikimi në përputhje me germën "a" ose "b)" nuk do të mund të sigurojë:

I. mosvënien në rrezik të stabilitetit të tregjeve financiare; ose

II. proporcionalitetin e publikimit të këtyre vendimeve, në lidhje me masat, që konsiderohen të papërfillshme.

Nëse autoriteti kompetent vendos të publikojë vendimin në baza anonime, siç përmendet në germën "b" të nënparagrafit të tretë, ai mund të shtyjë publikimin e të dhënave përkatëse për një periudhë të arsyeshme kohore, nëse parashikohet se arsyet për publikimin anonim do të pushojnë së ekzistuari gjatë kësaj periudhe.

2. Nëse vendimi i nënshtrohet apelimit përpara autoriteteve përkatëse gjyqësore ose të tjera, autoritetet kompetente gjithashtu publikojnë menjëherë këtë informacion në faqen e tyre të internetit, si dhe çdo informacion të mëtejshëm që lidhet me rezultatin e këtij apelimi. Përveç kësaj, çdo vendim që anulon vendimin që i nënshtrohet apelimit duhet të publikohet.

3. Autoritetet kompetente garantojnë që publikimet e çdo vendimi në përputhje me këtë nen, të mbeten të aksesueshme në faqen e tyre të internetit për një periudhë minimalisht pesë vjeçare pas momentit të publikimit. Të dhënat personale të përfshira në këto publikime ruhen vetëm në faqen e internetit të autoritetit kompetent, për periudhën kohore të nevojshme në përputhje me rregullat e mbrojtjes së zbatimit të të dhënave.

KREU VI

AKTE TË DELEGUARA DHE ZBATUESE

Neni 35

Ushtrimi i delegimit

1. Kompetencat për të miratuar aktet e deleguara i delegohen Komisionit sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.

2. Kompetenca për të miratuar aktet e deleguara, të përmendura në nenin 6 paragrafi 5 dhe 6, nenin 12 paragrafi 5, nënparagrafi i tretë i nenit 17, paragrafi 2, nenin 17 paragrafi 3 dhe neni 19, paragrafi 13 dhe 14, i jepet Komisionit për një periudhë kohore të papërcaktuar, që nis më 2 korrik 2014.

3. Delegimi i kompetencave, i përmendur në nenin 6, paragrafi 5 dhe 6, nenin 12, paragrafi 5, nënparagrafi i tretë i nenit 17, paragrafi 2, nenin 17 paragrafi 3 dhe neni 19, paragrafi 13 dhe 14 mund të revokohen në çdo kohë nga Parlamenti Evropian ose nga Këshilli. Vendimi i revokimit i jep fund delegimit të kompetencave të specifikuar në atë vendim. Ai hyn në fuqi një ditë pas botimit të vendimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian ose në një datë të mëvonshme të specifikuar në të. Ai nuk cenon vlefshmërinë e ndonjë akti të deleguar të hyrë tashmë në fuqi.

4. Pasi miraton një akt të deleguar, Komisioni njofton për këtë njëkohësisht Parlamentin Evropian dhe Këshillin.

5. Një akt i deleguar, i miratuar sipas nenit 6 paragrafi 5 dhe 6, nenit 12, paragrafi 5, nënparagrafi i tretë i nenit 17, paragrafi 2, nenit 17, paragrafi 3, ose nenit 19, paragrafët 13 ose

14, hyjnë në fuqi vetëm nëse nuk është shprehur asnjë kundërshtim as nga Parlamenti Evropian as nga Këshilli, brenda një periudhe tremujore pasi Parlamenti Evropian ose Këshilli është njoftuar për këtë akt, ose nëse, përpara përfundimit të kësaj periudhe, Parlamenti Evropian dhe Këshilli kanë informuar Komisionin se nuk do të kundërshtojnë. Kjo periudhë shtyhet me dy muaj me nismën e Parlamentit Evropian ose të Këshillit.

Neni 36

Procedura e Komitetit

1. Komisioni asistohet nga Komiteti Evropian i Titujve, i themeluar me Vendimin e Komisionit 2001/528/KE³¹. Ky Komitet është një komitet sipas kuptimit të Rregullores (BE) nr. 182/2011.

2. Aty ku përmendet ky paragraf, gjen zbatim neni 5 i Rregullores (BE) nr. 182/2011.

KREU VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 37

Shfuqizimi i Direktivës 2003/6/KE dhe i masave të saj zbatuese

Direktiva 2003/6/KE dhe Direktivat e Komisionit 2004/72/KE³², 2003/125/KE³³ dhe 2003/124/KE³⁴ dhe Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 2273/2003³⁵ shfuqizohen duke filluar nga data 3 korrik 2016. Referencat për Direktivën 2003/6/KE konsiderohen si referenca për këtë rregullore dhe lexohen në përputhje me tabelën e përputhshmërisë të paraqitur në shtojcën IV të kësaj rregulloreje.

Neni 38

Raportimi

Komisioni, deri më 3 korrik 2019, i paraqet një raport Parlamentit Evropian dhe Këshillit për zbatimin e kësaj rregulloreje, së bashku me një propozim legjislativ nëse është e përshtatshme. Ai raport vlerëson, ndër të tjera:

a) përshtatshmërinë e futjes së rregullave të përbashkëta mbi nevojën që të gjitha shtetet anëtare të parashikojnë sanksione administrative për abuzimin me informacionin e privilegjuar dhe manipulimin e tregut;

b) nëse përkufizimi i informacionit të brendshëm është i mjaftueshëm për të përfshirë të gjitha informacionet me rëndësi për autoritetet kompetente që të luftojnë në mënyrë efektive kundër abuzimit në treg;

c) përshtatshmërinë e kushteve sipas të cilave është i detyruar ndalimi për tregtim në përputhje me nenin 19, paragrafi 11 me qëllim identifikimin e rrethanave të tjera në të cilat duhet të zbatohet ndalimi;

d) mundësia e krijimit të një kuadri të Bashkimit Evropian për mbikëqyrjen e librit ndërtregtar të urdhrave në lidhje me abuzimin në treg, duke përfshirë rekomandimet për një kuadër të tillë; dhe

e) fushëveprimin e zbatimit të dispozitave të pikave të referencës.

Për qëllimet e germës "a" të nënparagrafit të parë, ESMA duhet të ndërmarrë një ushtrim hartëzimi të zbatimit të sanksioneve administrative dhe, kur shtetet anëtare kanë vendosur, në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 30, paragrafi 1, të përcaktojnë sanksione penale siç përmendet aty, për shkelje të kësaj rregulloreje, të zbatimit të sanksioneve të tilla penale brenda shteteve anëtare. Ai ushtrim përfshin gjithashtu të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion sipas nenit 33, paragrafët 1 dhe 2.

Neni 39

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi njëzetë ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

2. Ai zbatohet nga 3 korriku 2016, përveç nenit 4, paragrafët 4 dhe 5, nenit 5, paragrafi 6, nenit 6, paragrafët 5 dhe 6, nenit 7, paragrafi 5, nenit 11, paragrafët 9, 10 dhe 11, nenit 12, paragrafi 5, nenit 13, paragrafët 7 dhe 11, nenit 16, paragrafi 5, nënparagrafit të tretë të nenit 17, paragrafi 2, nenit 17, paragrafët 3, 10 dhe 11, nenit 18, paragrafi 9, nenit 19, paragrafët 13, 14 dhe 15, nenit 20, paragrafi 3, nenit 24, paragrafi 3, nenit 25, paragrafi 9, nënparagrafët e dytë, të tretë dhe të katërt të nenit 26, paragrafi 2, nenit 32, paragrafi 5 dhe nenit 33, paragrafi 5, të cilët zbatohen më 2 korrik 2014.

3. Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të përmbushur nenet 22, 23 dhe 30, nenin 31, paragrafi 1 dhe nenet 32 dhe 34 deri më 3 korrik 2016.

4. Referencat në këtë rregullore të Direktivës 2014/65/BE dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014, para 3 janarit 2017 duhet të lexohen si referenca në Direktivën 2004/39/KE në përputhje me tabelën e korrelacionit të përcaktuar në shtojcën IV të Direktivës 2014/65/BE, për sa kohë që kjo tabelë korrelacioni përmban dispozita që i referohen Direktivës 2004/39/KE.

Kur në dispozitat e kësaj Rregulloreje referohen OTF-të, tregjeve të rritjes së SME-ve, kuotave të emetimeve ose produkteve të ankanduara në bazë të tyre, këto dispozita nuk zbatohen për OTF-të, tregjet e rritjes së SME-ve, kuotave për emetimet ose produktet e ankanduara në bazë të tyre deri më 3 janar 2017.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha shtetet anëtare.

Nënshkruar në Strasburg, më 16 prill 2014.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

M. SCHULZ

Për Këshillin

Presidenti

D. KOURKOULAS

SHTOJCA I

A. Treguesit e sjelljes manipuluese që lidhen me sinjalet false ose çorientuese dhe me sigurimin e çmimeve

Për qëllime të zbatimit të germës "a" të nenit 12, paragrafi 1 i kësaj rregulloreje dhe pa cenuar format e sjelljes të përcaktuara në paragrafin 2 të atij neni, treguesit e mëposhtëm jo-shterues, të cilët nuk do të konsiderohen domosdoshmërisht, në vetvete, si manipulim i tregut, duhet të merren parasysh kur transaksionet ose urdhrat për tregti kontrollohen nga pjesëmarrësit e tregut dhe autoritetet kompetente:

a) shkalla në të cilën janë dhënë urdhrat e tregtimit ose janë ndërmarrë transaksione, përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të vëllimit të përditshëm të transaksioneve në instrumentin përkatës financiar, kontratën spot të mallrave të lidhura me to, ose produktin e ankandit bazuar në kuotat e emetimeve, veçanërisht kur ato aktivitete çojnë në një ndryshim të rëndësishëm në çmimet e tyre;

b) shkalla në të cilën janë dhënë urdhrat e tregtimit ose janë ndërmarrë transaksione nga personat me pozitë të konsiderueshme blerëse ose shitëse në një instrument financiar, një kontratë spot të mallrave të lidhur me to, ose një produkt i ankanduar bazuar në kuotat e emetimit, çojnë në ndryshime të rëndësishme në çmimin e atij instrumenti, në kontratën spot të mallrave të lidhur me to, ose produktin e ankanduar në bazë të kuotave të emetimit;

c) nëse transaksionet e ndërmarra nuk ndryshojnë pronësinë përfituese të një instrumenti financiar, një kontratë spot e mallrave të lidhur me to, ose një produkt të ankanduar në bazë të kuotave të emetimit;

d) shkalla në të cilën janë dhënë urdhrat e tregtimit ose janë ndërmarrë transaksione ose janë anuluar urdhra, përfshijnë kthimet e pozicionit në një periudhë të shkurtër dhe përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të vëllimit ditor të transaksioneve në instrumentin përkatës financiar, një kontratë spot të mallrave të lidhur me to ose një produkt i ankanduar në bazë të kuotave të emetimit, dhe mund të shoqërohet me ndryshime të rëndësishme në çmimin e një

instrumenti financiar, një kontratë spot të mallrave të lidhur me to ose një produkti të ankanduar në bazë në kuotat e emetimit;

e) shkalla në të cilën janë dhënë urdhrat e tregimit ose janë ndërmarrë transaksione janë përqendruar brenda një afati të shkurtër kohor në seancën tregtare dhe çojnë në një ndryshim të çmimit i cili më pas përmbysset;

f) shkalla në të cilën janë dhënë urdhrat e tregimit ndryshojnë përfaqësimin e ofertës më të mirë ose çmimeve të ofertës në një instrument financiar, një kontratë spot të mallrave të lidhur me to ose një produkt i ankanduar në bazë të kuotave të emetimit ose në përgjithësi përfaqësimi i librit të urdhrave në dispozicion të pjesëmarrësve në treg dhe hiqen para se të ekzekutohen; dhe

g) shkalla në të cilën janë dhënë urdhrat e tregimit ose janë ndërmarrë transaksione në ose rreth një kohe të caktuar kur çmimet e referencës, çmimet e shlyerjes dhe vlerësimet llogariten dhe çojnë në ndryshime të çmimeve të cilat kanë ndikim në çmime dhe vlerësime të tilla.

B. Treguesit e sjelljes manipuluese që lidhen me punësimin e një pajisjeje fiktive ose ndonjë forme tjetër të mashtrimit ose të sajimit

Për qëllime të zbatimit të germës "b" të nenit 12, paragrafi 1 i kësaj rregulloreje dhe pa cenuar format e sjelljes të përcaktuara në paragrafin 2 të atij neni, treguesit e mëposhtëm joshtrues, të cilët nuk do të konsiderohen domosdoshmërisht, në vetvete, si manipulim i tregut, duhet të merren parasysh kur transaksionet ose urdhrat për tregti kontrollohen nga pjesëmarrësit e tregut dhe autoritetet kompetente:

a) nëse urdhrat e dhënë për tregtim ose transaksionet e ndërmarrë nga personat paraprihen ose pasohen nga shpërndarja e informacionit të rremë ose çorientues nga të njëjtët persona ose nga persona të lidhur me to; dhe

b) nëse urdhrat e dhënë për tregtim ose transaksionet e ndërmarrë nga persona para ose pasi të njëjtët persona ose persona të lidhur me ta prodhojnë ose shpërndajnë rekomandime investimi të cilat janë të gabuara, të njëanshme ose të ndikuara dukshëm nga interesi material.

SHTOJCA II

TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Kjo Rregullore	Direktiva 2003/6/KE
Neni 1	
Neni 2	
Neni 2, paragrafi 1, germa "a"	Neni 9, paragrafi i parë

Neni 2, paragrafi 1, germa "b"	
Neni 2, paragrafi 1, germa "c"	
Neni 2, paragrafi 1, germa "d"	Neni 9, paragrafi i dytë
Neni 2, paragrafi 3	Neni 9, paragrafi i parë
Neni 2, paragrafi 4	Neni 10 germa, "a"
Pika 1 e nenit 3, paragrafi 1	Neni 1, paragrafi 3
Pika 2 e nenit 3, paragrafi 1	
Pika 3 e nenit 3, paragrafi 1	
Pika 4 e nenit 3, paragrafi 1	
Pika 5 e nenit 3, paragrafi 1	
Pika 6 e nenit 3, paragrafi 1	Neni 1, paragrafi 4
Pika 7 e nenit 3, paragrafi 1	
Pika 8 e nenit 3, paragrafi 1	
Pika 9 e nenit 3, paragrafi 1	Neni 1, paragrafi 5
Pika 10 e nenit 3, paragrafi 1	
Pika 11 e nenit 3, paragrafi 1	
Pika 12 e nenit 3, paragrafi 1	Neni 1, paragrafi 7
Pika 13 e nenit 3, paragrafi 1	Neni 1, paragrafi 6
Pikat 14 deri 35 të nenit 3, paragrafi 1	
Neni 4	
Neni 5	Neni 8

Neni 6, paragrafi 1	Neni 7
Neni 6, paragrafi 2	
Neni 6, paragrafi 3	
Neni 6, paragrafi 4	
Neni 6, paragrafi 5	
Neni 6, paragrafi 6	
Neni 6, paragrafi 7	
Neni 7, paragrafi 1, germa "a"	Neni 1, pika 1, paragrafi i parë
Neni 7, paragrafi 1, germa "b"	Neni 1, pika 1, paragrafi i dytë
Neni 7, paragrafi 1, germa "c"	
Neni 7, paragrafi 1, germa "d"	Neni 1, pika 1, paragrafi i tretë
Neni 7, paragrafi 2	
Neni 7, paragrafi 3	
Neni 7, paragrafi 4	
Neni 7, paragrafi 5	
Neni 8, paragrafi 1	Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi i parë
Neni 8, paragrafi 2	
Neni 8, paragrafi 2, germa "a"	Neni 3, germa "b"
Neni 8, paragrafi 2, germa "b"	
Neni 8, paragrafi 3	

Neni 8, paragrafi 4, germa "a"	Neni 2, paragrafi 1, germa "a"
Neni 8, paragrafi 4, germa "b"	Neni 2, paragrafi 1, germa "b"
Neni 8, paragrafi 4, germa "c"	Neni 2, paragrafi 1, germa "c"
Neni 8, paragrafi 4, germa "d"	Neni 2, paragrafi 1, germa "d"
Neni 8, paragrafi 4, nënparagrafi i dytë	Neni 4
Neni 8, paragrafi 5	Neni 2, paragrafi 2
Neni 9, paragrafi 1	
Neni 9, paragrafi 2	
Neni 9, paragrafi 3, germa "a"	Neni 2, paragrafi 3
Neni 9, paragrafi 3, germa "b"	Neni 2, paragrafi 3
Neni 9, paragrafi 4	
Neni 9, paragrafi 5	
Neni 9, paragrafi 6	
Neni 10, paragrafi 1	Neni 3, germa "a"
Neni 10, paragrafi 2	
Neni 11	
Neni 12, paragrafi 1	
Neni 12, paragrafi 1, germa "a"	Neni 1, paragrafi 2, germa "a"
Neni 12, paragrafi 1, germa "b"	Neni 1, paragrafi 2, germa "b"

Neni 12, paragrafi 1, germa "c"	Neni 1, paragrafi 2, germa "c"
Neni 12, paragrafi 1, germa "d"	
Neni 12, paragrafi 2, germa "a"	Neni 1, paragrafi 2, ndarja e parë e paragrafit të dytë
Neni 12, paragrafi 2, germa "b"	Neni 1, paragrafi 2, ndarja e dytë e paragrafit të dytë
Neni 12, paragrafi 2, germa "c"	
Neni 12, paragrafi 2, germa "d"	Neni 1, paragrafi 2, ndarja e tretë e paragrafit të dytë
Neni 12, paragrafi 2, germa "e"	
Neni 12, paragrafi 3	
Neni 12, paragrafi 4	
Neni 12, paragrafi 5	Neni 1, pika 2, paragrafi i tretë
Neni 13, paragrafi 1	Neni 1, pika 2, germa "a", paragrafi i dytë
Neni 13, paragrafi 1	
Neni 13, paragrafi 2	
Neni 13, paragrafi 3	
Neni 13, paragrafi 4	
Neni 13, paragrafi 5	
Neni 13, paragrafi 6	
Neni 13, paragrafi 7	
Neni 13, paragrafi 8	
Neni 13, paragrafi 9	

Neni 13, paragrafi 10	
Neni 13, paragrafi 11	
Neni 14, germa "a"	Neni 2, pika 1, paragrafi i parë
Neni 14, germa "b"	Neni 3, germa "b"
Neni 14, germa "c"	Neni 3, germa "a"
Neni 15	Neni 5
Neni 16, paragrafi 1	Neni 6, paragrafi 6
Neni 16, paragrafi 2	Neni 6, paragrafi 9
Neni 16, paragrafi 3	
Neni 16, paragrafi 4	
Neni 16, paragrafi 5	Neni 6 paragrafi 10, ndarja e shtatë
Neni 17, paragrafi 1	Neni 6, paragrafi 1
Neni 17, paragrafi 1, nënparagrafi i tretë	Neni 9, paragrafi i tretë
Neni 17, paragrafi 2	
Neni 17, paragrafi 3	
Neni 17, paragrafi 4	Neni 6, paragrafi 2
Neni 17, paragrafi 5	
Neni 17, paragrafi 6	
Neni 17, paragrafi 7	
Neni 17, paragrafi 8	Neni 6, paragrafi 3, nënparagrafi i parë dhe i dytë
Neni 17, paragrafi 9	
Neni 17, paragrafi 10	Neni 6, paragrafi 10, ndarja e parë dhe e dytë
Neni 17, paragrafi 11	

Neni 18, paragrafi 1	Neni 6, paragrafi 3, nënparagrafi i tretë
Neni 18, paragrafi 2	
Neni 18, paragrafi 3	
Neni 18, paragrafi 4	
Neni 18, paragrafi 5	
Neni 18, paragrafi 6	
Neni 18, paragrafi 7	Neni 9, paragrafi i tretë
Neni 18, paragrafi 8	
Neni 18, paragrafi 9	Neni 6, paragrafi 10, ndarja e katërt
Neni 19, paragrafi 1	Neni 6, paragrafi 4
Neni 19, paragrafi 1, germa "a"	Neni 6, paragrafi 4
Neni 19, paragrafi 1, germa "b"	
Neni 19, paragrafi 2	
Neni 19, paragrafi 3	
Neni 19, paragrafi 4, germa "a"	
Neni 19, paragrafi 4, germa "b"	
Neni 19, paragrafët 5 deri në 13	
Neni 19, paragrafi 14	Neni 6, paragrafi 10, ndarja e pestë
Neni 19, paragrafi 15	Neni 6, paragrafi 10, ndarja e pestë
Neni 20, paragrafi 1	Neni 6, paragrafi 5
Neni 20, paragrafi 2	Neni 6, paragrafi 8

Neni 20, paragrafi 3	Neni 6 paragrafi 10, ndarja e gjashtë dhe neni 6, paragrafi 11
Neni 21	Neni 1, paragrafi 2, germa "c", fjalia e dytë
Neni 22	Neni 11, paragrafi i parë dhe neni 10
Neni 23, paragrafi 1	Neni 12, paragrafi 1
Neni 23, paragrafi 1, germa "a"	Neni 12, paragrafi 1, germa "a"
Neni 23, paragrafi 1, germa "b"	Neni 12, paragrafi 1, germa "b"
Neni 23, paragrafi 1, germa "c"	Neni 12, paragrafi 1, germa "c"
Neni 23, paragrafi 1, germa "d"	Neni 12, paragrafi 1, germa "d"
Neni 23, paragrafi 2, germa "a"	Neni 12, paragrafi 2, germa "a"
Neni 23, paragrafi 2, germa "b"	Neni 12, paragrafi 2, germa "b"
Neni 23, paragrafi 2, germa "c"	
Neni 23, paragrafi 2, germa "d"	Neni 12, paragrafi 2, germa "c"
Neni 23, paragrafi 2, germa "e"	
Neni 23, paragrafi 2, germa "f"	
Neni 23, paragrafi 2, germa "g"	Neni 12, paragrafi 2, germa "d"
Neni 23, paragrafi 2, germa "h"	Neni 12, paragrafi 2, germa "d"
Neni 23, paragrafi 2, germa "i"	Neni 12, paragrafi 2, germa "g"

Neni 23, paragrafi 2, germa "j"	Neni 12, paragrafi 2, germa "f"
Neni 23, paragrafi 2, germa "k"	Neni 12, paragrafi 2, germa "e"
Neni 23, paragrafi 2, germa "l"	Neni 12, paragrafi 2, germa "h"
Neni 23, paragrafi 2, germa "m"	Neni 6, paragrafi 7
Neni 23, paragrafi 3	
Neni 23, paragrafi 4	
Neni 24, paragrafi 1	Neni 15a, paragrafi 1
Neni 24, paragrafi 2	Neni 15a, paragrafi 2
Neni 24, paragrafi 3	
Neni 25, paragrafi 1, nënparagrafi i parë	Neni 16, paragrafi 1
Neni 25, paragrafi 2	Neni 16, paragrafi 2 dhe neni 16, paragrafi 4, nënparagrafi i katërt
Neni 25, paragrafi 2, germa "a"	Neni 16, paragrafi 2, ndarja e parë e nënparagrafit të dytë dhe neni 16, paragrafi 4, nënparagrafi i katërt
Neni 25, paragrafi 2, germa "b"	
Neni 25, paragrafi 2, germa "c"	Neni 16, paragrafi 2, ndarja e dytë e nënparagrafit të dytë dhe neni 16, paragrafi 4, nënparagrafi i katërt
Neni 25, paragrafi 2, germa "d"	Neni 16, paragrafi 2, ndarja e tretë e nënparagrafit të dytë dhe neni 16, paragrafi 4, nënparagrafi i katërt
Neni 25, paragrafi 3	
Neni 25, paragrafi 4	Neni 16, paragrafi 2, fjalia e parë
Neni 25, paragrafi 5	Neni 16, paragrafi 3
Neni 25, paragrafi 6	Neni 16, paragrafi 4

Neni 25, paragrafi 7	Neni 16, paragrafi 2, nënparagrafi i katërt dhe neni 16, paragrafi 4, nënparagrafi i katërt
Neni 25, paragrafi 8	
Neni 25, paragrafi 9	Neni 16, paragrafi 5
Neni 26	
Neni 27, paragrafi 1	
Neni 27, paragrafi 2	
Neni 27, paragrafi 3	Neni 13
Neni 28	
Neni 29	
Neni 30, paragrafi 1, nënparagrafi i parë	Neni 14, paragrafi 1
Neni 30, paragrafi 1, germa "a"	
Neni 30, paragrafi 1, germa "b"	Neni 14, paragrafi 3
Neni 30, paragrafi 2	
Neni 30, paragrafi 3	
Neni 31	
Neni 32	
Neni 33, paragrafi 1	Neni 14, paragrafi 5, nënparagrafi i parë
Neni 33, paragrafi 2	
Neni 33, paragrafi 3	Neni 14, paragrafi 5, nënparagrafi i dytë
Neni 33, paragrafi 4	Neni 14, paragrafi 5, nënparagrafi i tretë
Neni 33, paragrafi 5	

Neni 34, paragrafi 1	Neni 14, paragrafi 4
Neni 34, paragrafi 2	
Neni 34, paragrafi 3	
Neni 35	
Neni 36, paragrafi 1	Neni 17, paragrafi 1
Neni 36, paragrafi 2	
Neni 37	Neni 20
Neni 38	
Neni 39	Neni 21
Shtojca	

1. *Gazeta Zyrtare C 161, 7.6.2012, f. 3.*
2. *Gazeta Zyrtare C 181, 21.6.2012, f. 64.*
3. Qëndrimi i Parlamentit Evropian, datë 10 shtator 2013 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare) dhe Vendimi i Këshillit, datë 14 prill 2014.
4. Direktiva 2003/6/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 28 janar 2003 "Për abuzimin me informacionet e privileguara dhe manipulimin e tregut (abuzimi në treg)" (*Gazeta Zyrtare L 96, 12.4.2003, f. 16*).
5. Rregullorja (BE) nr. 1227/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2011, "Për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë" (*Gazeta Zyrtare L 326, 8.12.2011, f. 1*).
6. Direktiva 2003/87/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 tetor 2003 "Për krijimin e një skeme për tregtimin e kuotave të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit", e cila ndryshon Direktivën e Këshillit nr. 96/61/KE" (*Gazeta Zyrtare L 275, 25.10.2003, f. 32*).
7. Direktiva 2004/39/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 21 prill 2004, "Për tregjet e instrumenteve financiare, që ndryshon Direktivat 85/611/KEE dhe 93/6/KEE të Këshillit dhe Direktivën 2000/12/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizon Direktivën 93/22/KEE të Këshillit" (*Gazeta Zyrtare L 145, 30.4.2004, f. 1*).
8. Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 1031/2010, datë 12 nëntor 2010, "Për orarin, administrimin dhe aspekte të tjera të ankandit të kuotave të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, sipas Direktivës 2003/87/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, që përcakton skemën për tregtimin e kuotave të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë brenda Bashkimit Evropian" (*Gazeta Zyrtare L 302, 18.11.2010, f. 1*).
9. Direktiva 2004/25/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 21 prill 2004 "Për ofertat e tenderave" (*Gazeta Zyrtare L 142, 30.4.2004, f. 12*).
10. Direktiva 2014/65/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 maj 2014 "Për tregjet e instrumenteve financiare dhe që ndryshon Direktivën 2002/92/KE dhe Direktivën 2011/67/BE (shihni faqen 349 të kësaj Gazete Zyrtare).
11. Direktiva 2014/57/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 prill 2014, "Për sanksionet penale në lidhje me abuzimin në treg" (shih faqen 179 të kësaj Gazete Zyrtare).
12. Direktiva 95/46/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24 tetor 1995, "Për mbrojtjen e individëve lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave" (*Gazeta Zyrtare L 281, 23.11.1995, f. 31*).
13. Rregullorja (KE) Nr. 45/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 18 dhjetor 2000, "Për mbrojtjen e individëve lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet e Komunitetit dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave" (*Gazeta Zyrtare L 8, 12.1.2001, f. 1*).

14. Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 2273/2003, datë 22 dhjetor 2003 për zbatimin e Direktivës 2003/6/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për përjashtimet për programet e riblerjes dhe stabilizimin e instrumenteve financiare (*Gazeta Zyrtare L 336, 23.12.2003, f. 33*).
15. Rregullorja (BE) nr. 182/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 shkurtit 2011 për përcaktimin e rregullave dhe parimeve të përgjithshme për mekanizmat e kontrollit nga shtetet anëtare për ushtrimin e kompetencave zbatuese nga Komisioni (*Gazeta Zyrtare L 55, 28.2.2011, f. 13*).
16. Rregullorja (BE) nr. 1093/2010 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24 nëntor 2010, "Për krijimin e Autoritetit Evropian të Mbikëqyrjes (Autoriteti Evropian Bankar), që ndryshon Vendimin nr. 716/2009/KE dhe shfuqizon Vendimin 2009/78/KE të Komisionit" (*Gazeta Zyrtare L 331, 15.12.2010, f. 12*).
17. *Gazeta Zyrtare C 177, 20.6.2012, f. 1*.
18. Rregullorja (BE) nr. 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, "Për kushtet e kujdesit për institucionet kredituese dhe shoqëritë e investimit dhe që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012" (*Gazeta Zyrtare L 176, 27.6.2013, f. 1*).
19. Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 1287/2006 datë 10 gusht 2006 për zbatimin e Direktivës 2004/39/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për sa u përket detyrimeve për mbajtjen e të dhënave për shoqëritë e investimit, raportimin e transaksioneve, transparencën e tregut, pranimin e instrumenteve financiare në tregtim dhe termat e përcaktuar për qëllimet e kësaj direktive (*Gazeta Zyrtare L 241, 2.9.2006, f. 1*).
20. Direktiva 2012/30/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2012, "Për koordinimin e masave mbrojtëse, të cilat kërkohen nga shtetet anëtare ose shoqëritë, me qëllim mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerë, në kuptimin e nenit 54, paragrafi i dytë i Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian, në lidhje me krijimin e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar dhe mirëmbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre, me synimin për t'i bërë këto masa mbrojtëse të barasvlershme" (*Gazeta Zyrtare L 315, 14.11.2012, f. 74*).
21. Rregullorja (BE) nr. 600/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 maj 2014, "Për tregjet e instrumenteve financiare dhe ndryshimin e Rregullores (BE) nr. 648/2012" (shih faqen 84 të kësaj gazete zyrtare)..
22. Direktiva 2002/58/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12 korrikut 2002 në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike (Direktiva për privatësinë dhe komunikimet elektronike) (*Gazeta Zyrtare L 201, 31.7.2002, f. 37*).
23. Rregullorja (BE) nr. 1095/2010 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24 nëntor 2010, "Për krijimin e Autoritetit Evropian të Mbikëqyrjes (Autoriteti Evropian i Titujve dhe Tregjeve), që ndryshon Vendimin Nr. 716/2009/KE dhe shfuqizon Vendimin 2009/77/KE të Komisionit" (*Gazeta Zyrtare L 331, 15.12.2010, f. 84*).
24. Direktiva 2004/109/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 dhjetor 2004, "Për harmonizimin e kërkesave të transparencës në lidhje me informacionin mbi emetuesit, titujt e të cilëve pranohen për t'u tregtuar në tregun e rregulluar dhe që ndryshon Direktivën 2001/34/KE" (*Gazeta Zyrtare L 390, 31.12.2004, f. 38*).
25. Direktiva 2013/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, "Për aksesin në aktivitetin e institucioneve kredituese dhe për mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve kredituese dhe të shoqërive të investimit, që ndryshon Direktivën 2002/87/KE dhe shfuqizon Direktivat 2006/48/KE dhe 2006/49/KE të Këshillit" (*Gazeta Zyrtare L 176, 27.6.2013, f. 338*).
26. Direktiva 2009/138/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 nëntor 2009, "Për marrjen dhe ndjekjen e biznesit të Sigurimit dhe Risigurimit (Aftësia Pagueuse II (*Gazeta Zyrtare L 335, 17.12.2009, f. 1*).
27. Rregullorja (KE) nr. 713/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 13 korrikut 2009 "Për krijimin e një agjencie për bashkëpunimin e rregullatorëve energjetikë" (*Gazeta Zyrtare L 211, 14.8.2009, f. 1*).
28. Direktiva 2013/34/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, "Për pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet përkatëse të llojeve të caktuara të sipërmarrjeve", që ndryshon Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon Direktivat e Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE (*Gazeta Zyrtare L 182, 29.6.2013, f. 19*).
29. Direktiva e Këshillit 86/635/KEE, datë 8 dhjetor 1986, "Për llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të bankave dhe të institucioneve të tjera financiare" (*Gazeta Zyrtare L 372, 31.12.1986, f. 1*).
30. Direktiva e Këshillit 91/674/KEE, datë 19 dhjetor 1991, "Për bilanci vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të shoqërive të sigurimit" (*Gazeta Zyrtare L 374, 31.12.1991, f. 7*).
31. Vendimi i Komisionit 2001/528/KE, datë 6 qershor 2001 "Për krijimin e Komitetit Evropian të Titujve" (*Gazeta Zyrtare L 191, 13.7.2001, f. 45*).
32. Direktiva e Komisionit 2004/72/KE datë 29 prill 2004 për zbatimin e Direktivës 2003/6/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për praktikat e pranuar të tregut, përkufizimin e informacionit të brendshëm në lidhje me derivativët mbi mallrat, hartimin e listave të personave të brendshëm, njoftimin e transaksioneve të menaxherëve dhe njoftimin e transaksioneve të dyshimta" (*Gazeta Zyrtare L 162, 30.4.2004, f. 70*).

33. Direktiva e Komisionit 2003/125/KE datë 22 dhjetor 2003 për zbatimin e Direktivës 2003/6/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për paraqitjen e drejtë të rekomandimeve të investimit dhe zbulimin e konflikteve të interesit (*Gazeta Zyrtare L 339, 24.12.2003, f. 73*).
34. Direktiva e Komisionit 2003/124/KE datë 22 dhjetor 2003 për zbatimin e Direktivës 2003/6/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për përkufizimin dhe publikimin e informacionit të brendshëm dhe përkufizimin e manipulimit të tregut (*Gazeta Zyrtare L 339, 24.12.2003, f. 70*).
35. Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 2273/2003, datë 22 dhjetor 2003 për zbatimin e Direktivës 2003/6/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për përjashtimet për programet e riblerjes dhe stabilizimin e instrumenteve financiare (*Gazeta Zyrtare L 336, 23.12.2003, f. 33*).
-